

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KRUJË

STRATEGJIA TERRITORIALE

VIZIONI STRATEGJIK, OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së
Z. EDI RAMA

N/KRYETARE I K.K.T-së
Znj. EGLANTINA GJERMENI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Z. HYSNI ÇAÇA

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë
Nr. 75 Datë 06.01.2017

Kryetari i Bashkisë
Z. ARTUR BUSHI

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË KRUJË
STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5, Datë 08.02.2017

DPKZHT: _____

STUDIO KONSULENTE "UTS-01": _____ Nr.Liç.N5737/3

STRUKTURA URBANE DHE TRANSPORTI

STRATEGJIA TERRITORIALE

VIZIONI STRATEGJIK, OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT

BASHKIA KRUJË

Maj 2016

Parathënie

Në korrik të vitit 2015, Qeveria Shqiptare mori nismën për të mbështetur 26 bashki në hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore me financim nga buxheti i shtetit.

Iniciativa për hartimin e Strategjisë, në kuadrin e PPV-së, vjen si nevojë për një qasje të re në trajtimin dhe konceptimin e situatës aktuale, për t'i dhënë një rrugë zhvillimi të qëndrueshëm dhe të organizuar territorit të bashkisë Krujë, duke u orientuar drejt një vizioni afatgjatë dhe shumë dimensional të problemeve urbane dhe përdorimit e ruajtjes së burimeve natyrore.

Kuadri ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, përmes direktivave dhe orientimeve që jep, për hartimin e Planeve të Përgjithshëm Lokale, siguron që produkti final i këtij procesi të jetë një dokument orientues strategjik për zhvillimin e bashkisë në tërësi. Synimet dhe objektivat e PPV sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë në aspektin ekonomik, urban, mjedisor dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshëm.

Strategjia e zhvillimit të territorit pasqyron një shkallë t lartë të përvojës dhe punës së kryer në nivel vendor, lokal e rajonal nga gjithë aktorët dhe specialistët e përfshirë. Ky dokument përpiqet të japë një kolazh shumë planesh dhe gjithëpërfshirës të faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, rajonalë dhe kombëtarë që ndikojnë në mënyrë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë ecurinë e Bashkisë Krujë në 15-20 vitet e ardhshëm. Përmes këtij dokumenti arrijmë të kuptojmë objektivat kryesorë të zhvillimit, sfidat mundësitë dhe rreziqet me të cilat ai do të përballet, duke lehtësuar vendimmarrjen afatgjatë që do të shprehet më tej përmes PPV-së.

Ky dokument ndërtohet jo vetëm mbi bazën e analizave shkencore territoriale, por edhe si shprehës i nevojave dhe dëshirave të banorëve dhe grupeve të interesit në Bashkinë Krujë. Gjatë periudhës së hartimit janë zhvilluar shumë vizita në terren e në institucione publike, me qëllim grumbullimin sa më të efektshëm të informacionit.

Në vijim Bashkia do të punojë ngushtësisht me konsulentin për të kaluar hapat ligjore e teknike të hartimit të PPV-së dhe rregullores së tij. Finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor do të jetë një nga arritjet e para të kësaj bashkie të re, me dëshirën e vullnetin për të perballuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm te territorit, së bashku me komunitetin, që është burimi dhe qëllimi final i këtij vullneti drejt të ardhmes.

Bashkia Krujë falënderon, së pari, të gjithë stafin e Bashkisë, në veçanti zyrën e planifikimit te territorit, për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve të dobishme të projektit. Të dhënat dhe njohuritë e zgjeruara të çdo njeriu kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin sa më të plotë dhe të saktë të këtij dokumenti.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

STRUKTURA URBANE DHE TRANSPORTI

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA KRUJË

Autorësia dhe kontributet

Dokumentet e PPV-së të bashkisë Krujë u përgatitën me pjesëmarrje aktive të stafit dhe të drejtueses Znj. Aida Dedja të DPKZHT nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, Z. Artur Bushi, me mbështetjen teknike të konsulentit UTS-01, me mbikëqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit nën drejtimin e koordinatores Znj. Fiona Mali dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Zhvillimit Urban

Bazuar në kontratën Nr. Prot. 564 të datës 28 janar 2016, lidhur midis MZHU dhe konsulentit UTS-01, grupi i punës, i përfshirë për realizimin e PPV-ve, gjatë periudhës janar-nëntor 2016, përbëhej nga:

Udhëheqës: Roberto Mascarucci (Planifikues urban)

Koordinator: Piero Rovigatti (Planifikues urban), Markel Baballëku (Inxhinier ndërtimi/vlerësues sizmik)

Ekspertë kyç: Klaud Manehasa (Planifikues urban), Mario Eboli (Ekonomist urban), Alfred Lako (Inxhinier/ekspert mjedisi) , Gjergj Islami (Arkitekt/Urbanist), Besar Zifla (Arkitekt/Urbanist), Antonio Demaio (Ekspert GIS)

Ekspertë në fusha të posaçme dhe staf mbështetës:
Rikard Luka (Inxhinier ndërtimi), Edmond Përgega (Arkitekt), Agim Selenica (Hidrolog), Shyqyri Aliaj (Gjeolog dhe Hidrogjeolog), Oltion Marko (Inxhinier mjedisi), Admir Agolli (Urbanist), Marsida Tuxhari (Arkitekte/Urbaniste), Enola Muhametaj (Arkitekte/Ekonomi urbane), Klaudjo Çollaku (Ekspert GIS), Altin Sula (Inxhinier transporti), Eugen Kallfani (Arkitekt/ (Ekspert i trashëgimis kulturore), Muhamet Kruja (Inxhinier transporti), Shpresa Prifti (Eksperte e trashëgimisë kulturore), Denada Veizaj (Arkitekte), Majlinda Shehu (Eksperte ligjore), Arjan Shyti (Inxhinier elektrik), Klodiana Kajmaku (Arkitekte), Alvin Saraçi (Përkthyes), Patris Martopullo (Inxhinier mjedisi), Anisa Llango (Inxhiniere ndërtimi), Ina Bajlozi (Inxhiniere ndërtimi), Jerina Luka (Rasha) (Shkenca sociale), Daniela Shalari (Ekonomiste), Desi Memoçi (Urbaniste), Ani Verzivolli (Inxhinier transporti).

Bashkia Krujë:

Artur Bushi	Kryetar i Bashkisë Krujë
Aida Dedja	Drejtor i Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit
Ilir Loci	Administrator i Nj. Administrative-Fushë Krujë
Qemal Daci	Administrator i Nj. Administrative Bubq
Shkelqim Malja	Specialist i menaxhimit të tokës
Drini Masha	Përgj. Sektorit të Marrëdhenieve me publikun
Arben Dobrozi	Specialist i Planifikimit të territorit
Riza Blushi	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Krujë

Në kopertinë: Edward Lear, Pamje e krujës (Croia), Telor 1848.

Shkurtime

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PKS	Plan Kombëtar Sektorial
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë 2015-2030)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ToR	Terma Reference
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMMTB	Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës Bujqësore
ZRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Së dyti, falënderon të gjithë përfaqësuesit e Njësive Administrative, si dhe të palëve të interesit dhe qytetarëve të kësaj bashkie, që gjithmonë kanë qenë pjesëmarrës dhe mjaft aktivë në çdo Forum Këshillues.

Gjithashtu, i shpreh mirënjohjen Ministrisë së Zhvillimit të Urban, për inicimin e këtij procesi dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e cila në shumë raste ka dhënë ndihmesën e saj të vyer, gjatë hartimit të dokumentit të Planifikimit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Krujë. Falënderojmë, veçanërisht, koordinatorin e projektit, që me bashkëpunimin e ngushtë, ka ndihmuar në avancimin e punës për këtë dokument.

Së fundmi, falënderon konsulentin, UTS-01, për mbledhjen e të gjithë materialeve ekzistuese, për dokumentimin e tyre dhe për përditësimin e të dhënave, si dhe për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Territorial të Bashkisë.

Shkurtime

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PKS	Plan Kombëtar Sektorial
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë 2015-2030)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ToR	Terma Reference
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMMTB	Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës Bujqësore
ZRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Lista e figurave

Fig. 1 PPK – Pamje satelitore e territorit të Zonës së Gjerë 16
Fig. 2 PPK – Itineraret dhe korridoret strategjike 18
Fig. 3 PPK – Skema e rrjetit të gazsjellësve në Ballkan 19
Fig. 4 PPK – Potencialet turistike të Mesdheut 20
Fig. 5 Fasha A – Det dhe Diell 21
Fig. 6 Fasha B – Bujqësia 22
Fig. 7 Fasha C – Histori dhe Kulturë 23
Fig. 8 Fasha D – Fasha detare 23
Fig. 9 PINS Durana, Hierarkia e Qendrave Urbane 25
Fig. 10 PINS Durana, Zhvillimi i Cluster-ave të kulturës e të turizmit 25
Fig. 11 PINS Durana, parashikimet për 5 sistemet territoriale 26
Fig. 12 PINSB – Infrastruktura 31
Fig. 13 Kategorizimi i turizmit sipas PINSB 32
Fig. 14 Rritja e PBB për frymë, 2006-2014 34
Fig. 15 Treguesit e papunësisë (%) 2013 - 2016 34
Fig. 16 Bilanci i tregtisë, Prill 2015 – Mars 2016 . 36
Fig. 17 Niveli i Borxhit Publik në raport me PBB, 2006-2015 36
Fig. 18 Shpërndarja e PBB në sektorët ekonomikë 2004-2014. 37
Fig. 19 Punësimi sipas sektorëve ekonomikë 2000 - 2010 37
Fig. 20 Evidentimi i pesë peizazheve në zonën e gjerë 41
Fig. 21 Fragment nga PINS i Bregdetit 43
Fig. 22 Korridoret tërthore Lindje-Perëndim 45
Fig. 23 Matrica e territorit 46
Fig. 24 Zonat urbane të miratuara (Vendimi Nr.5, dt. 19.12.14 i KKT) 47
Fig. 25 Evidentimi i morfologjive të zonave urbane 48
Fig. 26 Hierarkia e zonave urbane dhe sistemet e infrastrukturës 51
Fig. 27 Skema e zhvillimit të funksioneve 53
Fig. 28 Peizazhi Bregdetar 54
Fig. 29 Peizazhi Bujqësor 54

Fig. 30 Peizazhi Infrastrukturor 54
Fig. 31 Peizazhi urban rrëzë vargmaleve 55
Fig. 32 Peizazhi Malor 55
Fig. 33 Sistemi natyror 56
Fig. 34 Sistemi ujor 57
Fig. 35 Sistemi bujqësor 58
Fig. 36 Sistemi urban 59
Fig. 37 Sistemi infrastrukturor 60
Fig. 38 Territori i bashkisë Krujë 65
Fig. 39 Harta e trashëgimisë historiko – kulturore - natyrore 67
Fig. 40 Harta e degradimit dhe braktisjes 68
Fig. 41 Harta e riskut hidrologjik dhe rrëshqitjeve 69
Fig. 42 Harta e elementëve përjashtues 70
Fig. 43 Harta e projekteve 71
Fig. 44 Harta e flukseve në territorin e Bashkisë Krujë 81
Fig. 45 Ndarja në zona sipas shpejtësisë së erës dhe orëve vjetore 83
Fig. 46 Energjia diellore në Shqipëri 86
Fig. 47 Hidrocentralet në territorin e Shqipërisë 91
Fig. 48 Fluksi i energjisë 88
Fig. 49 Konsumi i energjisë 89
Fig. 50 Potenciali energjetik 93
Fig. 51 Fluksi i ujit 94
Fig. 52 Konsumi i ujit 97
Fig. 53 Fluksi i ushqimit 98
Fig. 54 Fluksi i mbetjeve 99
Fig. 55 Sistemi natyror 117
Fig. 56 Sistemi ujor 118
Fig. 57 Sistemi bujqësor 121
Fig. 58 Sistemi urban 122
Fig. 59 Sistemi infrastrukturor 123
Fig. 60 Mbivendosja e strategjive territorial 125
Fig. 61 Diagrama e ndërlidhjes së projekteve bazë 131
Fig. 62 Diagrama e ndërlidhjes së projekteve të zhvillimit dhe objektivave strategjike 135
Fig. 63 Qëndrueshmëria financiare e projektit 138
Fig. 64 Identifikimi dhe hartëzimi i projekteve 142

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

Lista e tabelave

Table 1: Rritja e PBB 2000-2014 35
Table 2 Bujqësia, vlera e shtuar (% e PBB) 38
Table 3 Industria, vlera e shtuar (% e PBB) 39
Table 4 Shërbimet, vlera e shtuar (% e PBB) 39
Table 5 Udhëzimet strategjike për ndërhyrjet në territor 49
Table 6 Fuqia dhe kapaciteti i hidrocentraleve në vend 82
Table 7: Lista e parqeve eolike për të cilat është dhënë licenca për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë elektrike 84
Table 8: Burimet gjeotermale në Shqipëri 85
Table 9: Popullsia banuese në Shqipëri (INSTAT, 2011) 88
Table 10: Njësitë ekonomike familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale (INSTAT, 2011) 91
Table 11: Bilanci i energjisë elektrike, 2011 (INSTAT, 2011) 91
Table 12: Fermat në Bashkinë Krujë (QTTB dhe MBZHRAU, 2014) 95
Table 13: Prodhimi bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Krujë (INSTAT, 2012) 95
Table 14: Ndryshimi i popullsisë 1989-2011 (INSTAT) 100
Table 15: Popullsia 2014-2015 (Bashkia Krujë) 101
Table 16 Përbërja strukturore e territorit të bashkisë Krujë 107
Table 17 Klasifikimi i njësive urbane në nivel bashkie 108
Table 18 Korridoret dhe grupimet e vendbanimeve malore 109
Table 19 Strategjitë bazë 113
Table 20 Projektet strategjike bazë 130
Table 21 Projektet strategjike të zhvillimit sipas tipit dhe kohës së zbatimit 134
Table 22 Objektivi Strategjik: Infrastrukturë dhe Logjistikë 140
Table 23 Objektivi Strategjik: Turizëm kulturor 140
Table 24 Objektivi Strategjik: Inovacion prodhimi 140
Table 25 Plani i veprimit për projektet bazë dhe projektet e zhvillimit 143

Përmbajtja

STRATEGJIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT

1.1 *Metodologjia* 15
1.1.1 *Qasja strategjike* 15
1.1.2 *Vizioni në shkallë të ndryshme* 16

1.2 *DIREKTIVAT STRATEGJIKE TE PLANEVE KOMBËTARE* 17
1.2.1 *Projektet kryesore sipas PPK* 17
1.2.2 *Qendrat urbane dhe lokale të zonës* 19
1.2.3 *Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin* 21
1.2.4 *Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë – Durrës (Durana)* 24
1.2.5 *Drejtimet e zhvillimit sipas pesë sistemeve* 28

1.3 *VIZIONI STRATEGJIK NË SHKALLË TË GJERË* 34
1.3.1 *Analiza dhe interpretimi i tendencave socio-ekonomike* 34
1.3.2 *Propozimi i përgjithshëm strategjik* 41
1.3.3 *Vizioni hapësinor territorial* 5[illegible]

STRATEGJIA TERRITORIALE

2.1 *IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE, POTENCIALEVE DHE PENGESAVE* 6[illegible]
2.1.1 *Analiza e thelluar e territorit* 65
2.1.2 *Analiza SWOT për secilin nga pesë sistemet territoriale (N, U, B, UB, IN)* 72
2.1.3 *Analiza metabolike* 80
2.1.4 *Analiza e vlerësimeve demografike* 100

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

2.2 STRATEGJIA TERRITORIALE, VIZIONI STRATEGJIK DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT 104
2.2.1 Identifikimi i mundësive kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të tri bashkive 104
2.2.2 Vizioni hapësinor lokal për territorin e bashkisë Krujë 106
2.2.3 Strategjia e zhvillimit lokal 112

2.3 HARTËZIMI I STRATEGJISË TERRITORIALE 116
2.3.1 Strategjia territoriale për secilin nga pesë sistemet territoriale të Bashkisë Krujë (N, U, B, UB, IN) 116
2.3.2 Mbivendosja e sistemeve territoriale 124

VEPRIMET STRATEGJIKE DHE PROJEKTET E ZHVILLIMIT
3.1 PROJEKTET STRATEGJIKE 129
3.1.1 Tipologjitë e projekteve 129
3.1.2 Projektet bazë 130
3.1.3 Projektet e zhvillimit 134

3.2 PROGRAMET DHE PLANI I VEPRIMIT 137
3.2.1 Hyrje 137
3.2.2 Analiza financiare e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit 138
3.2.3 Analiza ekonomike e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit 139
3.2.4 Plani i veprimit dhe objektivave strategjike 139

3.3 PROJEKTE ZHVILLIMI PILOT 141
3.3.1 Identifikimi dhe hartëzimi i projekteve 141
3.3.2 Skedat e projekteve 142

Aneks
4.1 KONSULTAT PUBLIKE GJATË HARTIMIT TË PPV 187
4.1.1 Dëgjesë Publike datë 01.03.2016 187
4.1.2 Pyetësorët e realizuar gjatë dëgjesave publike dhe mbledhjes së informacionit në terren 191
4.1.3 Përpunim i informacionit të mbledhur nga dëgjesa publike, terreni dhe online 194
4.1.4 Takimeve me përfaqësuesit e njësive administrative 195
4.1.5 Pyetësor i detajuar për njësitë administrative 199
4.1.6 Prezantim i Strategjive Territoriale të 26 PPV-ve, 3-4-5 Maj 2016 211
4.1.7 Takim me Forumin Këshillimor Vendor, datë 19 Maj 2016 212
4.1.8 Dëgjesë publike, datë 26 Maj 2016 216
4.1.9 Takim me Forumin e Bashkërendimit të Planifikimit Vendor (FBPV) 30 Maj 2016 218

4.2 MATERIALI HARTOGRAFIK 222

Hyrje

Një ndër instrumentet e planifikimit vendor është: Dokumenti i Strategjisë Territoriale së Zhvillimit, e cila është qasja e parë fiziko-hapësinore me Planin e Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie, si shprehja më e lartë e planifikimit te territorit, që pasqyron përparësi e qëllime strategjike, objektiva, mjete e rezultate të pritshme, për të orientuar, drejtuar dhe nxitur proceset e mëtejshme të planifikimit të territorit.

Strategjia Territoriale është dokumenti strategjik thelbësor qe udhëzon zhvillimin fiziko-hapësinor të njësisë së qeverisjes vendore dhe shërben si bazë për zhvillimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Politika e zhvillimit te territorit është bazuar në fazat e analizës së gjendjes ekzistuese dhe përfshin projeksionet ekonomike dhe demografike për 15-20 vitet e ardhshme. Këto parashikime janë bërë mbi bazën e analizimit të tendencave të zhvillimit në vitet e fundit dhe në të dhënat sociale, ekonomike e demografike të mbledhura në fazat e para. Gjithashtu janë marrë parasysh parashikimet e zhvillimit të ardhshëm të Bashkisë, sipas qëllimit dhe objektivave për vizionin e zhvillimit te këtij territori, që duhet të përfshijë plani i përgjithshëm vendor.

Ky projekt përfshin hartimin e instrumenteve vendore të planifikimit për Bashkinë Krujë, ku theksi vihet dhe është i orientuar në zhvillimin e njësisë në aspektin ekonomik, urban, mjedisor dhe çdo aspekt tjetër të rëndësishëm për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshëm.

Ky dokument ka 3 kapitujë kryesorë, që përbëjnë bazën e vlerësimit:

- Strategjia Rajonale
- Strategjia Territoriale
- Plani i veprimeve prioritare, investimeve strategjike kapitale dhe projekteve pilot të zhvillimit

Një element i rëndësishëm i kësaj faze është Përfshirja e grupeve të interesit dhe dëgjesa publike me objektiv kryesor takimet publike për të krijuar transparencë dhe besim në mes të qytetarëve dhe autoriteteve publike, para se të ndërmerren vendime të zhvillimit. Gjatë periudhës së hartimit të këtij dokumenti janë realizuar 3 dëgjesa publike, si dhe janë kryer takime të ngushta me ekspertë vendorë, përfaqësues të biznesit dhe aktorë të tjerë, që operojnë në këtë rajon dhe janë pjesë e vlerës e zhvillimit me aktivitetin e tyre.

Strategjia rajonale shtron një vizion të përgjithshëm të gjithë territorit të përfshirë në Lotin 1, duke përfituar nga vazhdimësia hapësinore e territorit në studim, duke evidentuar pikat e përbashkëta, pozicionin dhe rolin që luan ky rajon në tërësinë territoriale të Republikës

së Shqipërisë, sidomos përsa i përket zhvillimit të infrastrukturës, raportit mes malit dhe detit, veriut dhe jugut, urbanizmit dhe natyrës.
Strategjia Territoriale bazohet në gjetjet e fazës së parë dhe potencialet e zonës duke përcaktuar strukturën e ndërtuar të territorit, vizonin dhe strategjinë zhvillimore specifike për Bashkinë e Krujës. Ky proces do të zhvillohet duke ecur në tre hapa:

- Identifikimi i nevojave, potencialet dhe kufizimet
- Formulimi i një vizion dhe strategjie për zhvillimin lokal e njësisë territoriale
- Hartëzimi i Strategjisë së Territorit

Strategjia do të japë orientimet kryesore të zhvillimit, përcaktimet hapësinore dhe sasiore të nevojave, elementët kryesorë të konservimit, si dhe do të ofrojë rekomandime e programe specifike për problemet kryesore dhe transformimet e parashikuara.
Vizioni dhe orientimet kryesore strategjike do të paraqiten në harta, sipas pesë sistemeve territoriale, duke treguar direktivat kryesore, fazat e zbatimit për zhvillime të mëtejshme, si dhe ndryshimet e nevojshme që rrjedhin nga zbatimi i vizionit.

Plani i veprimeve prioritare, investimeve strategjike kapitale dhe projekteve pilot të zhvillimit vjen si një shtjellim i nevojave prioritare të bashkisë dhe si plan i investimeve mbi të cilat do të zhvillohen këta elementë kryesorë. Plani do të bazohet kryesisht në investimet në infrastrukturën e nevojshme për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe për të akomoduar rritjen e ardhshme ekonomike, duke identifikuar së pari projektet e investimeve me prioritet të lartë, të nevojshme gjatë pesë viteve të ardhshme. Ky plan do të evidentojë tre tipe projektesh, duke filluar nga shkalla e madhe në projektet e detajuara dhe duke shpjeguar diferencat e rëndësinë e secilit:

- Projekte Bazë
- Projekte Zhvillimi
- Projekte Pilot

Plani do të përfshijë gjithashtu një vlerësim dhe programin e investimeve kapitale financiare për ndërtimin dhe shpenzimet operative të infrastrukturës së re, si dhe zonat e rëndësisë së veçantë për territorin lokal, të konsideruara zona të zhvillimit prioritar dhe që do të luajnë rolin e rasteve studimore për testimin e zhvillimeve të së ardhmes.



01 / Strategjia e përgjithshme e zhvillimit

1 STRATEGJIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT

1.1 METODOLOGJIA

1.1.1 Qasja strategjike

Ajo që karakterizon vëmendjen e kohëve të fundit ndaj qasjes strategjike të planifikimit është mundësia, që njëkohësisht të mbahen parasysh, si nevoja e re për konkurrencë e sistemeve lokale, ashtu edhe kriza e modelit tradicional të zhvillimit. Është kjo arsyeja pse, detyra kryesore e planeve të reja urbanistike vendore është ajo e krijimit të mundësive të reja për pozicionim të qëndrueshëm të resurseve lokale, duke përfshirë iniciativat urbanistike në një kornize më të gjerë, duke ekzaminuar skenarët alternativë, duke vlerësuar efektet, por mbi të gjitha duke saktësuar "perspektivat territoriale" të referimit.

Disa lloje problematikash nuk mund të përballohen dhe të zgjidhen në nivel lokal. Menaxhimi i zhvillimit lokal, pa përcaktuar horizontet strategjike, mund të bëjë që qyteteve dhe territoreve t'ju shkojnë dëm mundësi shumë të rëndësishme zhvillimi. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) duhet që të mund të përfytyrojë mënyra të reja të organizimit të hapësirës në raport me ripozicionimin strategjik të vendit në kontekstin e "Zonës së Gjerë" (Leximi dhe interpretimi i territorit me anë të "Zonave të Gjera" nënkupton kërkimin e shkallës së duhur të planifikimit që përfshin një hapësirë territoriale me karakteristika homogjene, e cila shpeshherë tejkalon kufijtë administrative lokalë. Në rastin e këtij studimi, territori i bashkive Lezhë, Kurbin dhe Krujë paraqet një homogjenitet funksional dhe hapësinor, edhe pse nuk mungojnë situatat specifike lokale.).

Mundësia e funksionimit me sukses e një programi lokal zhvillimi varet edhe nga krijimi i situatave të tjera shtesë të favorshme si: ndërtimi i rrjetit të grupeve të interesit, marrëveshja mes institucioneve për realizimin e tij, pajtimi social i iniciativës etj.
Në këtë drejtim mund, dhe duhet të punohet që planet e reja të jenë një mundësi për të tejkaluar dështimet e të shkuarës, duke ndërtuar një listë ndërhyrjesh prioritare që të kenë kushtin e dyfishtë:

- të jenë të sakta nga pikëpamja teknike
- të jenë te zbatueshme nga pikëpamja ekonomiko-sociale.

Në mënyrë që Plani i Përgjithshëm Vendor të mund të jetë një instrument efikas për zhvillimin e territorit, ai duhet:

- të sqarojë synimet ekonomiko-sociale të komunitetit lokal duke përcaktuar ripozicionimin e tij strategjik në kontekstin e një perspektive të "Zonës së Gjerë";
- të evidentojë veprimet strategjike që mund të realizohen në një kohë të shkurtër me anë të resurseve të disponueshme dhe/të përdorshme;
- të hartohet mbi disa objektiva (të limituara) që duhet të arrihen në një hark kohor të paracaktuar.

Nga kjo rrjedh nevoja e proceseve qeverisëse në disa nivele, të bazuara në marrëveshje (si horizontale, ashtu edhe vertikale) mes institucioneve të niveleve dhe llojeve të ndryshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL · TIRANE · SEKRETARIA

Fig. 1 PPK – Pamje satelitore e territorit të Zonës së Gjerë

PPV i hartuar sipas një qasjeje strategjike mund t'i krijojë pushtetit lokal mundësi të reja shtesë zhvillimi, por për të bërë këtë, programi i ndërhyrjeve dhe i veprimeve që duhen vënë në funksion duhet të ndërtohet duke u nisur nga sugjerimet e ofruara nga territori, i nënkuptuar në formën e dyfishtë të një sistemi vendor dhe një bashkësie grupesh interesi. Vizioni Strategjik duhet konsideruar si qasja projektuale e një "perspektive territoriale", e ndërtuar duke u nisur nga "ambiciet ekonomiko-sociale" të komunitetit lokal. Bëhet fjalë për ndërtimin e një politike të re urbane në një harmoni më të madhe me logjikën ekonomike. Duke qenë se një detyrë e tillë zhvillimi nuk mund t'i lihet vetëm planit urbanistik (siç nënkuptohet tradicionalisht), procesi duhet të parashikojë ndërtimin e një perspektive territoriale si kalim nga ambiciet ekonomiko-sociale të ndërhyrjeve.

Një PPV e hartuar sipas logjikës së mësipërme ka këto avantazhe:

- qeverisjen e transformimit të tokave, në kuadër të një objektivi koherent të nxjerrjes në pah të vlerave ekonomike;
- të garantojë funksionalitetin e secilës prej ndërhyrjeve, në lidhje me sistemin e përgjithshëm të rrjeteve;
- të favorizojë pikat (vendndodhjet) e mundshme prodhuese, që janë të afta të thithin investime nga jashtë.

Në këtë kontekst, Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) duhet të dijë të përballojë me vetëdije raportin mes vendit dhe rrjetit, si në hapësirë ashtu edhe në shkallë, domethënë të përfytyrojë lloje të reja organizimi të hapësirës dhe t'i përfytyrojë ato në lidhje me pozicionimin strategjik të vendit krahasuar me dinamikën e rrjeteve.

1.1.2 Vizioni në shkallë të ndryshme

Transformimi i një Plani të Përgjithshëm Vendor në një projekt zhvillimi, nënkupton shpjegimin e atyre përmbajtjeve që mund t'i shtojnë planit mundësi të reja zhvillimi konkrete dhe të menjëhershme.

Në përputhje me një vizion të përbashkët në shkallë territoriale, PPV-ja duhet të marrë përsipër detyrën e parashikimit të "mundësive taktike" të afta për t'i dhënë realizueshmëri zgjedhjeve strategjike. Pra duhen parashikuar në PPV të gjitha elementet domethënëse, që kanë aftësinë ta transformojnë në një projekt të vërtetë urbanistik, që të mund të garantojë realizueshmërinë e strategjive të evidentuara në shkallë territoriale, si edhe sigurinë e shpejtësinë procedurale për realizimin e këtyre parashikimeve të bëra nga plani.

Një plan mund të bëhet projekt pavarësisht nga shkalla e aplikimit. Përcaktimi i një konfigurimi të deshiruar hapësinor dhe evidentimi i bashkësive të veprimeve

që duhen vënë në funksion për arritjen e tij është një operacion që mund të bëhet në çfarëdo shkalle, për të rindërtuar një qytet por edhe për të realizuar një sistem objektesh të vogla me karakter shërbimi të shpërndarë në territor ose një rrjet të organizuar për menaxhimin e një fluksi mallrash apo njerëzish.

Raporti midis projektit dhe planit shtjellohet në shkallë të ndryshme dhe i përshkon vertikalisht shkallët, në kuptimin që plani mund të shkaktojë projekte ndërhyrjesh në shkallë të ndryshme nga ato për të cilat është hartuar, ashtu sikurse një projekt mund të provokojë efekte në shkallë të ndryshme nga ajo në të cilën zbatohet. Për shembull, shpeshherë nënvleftësohet influenca e ndërsjellë mes organizimit të hapësirave në shkallë lokale dhe dinamikave ekonomiko-sociale në shkallë globale. Politikat e zhvillimit ekonomik janë akoma shumë të shkëputura nga politikat e qeverisjes së transformimeve të hapësirës territoriale dhe urbane. Ndërsa lidhja funksionale mes projektimit të hapësirës së urbanizuar dhe strategjive të zhvillimit të kontekstit është e fortë dhe e ndërsjellët. Zgjedhjet hapësinore, në shkallë territoriale dhe urbane, mund të kenë influencë mbi dinamikat ekonomike kontekstuale, ashtu si zgjedhjet strategjike të sistemit mund të përfitojnë mundësi të reja zhvillimi urbanistik.

Veprimi i bashkërenduar i planifikimit të territorit dhe i projektimit të hapësirave urbanizuese duhet të përcaktojë kushtet e kontekstit që favorizojnë tërheqjen e investimeve, të cilat nuk janë më të lidhura vetëm me shërbimet ndaj prodhimit (zonat ekonomike – industriale), por edhe me shërbimet e integruara me njerëzin (sisteme urbane), duke parë që me gjithë globalizimin e marrëdhënieve virtuale, janë akoma qytetet ato që tërheqin dijen dhe favorizojnë nxitjen e proceseve të inovacionit.

Planifikimi strategjik, në riprojektimin e rrjeteve infrastrukturore, mund të transformojë boshllëqet urbane (hapësira të pa urbanizuara brenda zonës urbane) në mundësi të reja zhvillimi. Plani urbanistik i një qyteti mund të jetë themelor për krijimin e kushteve të duhura të kontekstit, në mënyrë që ai qytet të jetë më tërheqës kundrejt personave dhe kapitaleve. Konfigurimi hapësinor i një nyjeje infrastrukturore mund të përcaktojë kushtet bazë, që një lidhje e thjeshtë intermodale të transformohet në një "ndërlidhje komplekse", e aftë të krijojë dinamika të reja zhvillimi social dhe ekonomik.

Vlerësimi i vetëdijshëm i raporteve të shkallëve, lejon të konceptohet në mënyrën e duhur, zona e studimit në lidhje me raportet e shumta hapësinore, si të brendshme ashtu edhe të jashtme, duke tejkaluar vështirësinë e zakonshme të përkthimit të kompleksitetit të rrjeteve në një projekt po aq kompleks. Vetëdija e shkallës është i pari kusht që projekti i hapësirave urbanizuese të jetë koherent dhe bashkëveprues me rregullat e përgjithshme të planifikimit të përdorimit të tokës në shkallë "të gjerë" (pra në konceptin e hapësirës territoriale përtej kufijve lokalë).

1.2 DIREKTIVAT STRATEGJIKE TË PLANEVE KOMBËTARE

1.2.1 Projektet kryesore sipas PPK

Bashkia Krujë, përfshihet në disa nga programet dhe projektet strategjike të Planit Kombëtar. Ajo bën pjesë në rajonin ekonomik Tiranë Durrës ose Motorin Qendror. Më poshtë janë listuar parashikimet konkrete të PPK-së që lidhen drejtpërsëdrejti me territorin në studim.

Zona në fjalë është pjesë e këtyre Projekteve strategjike të vendit në lidhje me Europën:

- Korridori i Gjelbër (Realizimi i lidhjes midis Malit te Zi dhe Greqisë nga Hani i Hotit në Shkodër dhe Gjirokaster përmes pikes kufitare Kakavija, me një gjatësi prej 405 km)
- Rruga peizazhistike brgdetare (rrugë bregdetare turistike me impakt të ulët mjedisor, që lidh lokalitetet e bregdetit: Velipojë – Shëngjin, Shëngjin – Patok, Patok – Durrës, Durrës – Divjakë, Divjakë – Seman, Seman – Vlorë, Vlorë – Himarë, Himarë –

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË QYTETIT TIRANË SEKRETARIA



Fig. 2 PPK – Itineraret dhe korridoret strategjike

Sarandë, Sarandë – Butrint.

- Rruga e Kombit (Durrës-Kukës-Prishtinë-Nish). Si një nga korridoret me ndikim më të lartë në rajon për shkak të lidhjes përmes Prishtinës me korridorin X dhe Serbinë.

Në territorin e bashkive të Lotit 1 kalojnë korridoret e mëposhtme energjetike:

- IAP- Ionian Adriatik Pipeline do të kalojë në pjesën perëndimore të Shqipërisë, nga Fieri në Shkodër për të furnizuar Malin e Zi, Bosnjën e Kroacisë.

- IAP-KOSOVË. IAP degëzohet në rajonin Shkodër-Lezhë, për të furnizuar Kosovën nëpërmjet Kukësit duke realizuar Unazën Perëndimore të Ballkanit, Western Ballkan Rings (WBR)

Gazsjellësi Joniano-Adriatik është një zgjatim i projektit TAP drejt vendeve të rajonit. Nga studimi i fizibilitetit[1], ky gazsjellës ka një gjatësi 510.8 km dhe segmenti që shtrihet në territorin e vendit tonë është 167.7km. Pikënisja është në Fier (ku kryqëzohet me TAP) dhe përshkon përafërsisht gjithë vijën bregdetare drejt veriut, arrin në Malin e Zi e më pas përfundon në Split të Kroacisë.

Për Shqipërinë, veç investimeve direkte në masën 170 milionë euro dhe krijimit të vendeve të reja të punës të përcaktuara keto nga studimi i fizibilitetit, ky investim strategjik mundëson shtrirjen e rrjetit të gazit në zonat më të populluara të vendit. Gazsjellësi Transadriatik ndalon në Fier duke vazhduar drejt Italisë, ndërsa linja Joniano-Adriatike bën të mundur që tubacioni të shtrihet edhe në qytetin e Durrësit, atë të Tiranës dhe Shkodrës. Paralelisht, ndërtimi i këtij gazsjellësi rrit edhe më shumë

[1] *FS and ESIA for the Ionian – Adriatic Pipeline (IAP), Feasibility Study Report - January 2014 (EuropeAid/128073/C/SER/MULTI, Sub Project: WB5-REG-ENE-03)*

Fig. 3 PPK – Skema e rrjetit të gazsjellësve në Ballkan

pozitat gjeostrategjike të Shqipërisë në rajon, duke e shndërruar atë në nyje të rrjetit rajonal të gazit. Sipas studimit, gazsjellësi do të transportojë 5 miliardë metër kub gaz në vit, prej të cilave 1 miliardë metër kub do të konsumohen në Shqipëri, 0.5 miliardë në Mal të Zi dhe pjesa tjetër në Bosnje e Kroaci.

Gjithashtu në këtë territor kalon dhe linja e interkoneksionit 400kV, Elbasan – Tiranë – Podgoricë një prej linjave kryesore të energjisë elektrike që Shqipëria ka me tregun e rajonit dhe atë të Bashkimit Europian. Kjo linjë sëbashku me dy linjat e tjera të interkoneksionit: Shqipëri – Kosovë dhe Tiranë – Elbasan – Kapshticë, përbëjnë korridoret kryesore të energjisë elektrike me anë të cilave vendi jonë lidhet me tregun rajonal.

1.2.2 Qendrat urbane dhe lokale të zonës

1. KRUJA

Objektivat

- Qender turistike kombetare.
- Turizem i alternuar, historik-kulturor, eko, malor, kulinar, etj. për ta zhvilluar gjatë gjithë vitit ekonominë.
- Mbrojtje e mjedisit.
- Qender logjistike.
- Zhvillimi i bujqësisë

Politikat

- Forcim i mobilitetit dhe logjistikës.
- Promovim potencialesh turistike.
- Nxitje e vlerave bujqësore.
- Aksesim i vlerave natyrore, kulturore, perms infrastrukturës me impakt të ulët në mjedis.
- Masa konkrete për mbrojtjen nga rreziqet natyrore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA

Kruja dhe Fushë Kruja hyjnë në grupin e qendrave dytësore urbane. Si i tillë ato karakterizohen nga tipare zhvillimi ekonomik të specializuar. Kruja karakterizohet nga ekonomia e lidhur kryesisht me turizmin historik dhe natyror, ndërsa Fushë Kruja me zhvillimin e logjistikës. Këto qendra, në bashkëpunim me qendrat primare (Metropoli Tiranë dhe Durrësi), ndihmojnë në zhvillimin e zonës ekonomike primare (rajoni ekonomik Tiranë-Durrës).

Sipas Draft-PPK, duke u pozicionuar në brendësi të territorit të vendit, Bashkia Krujë është pjesë integrale e Motorit Qendror apo ndryshe rajonit ekonomik Tiranë - Durrës. Ky dokument parashikon këtë profil mbizotërues për rajonin: Shërbime, Tregti (shkëmbim përpunim)-Energji-Turizëm-Agrobiznes - lidhje e fortë bashkëpunimi ndërkombëtar.

Të qenit pjesë e Rajonit ekonomik Motor Qendror e bën këtë bashki të jetë e lidhur me atraktore ekonomikë si qendrat e inovacionit, hub-et logjistike, infrastrukturë gazsjellës, apo aeroport kombëtar kryesisht të vendosura në dy qendrat e tjera të rajonit. Duke kaluar në një shkallë më të vogël analize të territorit, në Draft PPK, qendra e dytësore e specializuar e Krujës karakterizohet nga prezenca e Turizmit (Zonë me rëndësi kombëtare) dhe e zonës me aktivitet ekonomik të Fushë Krujës si atraktoret kryesorë të zhvillimit ekonomik.

Afërsia me motorin qendror ekonomik bën që bashkia Krujë të jetë pranë akseve kryesore me rëndësi kombëtare. Gjithashtu, bashkia Krujë pozicionohet pranë hubeve multimodale të Tiranës e atyre 5 modale të Durrësit e të Lezhës. Lidhja e qytetit Krujë me atë të Fushë Krujës bëhet nëpërmjet transportit publik, të automjeteve dhe atij të gjelbër (green).

Sipas Draft-PPK, në aspektin mjedisor, Kruja kufizohet nga një zone e mbrojtur dhe me prirje të zhvillimit të turizmit (zonë natyrore dhe parqet kombëtare në lindje të territorit) ku rëndësi të veçantë paraqet Parku Kombëtar i Qafështamës. Gjithashtu territori është i pasur me monumente të natyrës me potencial të lartë turistik.

Përsa i përket trashëgimisë kulturore dhe historike, Kruja është një qendër me vlera të rëndësisë kombëtare si psh.: Kalaja e Krujës dhe Pazari i Vjetër, Kalaja në Ishatin Zgërdhesh (Albanopolis), si dhe një sërë monumentesh të tjera me vlera të spikatura dhe potencial të lartë turistik.

Në terma të sektorit të ekonomisë, në territorin e bashkisë Krujë ndodhen dy fabrika të prodhimit të çimentos, prodhimit të gurit gëlqeror si edhe lexohet një prezencë e fortë e industrisë fasone. Po në këtë kuadër përmendim edhe korridorin ekonomik në Nikël ku është e zhvilluar industria e mobilierisë së drurit.



Fig. 4 PPK – Potencialet turistike të Mesdheut

1.2.3 Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin

Parimet kryesore të këtij Plani për Bregdetin janë:

- Bregdeti si binom det - tokë aset i rëndesishëm kombëtar dhe pjesë e integruar e rrjetit mesdhetar.

- Hapësirë e mirë menaxhuar ku harmonizohen nevojat për zhvillim ekonomik dhe nevojat lokale me domosdoshmërinë e mbrojtjes së aseteve kulturore, natyrore dhe historike.

1.2.3.1 Integrimi në Hapësirën mesdhetare

Deti Mesdhe, paraqet një potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, pasi rreth 51% e turizmit botëror zhvillohet në këtë hapësirë. Qëllimi primar i këtij plani është integrimi real i vendit tonë në hapësirën mesdhetare, përmes propozimeve të reja në infrastrukturën lidhëse, bashkëpunim ndër-rajonal për zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe programeve të ndryshme ndërkombëtare (për vendet në proces integrimi në UE).

Kjo do të arrihet duke ofruar një zhvillim të kontrolluar në zonën bregdetare, zhvillim i cili mundëson ruajtjen e aseteve natyrore, kulturore dhe sociale dhe gjeneron ekonomi, zhvillim i cili bazohet në traditat, kulturën dhe produktin vendas.

Projekti ndërkombëtar i rrugës peizazhistike bregdetare, e cila ka si qëllim ndërlidhjen e gjithë hapësirës Mesdhetare, është një projekt strategjik i rëndësishëm, i cili rrit mundësinë e vendit tonë për tu integruar në marrëdhëniet ekonomike me vendet e tjera jo vetëm të Mesdheut, por edhe në brendësi të kontinenteve.

1.2.3.2 Potencialet e fashave, tokësore dhe detare

Si gjithë bashkitë me territore bregdetare, vizioni i këtyre bashkive duhet të marrë në konsideratë zonën mbrojtëse të parashikuar nga PINSB-ja sipas këtyre fashave:

1. Fasha A

Kjo është fasha e hapësirës bregdetare det-diell. Sipas Planit për Bregdetin kjo fashë është njëkohësisht:

Territori i parë që prek detin Mesdhe, përmes deteve Adriatik dhe Jon, me mundësi zhvillimi të transportit detare mes tre kontinente Azi, Afrikë dhe Evropë, dhe lidhje të menjëhershme me 27 shtete që prekin detin Mesdhe;

Territori më i ndjeshëm ndaj fenomeneve të përmbytjes, erozionit, rrëshqitjes dhe ndotjes së deteve dhe brigjeve detare Adriatik dhe Jon (nga prurjet e tetë lumenjve) dhe nga zhvillimi urban i madh dhe i pakontrolluar në hapësirën e bregdetit. Hapësirë bregdetare, me gjerësi 2-10 km, është zhvilluar më tepër në sektorin e turizmit det-diell, si pasojë e presionit dhe potenciali më i lartë i zhvillimit të ekonomisë së turizmit.



Fig. 5 Fasha A – Det dhe Diell

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

2. Fasha B

Kjo është fasha Bujqësore e hapësirës bregdetare. Fasha B është hapësira e tokës e cila vjen menjëherë pas fashës A, në brendësi të territorit. Ajo përfaqësohet nga ultësira perëndimore, si zonë e ndërmjetme, mes fashës së parë të bregdetit dhe vargut të lartë malor e shkëmbor, e cila varion nga 5-25 km gjerësi dhe përfshin tokën bujqësore dhe kodrat e ulëta me tarracat e punuara në vreshtari, pemë frutore dhe ullishte, dhe akset e transportit rrugor kryesor kombëtar Veri-Jug.

Ky brez ka një pasuri ujore shumë të lartë e cila kontribuon në rritjen dhe zhvillimin e tokës bujqësore. Uji është faktori kryesor lidhës midis zonës së ndërmjetme dhe rripit bregdetar. Cilësia dhe sasia e tij është më rëndësi thelbësore për ruajtjen e qëndrueshmërisë së rripit bregdetar.

3. Fasha C

Kjo është fasha e pasurisë historike e kulturore të hapësirës bregdetare. Fasha C është hapësirë territoriale e cila nis që nga bregdeti e vazhdon deri më në brendësi të territorit duke përfshirë edhe qytete me vlera jo vetëm kombëtare , por edhe ndërkombëtare që gëzojnë statusin dhe mbrohen nga UNESCO.

Kjo fashë përfaqësohet nga vlerat e trashëgimisë kulturore që shtrihen në të gjithë territorin bregdetar, fushor dhe malor, dhe që ka ndikim me vlerat që ajo mbart, në të gjithë territorin bregdetar të Shqipërisë.

Territori i fashës C, mbivendoset me dy fashat e para A dhe B, dhe depërton më thellë në brendësi të territorit, duke përfshirë të gjitha potencialet me vlerë dhe me ndikim në zhvillimin e turizmit.

Thellësia e kësaj fashe në territor varion nga 10-40 km distancë nga vija bregdetare.

Numërohen rreth 1000 monumente kulture dhe historike vetëm në këtë pjesë të territorit të Shqipërisë.

4. Fasha D

Kjo fashë përfaqësohet nga hapësira detare (19,3 km), nga të gjitha aktivitetet ekonomike e rekreative që ndodhin në të dhe nga potencialet për zhvillim të saj, si:

- zhvillimi i akuakulturës,
- transporti detar
- turizmi detar
- ekstraktimi dhe përpunimi i kripës
- zhvillimi i industrisë se peshkimit



Fig. 6 Fasha B – Bujqësia



Fig. 7 Fasha C – Histori dhe Kulturë



Fig. 8 Fasha D – Fasha Detare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

1.2.4 Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë – Durrës (Durana)

Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë – Durrës (PINS Durana) është një dokument planifikimi në shkallë kombëtare që parashikon zhvillimin e rajonit metropolitan dhe zonës ekonomike më të rëndësishme të vendit. Duke qenë se territori i Lotit 1 është kufitar në pjesën jugore me Bashkitë Tiranë, Vorë dhe Durrës, përcaktimet e PINS Durana prekin drejtpërdrejtë këtë territor. Kryesisht efekti i këtyre përcaktimeve vepron në bashkinë Krujë.

Sipas këtij PINS, rajoni i Duranës trajtohet si motori më i rëndësishëm ekonomik i vendit, kjo për shkak të densitetit të lartë të popullatës dhe përqendrimit të lartë të aktiviteteve ekonomike me rëndësi kombëtare. Rajoni Durrës-Tiranë është nyja kryesore e ndërveprimit të burimeve njerëzore, mallrave, dhe hapësirave të jetueshme të veriut dhe jugut të Shqipërisë si dhe porta hyrëse e "Korridorit 8". Ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e rajonit luajnë dhe portat logjistike të pozicionuara në të; Porti Durrësit dhe Aeroporti "Nënë Tereza".

Rajoni "Durrës-Tiranë" është kontribuesi kryesor i zhvillimit ekonomik në rang kombëtar, si në numër biznesesh po njësoj dhe në shumëllojshmërinë e tyre, kjo falë prezencës së lartë në numër të institucioneve dhe numrit të lartë të dendësisë së banorëve në rajon si dhe pozicionimit të favorshëm gjeografik.

Skenari i zhvillimit të korridorit ekonomik të Duranës mbështetet mbi parimin e policentrizmit dhe krijimit të një Cluster-i ekonomik, i cili mbështetet mbi sektorë si inovacion, ndërtim, prodhim, përpunim. Ky dokument propozon Dendësimin e Diversitetit që kërkon të ruhet dhe shtohet shumëllojshmëria e bizneseve në këtë zonë duke incentivuar ndërlidhjen e tyre. Të nxiten "cluster-at" ekonomike të cilat mbështesin në formë ciklike njëra tjetrën, për ndërtimin e një ekonomie qarkulluese – "Circular Economy".

Në këtë sens, propozohet ky hierarkizim i qendrave urbane e rajoneve si në hartë. Vërehet pozicioni specifik që zë sidomos zona e Nikël-Bubq-it në këtë skenar ku konsiderohet si një pol kompetitiv për shkak të industrisë së përpunimit të drurit. Në skenarin e zhvillimit propozohet përforcimi i këtij karakteri duke propozuar një cluster ekonomike te bazuar ne ndërlidhjen e sektorëve te prodhimit e përpunimit te drurit me bujqësinë e transportet.

Në kuadër të hartimit të politikave të turizmit prej këtij dokumenti, bashkia Krujë kalon në një plan primar. Në këtë dokument theksohet se ndërlidhja e sektorëve të shërbimeve në ndikim të turizmit, nuk ka qenë e fokusuar në një strategji unifikuese për të brendashkruar: Natyrën - Historinë - Kulturën – Identitetin. Në këtë hartë jepen shërbimet e ofruara nga ky rajon. dhe ndërlidhjet mes Krujës dhe Elbasanit, si dy qendra me ndikim të lartë në turizëm me të gjitha qendrat e tjera të rajonit.
Ky dokument rekomandon që të synohet zhvillimi i Cluster-ave të kulturës përmes nxitjes së bashkëpunimit mes drejtorive sektoriale të kulturës, linjës së muzeve, agjencive turistike, hoteleve, restoranteve, zhvillimit të zejtarisë dhe artizanatit, komunitetit lokal që mbart vlera të kulturës jo materiale dhe të trashëgimisë së paprekshme, organizuesve të sporteve të aventurës apo organizatave të ngjitjeve në mal dhe alpinizëm, për një rrjet të përbashkët të promovimit të turizmit të qëndrueshëm dhe zhvillimit ekonomik.

Tokat bujqësore në rajon, kanë pësuar transformime të konsiderueshme në harkun kohor të njëzetë viteve të fundit ,si pasojë e aktivitetit njerëzor të pakontrolluar. Dëmtimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor në rajon ka prekur të gjithë elementët përbërës të tij duke ndërvepruar direkt mbi mjedisin në tërësi si dhe mbi jetën njerëzore. Politikat territoriale të deritanishme nuk munden të ruanin një zhvillim të qëndrueshëm në Sistemin e Urbanizimit Urban - Rural si pasojë e kërkesës për zhvillim në hapësira shërbimi dhe banimi, formale dhe informale. Sistemi i vaditjes së tokave bujqësore dhe sistemi i rezervuareve të rajonit si dhe ndërlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore janë dëmtuar rende nga



Fig. 9 PINS Durana, Hierarkia e Qendrave Urbane



Fig. 10 PINS Durana, Zhvillimi i Cluster-ave të kulturës e të turizmit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TIRANËS SEKRETARIA

mungesa e mirëmbajtjes si dhe nga dëmtimet njerëzore. Sistemi i magazinimit, përpunimit dhe ndërlidhjes të tregjeve rajonale është inekzistent si pasojë e zhvillimit të pakontrolluar dhe ndryshimit të destinacionit të përdorimit të godinave pas privatizimit të tyre në vitet 1990 . Sipërfaqet e tokave bujqësore në rajon u dëmtuan rëndë nga ndërtimet formale dhe informale, duke ndryshuar efiçiencën e tyre në shfrytëzim dhe

përdorim si dhe duke ndryshuar statusin e përdorimit të tokës.

Nëpërmjet një qasjeje që synon konsolidimin e zonave urbane, kontrollimin e densiteteve e funksioneve, ky dokument tenton rikuperimin e sistemit bujqësor.
Ndërkohë, afërsia me zonat e mbrojtura e brezat pyjore shkon në favor të forcimit të zhvillimit të integruar turizëm-natyrë-agrobiznes.
Një përmbledhje e përcaktimeve, objektivave dhe politikave që rrjedhin nga PINS Durana dhe që prekin territoret e bashkive të Lotit 1, paraqitet në vijim.

Objektivat strategjikë:

- Përmirësimi Infrastrukturës, Trasnsportit dhe Lëvizshmërise në Rajon. Zhvillimi i mobilitetit dhe optimizimi i lëvizshmërisë. Përmirësimi i Transportit Publik dhe i lëvizshmërisë me anë të biçikletave dhe për këmbësorë. Përmirësimi i rolit të Portit të Durrësit dhe Aeroportit "Nënë Tereza" për të përmirësuar aksesueshmërinë e rajonit në shkallë ndërkombëtare.

- Mbrojtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit Natyror. Ruajtja e Burimeve Natyrore dhe Mbrojtja e Mjedisit. Integrimi i sistemeve natyrore me dizajnin e infrastrukturës si dhe krijimi i rrjeteve të parqeve nga niveli lokal tek ai rajonal.

Politikat strategjike për zhvillim ekonomik mbështeten në:

- Konkurrueshmëria Rajonale. Rajoni Metropolitan është njohur si drejtues i sipërmarrjeve në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar dhe është suportuar me Pole/Zona/Korridore strategjike në punësim, duke ndihmuar shërbimet Urbane dhe Rurale. Këto zona zhvillimi janë mbështetur me korridore dhe porta (HUB-e) në transport, për të krijuar pole të përqëndruara për suportimin dhe diversifikimin e mundësive rajonale për tërheqjen e investimeve dhe IHD-ve nga sipërmarrjet dhe Clusterat e biznesit.

- Rritja e Qëndrueshme. Për të krijuar mirëqenie dhe zhvillim ekonomik për të gjithë shtresat e popullatës, nga promovimi i zonave ekonomike të identifikuara në rajon , për të përshpejtuar dhe lehtësuar mundësite e reja në punësim dhe për të mbështetur ato aktuale për banorët duke reduktuar volumin e paqëndrueshëm të transportit në distanca të largëta për punësim.

Politikat e zhvillimit:

- Zhvillimi Ekonomik dhe Konkurrueshmëria Rajonale. Objektivi primar i dokumentit është nënvizimi dhe fortësimi i drejtimit të konkurrueshmërisë ekonomike në rang ballkanik e mesdhetar, drejt rritjes së qëndrueshme. Për këtë synim rajoni duhet të përqëndrohet në këto sektorë: Njohuri dhe Dije, Investime në R&D, Inovacion, SME-të & Sipermarrja, Konkurrueshmëria.

- Inkubatorët si Katalizator Zhvillimi. Metropoli Tiranë – Durrës si një "Portë Ballkanike dhe Mesdhetare" duhet të ketë përfaqësimin e tij me anë të inkubatorëve të zhillimit të bizneseve si instrument përshpejtues për aktivizimin e inovacionit sekorial në industri të ndryshme.

- Zhvillimi i Cluster-ave Ekonomik. Cluster biznesesh i fokusuar në polin Aerport-Vorë-Kashar.

- Polet, Zonat dhe Korridoret e zhvillimit ekonomik. Rajoni Tiranë-Durrës është nyja kryesore e ndërveprimit të burimeve njerëzore, mallrave, dhe hapsirave të jetueshme të veriut dhe jugut të Shqipërisë si dhe porta hyrëse e "Korridorit 8". Ndër polet strategjike për zhvillimin ekonomik që lidhen me territorin e Lotit 1 mund të përmendim:

  - **Poli Kamëz – Nikël.** *Ky pol fokusohet në: Përpunimin e Drurit, Logjistikë, Tregtim / Përpunim, Materiale Ndërtimi / Industri e lehtë, Fasoneri, Gjysëm – Produkte Elitare Biznesi, Stadium Kombëtar (Olimpik), Shërbime Aeroportuale (Zonë ekonomike), Logjistikë*

- Turizmi i Qytetit dhe fundjavës "City Break". Në këtë politikë i jepet prioritet zhvillimit të turizmit ndërkombëtar nëpërmjet aeroportit dhe stimulimit të çmimeve të ulta të biletave, si dhe turizmit te brendshem rajonal duke krijuar oferte efiçente, cilësore dhe me shumllojshmëri zgjedhjesh. Në këtë kuadër, propozohen të zhvillohen polet rajonale të turizmit ku përfshihet sistemi natyror i lumit Ishëm, Parku Rajonal Ndroq – Kepi i Rodonit si dhe zona Prezë - Bubq.

- Policentrizmi dhe Hierarkizimi i Qendrave Urbane. Kjo politikë synon vendosjen e një hierarkie të qartë midis qendrave urbane të rajonit e cila do të lejojë specializimin dhe marrëdhënien komplementare të këtyre qendrave në raport me njëra tjetrën.

Në këtë kuadër, Fushë-Kruja shndërrohet në Qendër Lokale, e fokusuar në shërbimet logjistike dhe agro-industri. Përmirësim i hapësirave publike dhe sociale.

Shërbime publike në nivel lokal.

- Rigjenerimi i Poleve Urbane. Rigjenerimi i Poleve Urbane është njëri prej parimeve në krijimin e zonave urbane policentrike. Ai shmang përqëndrimin e shërbimeve të unifikuara ne qendrat monocentrike si dhe krijon kushte për zona të reja shërbimesh të diversifikuara në funksione dhe shërbime, për të ruajtur një balancë më të mirë të shpërndarjes së mirëqenies në hapsirat urbane.

- Zhvillimi Ekonomik Rural dhe polet e zhvillimit territorial. Zhvillimi i zonave rurale duhet të jetë i bazuar mbi ndërtimin e një vizioni të qartë ndërveprimi në rrjet , të mbështetur në bashkëpunimin me qëndrat primare. Në këtë kuadër, direktivat e PINS percaktojnë zhvillimin e ekonomive bujqësore të mëposhtme për territorin e Lotit 1:

  - *BUBQ: Bujqësi dhe blegtori*
  - *NIKËL: Dru-frutorë, Bujqësi e Blegtori*
  - *THUMANË: Bujqësi e Blegtori*



Fig. 11 PINS Durana, parashikimet për 5 sistemet territoriale

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARI

- Turizmi rural rajonal. Potencialet e përcaktuara nga PINS për Lotin 1 në turizëm rural, agro-turizëm, turizëm Det-Diell dhe turizëm natyror janë në:
  - o *Agro Turizëm: Laguna e Patokut*
  - o *Turizëm Det – Diell: Gjiri Lalëzit – Kepi Rodonit – Lugina Patokut*

- Brandimi dhe Marketimi i zonave Rurale. Brendimi dhe Marketimi janë nga elementët bazë në krijimin e Strategjisë së Markës & krijimin e Rajonit "Bio – Food" duke ndërthurur me Strategjinë e Zhvillimit rajonal si dhe me strategjinë e zhvillimit të Turizmit dhe Mjedisin.
- Rrjetet Rrugore Strategjike Rajonale. Rrjeti rrugor strategjik bazohet mbi efiçentimin e lidhjes së rajonit me akset kombëtare dhe ndërkombëtare. Rrjeti dhe hierarkia e akseve të propozuara do të mundësojnë akses të shpejtë dhe efiçencë të lartë të lëvizshmërisë së mallrave , banorëve dhe turistëve në rajon. Në këtë kuadër, lëvizshmëria multimodale me fokus primar transportin publik merr një rëndësi të veçantë.

- Lëvizshmeria Hekurudhore. Rajoni duhet të efiçentoj lëvizshmërinë hekurudhore në raport me lëvizjen me automjete ndërqytetëse duke zhvilluar stacionet Multi-Modale në akset primare të aksesueshme nga të gjitha shtresat shoqërore në qendrat urbane.

- Itinerare rajonal për lëvizjen me biçikleta. Itineraret e lëvizjes me biçikleta jashtë zonave urbane, duhet të jenë të përshtatur me korsi të specializuara, të kalojnë në zona larg lëvizjes së automjeteve për të bërë sa më të sigurt dhe sa me te këndshme lëvizjen me biçikletë. Në këtë kuadër, ndërlidhja e parqeve natyrore të Krujës dhe Tiranës është një itinerar rajonal mjaft atraktiv.

- Ruajtja dhe Menaxhimi burimeve ujore Mbi – Nen tokesore në rajon. Shëndrrimi i dy lumenjve Erzen & Ishëm në potenciale mjedisore dhe në "koorridore të gjelbërt" ndërlidhes për parqet e rajonit.

- Rezervat natyrore rajonale. PINS përcakton disa zona si rezerva natyrore rajonale: Korridori ekologjik i Lumit Ishëm, Zona e Mbrojtur Kepi i Rodonit – Patok – Fushëkuqe – Ishëm, Parku Rajonal Vaqarr – Kepi i Rodonit.

1.2.5 Drejtimet e zhvillimit sipas pesë sistemeve

Të dhënat dhe objektivat kryesore për zhvillimin e zonës sipas pesë sistemeve janë një përmbledhje e orientimeve të përbashkëta që dalin nga analizimi i PPK-së dhe Planeve ndërsektoriale që ndikojnë në zonat e përfshira në Lotin 1.

1.2.5.1 SISTEMI URBAN

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër. "Territori urban" është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor.

Objektivi kryesor: Rritja inteligjente
Politika: Zhvillimi policentrik, densifikimi, gjithëpërfshirja

Parimet mbi të cilat do bazohet Sistemi Urban:

- Zhvillim Policentrik hapësinor dhe nje marredhenie te re Urbane–Rurale

- Përcaktimi i zonave urbane prioritare, që të funksionojnë si nyjë lidhëse për fshatrat më pak të populluara dhe si lokalitet për shpërndarjen e shërbimeve.

- Kontroll i ekspansionit fizik te qyteteve dhe zonave të urbanizuara duke promovuar densifikimin në vend te shpërhapjes urbane;

- Përcaktimi i saktë i vijave te gjelbra kufizuese për zonat urbane, duke marrë parasysh legalizimin e zhvillimeve te deritanishme.

- Përcaktimin me vizion te zonave te zhvillimit te mëtejshëm në bazë te sugjerimeve te PPK-së dhe tendencave demografike.

- Hierarkizimin e qendrave dhe profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomikë te përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.

- Efiçensë energjetike dhe energji e rinovueshme

- Rivitalizimi i ballinave ujore ne te gjitha qendrat urbane dhe lokale ne bregdet, duke rritur kështu cilësinë e jetesës, përmes hapësirave publike.

- Promovimi i qendrave lokale dhe lokaliteteve jo vetëm turistike, me anë te vlerave arkitektonike, monumentale, tradicionale e natyrore që ato vetë kanë. Duke u nisur nga plani kombëtar, në nivel bashkie, PPV-ja duhet te përcaktojë:

- Qendrat primare, ne zonat e banuara me popullsi te stabilizuar dhe shërbime bazike te karakterit infrastrukturor, si elementë te hierarkisë lokale.

- Qendrat e specializuara, qe do te zhvillohen ne përputhje me potencialet e tyre dhe karakteristikat specifike te karakterit ekonomik

1.2.5.2 SISTEMI NATYROR

Sistemi natyror (N) përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura te natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë te përdorimit "natyre" dhe ne përputhje me legjislacionin e posaçëm.

Objektivi kryesor: Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit natyror.
Politika: Rritje e zonave te mbrojtura natyrore, promovimi dhe aksesi i tyre.

Targeti për 2030 i PPV-së do te synojë shtimin e sipërfaqes se zonave te mbrojtura 20 % per tokën dhe 12-15 % te sipërfaqes ujore. Ruajtja dhe shtimi i zonave te mbrojtura natyrore do te bëhet nëpërmjet:

- Vendosjes se prioritetit te perdorimit te Zonave te lira natyrore, me perparesi mjedisin.

- Krijimi dhe konsolidimi i Korridoreve lidhese Natyrore përgjatë luginave lumore, te cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme te sistemit te zonave te mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor.

- Zonat me rrezikshmëri natyrore ndaj njeriut si rrjedhim i erozionit, nivelit te larte sizmik, prezencës se materialeve te dëmshme per shëndetin, etj.

- Zonat e degraduara prej aktiviteti njerëzor, si punime minerare, depozitim mbeturinash, shfrytëzim i pa kriter i burimeve natyrore, etj. Te vendosen objektiva kohore per rikthimin e këtyre zonave ne gjendjen e mëparshme.

1.2.5.3 SISTEMI BUJQËSOR

Sistemi bujqësor (B) përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore te saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët ne shërbim te saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë te perdorimit te tokës "bujqësinë".

Objektivi kryesor: Efiçencë për një sektor bujqësor konkurrues

Politika: Ruajtje, konsolidim, modernizim.

Plani i Përgjithshëm Vendor do te bazojë ndarjen e territorit te Sistemit bujqësor sipas këtyre objektivave:

- Ruajtje maksimale e fondit te tokës bujqësore, me ane te politikave te densifikimit te zhvillimit urban. "Asnjë ndërtim i ri ne toke bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor".

- Vendosja e nje rrjeti te suksesshëm te zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim – grumbullim – përpunim - eksportim, me qëllim rritjen e vlerës se zinxhirit ekonomik.

- Krijimi i qendrave te specializuara bujqësore dhe profilizimi i tyre sipas karakteristikave te prodhimit lokal.

- Specializim ne prodhim dhe perpunim te produkteve dhe produkteve karakteristike te zonës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

1.2.5.4 SISTEMI UJOR

Sistemi ujor (U) është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës "ujë".
Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;

- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujor;

- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda se cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Plani i Përgjithshëm Vendor për Sistemin Ujor orienton drejt këtyre objektivave:

- Prioritet maksimal mbrojtjes së burime hidroenergjetike të zonës.

- Përcaktimin e vijës blu, të mbrojtjes së sipërfaqeve hidrike dhe fashat mbrojtëse të kërkuar nga ligji.

- Evidentimi i zonave të rrezikshme për njeriun si rezultat i përmbytjeve, ose që janë në rrëgjim kënetor

- Përcaktimi i zonave të përshtatshme për zhvillim turistik ujor

- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin e peshkimit dhe infrastrukturës së nevojshme.

Korridoret e gjelbra

Integrimi i luginave të lumenjve është menduar të realizohet nëpërmjet burimeve të tjera natyrore, në mënyrë që të kryhet vlerësimi i lumenjve me pamje të mirë peizazhistike, duke i cilësuar ato si korridore të gjelbra që mundësojnë lidhjen e vendeve të ndryshme me njëri-tjetrin; lidhjen e vlerave natyrore, kulturore, liqenet, monumente historike, vendbanime me vlera arkitektonike, fshatra historikë, lagunat, plazhet, etj., duke filluar nga vija bregdetare deri në pjesën e brendshme të territorit.

Pra luginat e lumenjve, do të shërbejnë si:

- Korridoret e gjelbër do të kenë funksionin e zonave bllokuese për kufizimin e shtrirjes urbane dhe gjithashtu të krijojnë mundësinë për përdorime rekreative të hapësirave publike.

- Këto "kanale natyrore", do të përdoren për lëvizjen e turistëve nga një zonë e mbrojtur, në tjetrën.

- Si zona të përshtatshme për ecje, çiklizëm apo sport.

Planet e bashkisë duhet të përcaktojnë gjithashtu edhe zonat me rreziqe mjedisore, si rrëshqitjet, erozioni, zonat e rrezikuara nga përmbytjet në vijën bregdetare. Gjithashtu, ato duhet të përcaktojnë parametrat e ndërtimeve të reja, në afërsi të këtyre korridoreve, për rastet që aty pranë mund të ketë lokalitete të zhvilluara, në mënyrë që të parandalohen dëmet që këto ndërtime mund të shkaktojnë.

1.2.5.5 SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Sistemi infrastrukturor (IN) përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës "infrastrukturë".

Objektivi kryesor: Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmerisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar te flukseve.

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një Sistemi te integruar multimodal mbarë kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave te aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Objektivat e tjera të PPV-së së në lidhje me sistemin infrastrukturor janë:

- Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave urbane.
- Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave prioritare, si qendra që ofrojnë shërbime publike të specializuar e të avancuara.

- Promovimi i transportit publik qytetas dhe ndërqytetës si transport alternativ nëpërmjet infrastrukturës së butë, rrugë për biçikleta dhe këmbësorë.

- Rinovimi i hekurudhave ekzistuese, duke vendosur sistemin elektrik për transportin hekurudhor.

- Klasifikimi rrjetit rrugor ekzistues dhe të parashikuar në:
  - rrjet të kategorisë I
  - rrjet të kategorisë II
  - rrjet të kategorisë III

- Përcaktimi i "Vijës së kuqe" ose vijës së ndërtimit të rrugës për çdo tip rrjeti dhe korridori të përfshirë në Sistem. Vija e kuqe është kufiri i lejuar për vendosjen e një ndërtimi në anët e trupit të rrugës që i referohet ose vija kufizuese e të gjithe brezave mbrojtës, si p.sh., brezat mbrojtës të përcaktuar nga Kodi Rrugor, të zonave të mbrojtura nga legjislacioni i mjedisit, kulturës, energjisë etj., si edhe breza mbrojtës të përcaktuar nga dokumentet e planifikimit.

1.2.5.6 TURIZMI

Nga vlerësimi i të gjitha tipologjive të turizmit, në këtë plan të integruar ndërsektorial të bregdetit, prezantohen në 6 grup-ndarjeje, të cilat janë konsideruar si më të rëndësishmet për zonën e bregdetit të Shqipërisë, për nga pesha e lartë që ato zënë dhe kontribuojnë në PBB - së aktuale të Shqipërisë dhe të bregdetit, dhe për perspektiven e rritjes që ato paraqesin për të ardhmen, 2030.



Fig. 12 PINSB – Infrastruktura

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

- Turizmi kulturor duke shfrytëzuar potencialet e mëdha të historisë dhe kulturës së pasur shqiptare në të gjithë territorin e saj.

- Turizmi natyror/ekoturizëm, dhe turizmin rural si produkt i vogël turistik por që po zhvillohet me shpejtësi; përfshirë atraksionet turistike natyrore, si: malet, parqet kombëtare, peizazhet tërheqëse, florën dhe faunën unike të ekosistemeve të ndryshme, liqenet lumenjtë dhe fshatrat tipikë me jetë autentike rurale, produkte agro biodiversiteti që ofrohen dhe promovohen përmes turizmit.

- Agroturizëm, i cili bazohet jo vetëm tek produktet lokale biologjikisht të pasura me vlera të larta ushqyese, që i ofrohen turistit kombëtar dhe atij ndërkombëtar lidhur me sektorët e bujqësisë e blegtorisë, por edhe tek produktet e përpunuara për t'i transformuar ato në edhe në variete më të pasura, tipike të kulinarisë tradicionale shqiptare.

- Turizmi malor, si pjesë përbërëse e rëndësishme e turizmit natyror-rural, rrit ofertën turistike të Shqipërisë në nivele më të larta, duke konsideruar faktin se pjesa më e madhe e territorit të Shqipërisë është territor malor. Ky llloj turizmi nuk është i aksesueshëm vetëm në stinë dimërore, për ecje, ngjitje në mal kur bie dëborë, apo dhe për sportet si ski, ngjitje, ecje sportive, etj., por edhe gjatë sezoneve të tjera, si; pranverë, vjeshtë, dhe verë për të praktikuar ecjen sportive, shëtitje me biçikleta, kamping në mal, hipizëm, alpinizëm, etj.

- Turizmi i sporteve të ndryshme. Territori i Shqipërisë, me karakterin e tij shumë të alternuar për nga relievi dhe pasuritë natyrore, ofron mundësinë e zhvillimit të të gjitha llojeve të sporteve, të cilat nisin nga ato të një niveli të lehtë për tu aplikuar (noti, lundrimi, në det, lumenj, liqene, ecje, çiklizëm, hipizëm, golf, tenis, etj.) e deri tek aplikimi i sporteve ekstreme, për nga vështirësia e tyre (hedhje me parashutë, gara me makina nëpër terrene të vështirë, zhytje, ski, snowboard, alpinizëm, etj.).

Në territorin e bashkisë Krujë gjejnë vend pothuajse të gjitha tipologjitë e turizmit të përcaktuara më sipër. PPV e bashkisë, në përshtatje me territorin ku shtrihet dhe në përputhje me



Fig. 13 Kategorizimi i turizmit sipas PINSB

mundësitë e zhvillimit të tipologjive të ndryshme të turizmit, do bëjë propozime konkrete për fuqizimin e atyre lokalitete ku aktualisht ka aktivitet turistik dhe promovimin e zonave apo qendrave të tjera të cilat mbartin potencial turistik por për arsye të ndryshme nuk janë të vizitueshme aktualisht.
Në kapitullin e fundit të këtij dokumenti, që ka lidhje me Veprimet Strategjike dhe Projektet e Zhvillimit një fokus i veçantë i është dhënë dhe turizmit. Përveç promovimit të aseteve turistike që aktualisht gjenden në këtë territor konstatohet e domosdoshme rritja e aksesit të tyre përmes infrastrukturës rrugore me impakt të ulët mjedisor. Si përfundim mund të themi që të gjitha propozimet strategjike kanë lidhje, direkte ose indirekte, me zhvillimin e tipologjive të ndryshme të turizmit në këtë zonë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.3 VIZIONI STRATEGJIK NË SHKALLË TË GJERË

1.3.1 Analiza dhe interpretimi i tendencave socio-ekonomike

1.3.1.1 Analiza e situatës ekonomike sipas sektorëve kryesorë të prodhimit

Sipas Bankës Botërore (BB) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Shqipëria klasifikohet si vend në zhvillim dhe me të ardhura të mesme dhe të larta dhe është një opinion i përhapur se Shqipëria ka një potencial të madh për rritjen ekonomike dhe për integrimin progresiv me ekonomitë e Bashkimit Europian (BE), mes të cilëve Italia, e cila është edhe partneri më i madh ekonomik i saj.

Kushtet ekonomike të popullsisë variojnë sipas zonave, me popullsinë rurale që karakterizohet nga një varfëri e përhapur, gjë që ka krijuar flukse migrimi të brendshëm nga zonat rurale drejt atyre urbane. Përqindja zyrtare e papunësisë së forcës punëtore, që rrotullohet rreth vlerës 17% në vitet e fundit, nuk është më e keqe se ajo e vendeve me ekonomi të avancuar të hapësirës evropiane, por fsheh një nën-punësim (punësim në nivel jo të plotë) të resurseve njerëzore shqiptare.

Fig. 14 Rritja e PBB për frymë, 2006-2014



Fig. 15 Treguesit e papunësisë (%) 2013 - 2016

Ekonomia është e karakterizuar edhe nga përhapja e aktiviteteve informale (të mbuluara), të cilat dalin jashtë kontrollit të organeve shtetërore dhe sistemit të taksimit. Pikat më të forta të ekonomisë janë: kosto e ulët e fuqisë punëtore; pasuria në lende të para (kryesisht në minerale dhe resurse ujore); pozicioni gjeografik strategjik në qendër të Mesdheut; sistemi i taksave i cili është ulët në krahasim me vendet e afërta të Bashkimit Evropian. Këto elemente që përbëjnë avantazhe konkurruese kanë dhënë frytet e tyre falë reformave të bëra nga fundi i viteve '90. të cilat kanë prodhuar një rritje me ritme të larta të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) deri në vitin 2008, vit i fillimit të krizës financiare dhe ekonomike ndërkombëtare, e cila është akoma në vazhdim, siç tregojnë të dhënat më poshtë (burimi FMN):

- fragmentimi i lartë i pronësisë së tokave bujqësore, me sipërmarrje bujqësore me karakter familjar dhe të dedikuara kryesisht prodhimeve për përdorim vetjak;

- mungesa e infrastrukturave logjistike për grumbullimin, magazinimin dhe transportin e prodhimeve;

- kredidhënia e ulët nga ana e bankave, shpeshherë deri në mungesë totale, për sipërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla, të cilat përbëjnë bazën prodhuese të vendit (rreth 99% e tyre ka një numër punëtoresh të përfshirë mes 1 dhe 4 vetë);

- mungesa e menaxhimit të duhur të cikliit të mbetjeve dhe niveli i lartë i ndotjes, të cilët frenojnë shfrytëzimin turistik të

Viti	2000	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
rritja e PBB në %	6,66	5,43	5,9	7,53	3,35	3,71	2,55	1,42	1,11	2,17

Tabela 1: Rritja e PBB 2000-2014

Në vitet pasardhëse rritja e PBB ka pësuar një frenim progresiv, deri në vitin 2014 pas të cilit pritet një rritje e moderuar por graduale, sipas parashikimeve të bëra nga BB.
Është për t'u nënvizuar se këto parashikime, edhe pse janë pozitive, janë të karakterizuara nga një pasiguri e lartë, si për prezencën e problemeve strukturore të ekonomisë ashtu edhe për urgjencën dhe pasigurinë ekonomike ndërkombëtare e cila nuk është e favorshme. Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, vendi ka bërë hapa të mëdhenj në arritjen e kushteve të një ekonomie tregu moderne, por mbeten të pazgjidhura disa pika kritike të cilat frenojnë zhvillimin ekonomik të vendit.

Mes tyre, ato më të rëndësishmet janë:

- pasiguria e të drejtës mbi pronat e shpërndara pas rënies së regjimit komunist, të cilat krijojnë një konfliktualitet të lartë gjyqësor mes popullsisë si edhe paraqesin rrezik për investimet private;

- bregdetit dhe zhvillimin e një bujqësie ekologjike me një vlerë të lartë të shtuar;

- mungesa e infrastrukturave të tjera në shumë zona, siç janë rrjetet e kanalizimeve dhe të shpërndarjes së ujit të pijshëm, rrjeti rrugor, rrjeti hekurudhor (tashme pothuajse jashtë përdorimit) etj.

Për këto arsye, perspektivat e zhvillimit të vendit duken së kanë një potencial të lartë por edhe një nivel të lartë pasigurie; në mënyrë që të realizohen, është e nevojshme që të plotësohet procesi i transformimit institucional dhe i modernizimit strukturor në të cilin vendi duket aktualisht i përfshirë.

Pikave kritike strukturore të ekonomisë, i janë shtuar dëmet e shkaktuara nga kriza ekonomike ndërkombëtare e vitit 2008, e cila ka prekur Shqipërinë në dy drejtime: ka pësuar një rënie të dukshme të eksporteve, si rezultat e krizës së të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA KOMBËTARE E PYLLIT TIRANË SEKRETARIA



Fig. 16 Bilanci i tregtisë, Prill 2015 – Mars 2016

ardhurave dhe të kërkesës ndërkombëtare; dhe njëkohësisht ka vuajtur një tkurrje të remitancave të emigrantëve, të cilat kanë kaluar nga 12-15% e PBB para vitit 2008, në 7% në vitin 2012 dhe në pak më tepër se 5% në vitin 2013. Remitancat përbejnë një burim primar të resurseve financiare të vendit, të ardhura kryesisht nga shqiptare të emigruar në Itali dhe Greqi, të cilët përbëjnë rreth 20% të të gjithë forcës punëtore shqiptare.

Ndërkohe, importet në Shqipëri nuk kanë pësuar rënie dhe shkëmbimet me jashtë vazhdojnë të pësojnë një rritje të deficitit të veprimeve dhe një rritje të deficitit të baraspeshës tregtare, të cilat nuk balancohen nga një fluks i mjaftueshëm i remitancave nga jashtë.

Rritja e vazhdueshme e borxhit të jashtëm publik të vendit ka shtyre BB të sugjerojë ndërhyrje për uljen e deficitit të baraspeshës së pagesave dhe për uljen e borxhit publik (që, sipas BB, duhet të zbresë deri në 30-40% të PBB). Nga ana tjetër qeveria shqiptare ka vendosur të rrisë shpenzimin publik, duke çuar nivelin e borxhit publik përtej kufirit të 70%.

Kjo politikë fiskale zgjeruese (ekspansive) pritet te ketë efekte pozitive në rritjen ekonomike, por roli i saj varet nga efikasiteti i ndërhyrjeve të cilat kanë si qellim tejkalimin e problematikave të lartpërmendura.

Sektorët prodhues

Rreth 80% e ekonomisë shqiptare përbëhet nga sipërmarrje private, të cilat arrijnë rreth 120 mijë njësi, nga të cilat 99% janë me dimensione shumë të vogla (1-4 punëtorë).

Duke filluar nga vitet e para të këtij shekulli, sektori i shërbimeve (tërësor) është kthyer në një sektor dominues mbi atë primar (bujqësi, blegtori), i cili vuan problematikat e përshkruara më lart, dhe mbi atë industrial, i cili nuk

Fig. 17 Niveli i Borxhit Publik në raport me PBB, 2006-2015

është shumë i zhvilluar. Sektori terciar (i shërbimeve) përbën rreth 84% të sipërmarrjeve ekzistuese në Shqipëri dhe kontribuon për 52,19% të PBB. 52% e sipërmarrjeve të sektorit të shërbimeve operon në sektorin e tregtisë, 12% në atë të transporteve dhe telekomunikacionit dhe pjesa tjetër prej 17% ofron lloje të tjera shërbimesh. Nga ana tjetër, ndërmarrjet prodhuese përbëjnë vetëm 16% të totalit, nga të cilat 62% janë në sektorin artizanal, 27% në sektorin e ndërtimit dhe 11% në atë të bujqësisë dhe peshkimit.

Bujqësia

Në Shqipëri bujqësia ka luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Me gjithë rritjen e shpejtë të viteve të para të shekullit, e trajnuar edhe nga sektori i shërbimeve, bujqësia ka vazhduar të ndikojë për më shumë se 20% të PBB, duke punësuar më shumë se 40% të fuqisë punëtore të vendit.



Fig. 18 Shpërndarja e PBB në sektorët ekonomikë 2004-2014.



Fig. 19 Punësimi sipas sektorëve ekonomikë 2000 - 2010

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË QYTETIT
TIRANË
SEKRETARIA

2000	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
35,90	26,49	20,22	19,87	19,42	19,40	20,65	20,95	21,66	22,50	22,64

Tabela 2: Bujqësia, vlera e shtuar (% e PBB)

Ky sektor përdor rreth 1.100.000 m² terren bujqësor, nga të cilët tokat me bonitet të mesëm dhe të lartë shfrytëzohen me kultura të mbjella, rreth 584.000 m² dhe me kultura të përhershme për 123.000 m², ndërsa pjesa që mbetet prej 450.000 m², me pjellori të ulët, përdoren si kullota. Përafërsisht, gjysma e popullsisë (1 milion nga 4,2 milion brenda dhe jashtë kufijve) jeton në zona rurale, me gjithë emigrimin e madh, të regjistruar në vitet e fundit, drejt qendrave të mëdha urbane.

Drithërat janë kultura kryesore dhe zënë rreth 40% të sipërfaqeve të mbjella. Prodhimet e tjera kryesore të vendit janë frutikultura, e cila përbën 19% të prodhimit bujqësor, patatet dhe panxhari i sheqerit. Në rritje të shpejtë janë vreshtaria dhe prodhimet e ullirit, të cilat paraqesin perspektiva të mira integrimi me sektorin agro-industrial. Blegtoria, e përqendruar kryesisht në zonat malore, është kryesisht e tipit dele dhe pula, respektivisht me 1.850.504 dhe 9.065.000 krerë. Ndjekin më pas mbarështimi i dhive, me 883.000 krerë dhe ai i lopëve, me 468.100 krerë (të dhëna të vitit 2013).

Prodhimi bujqësor në Shqipëri realizohet pothuajse tërësisht, nga sipërmarrje të dimensioneve të vogla me drejtim familjar, të cilat përdorin parcela toke, mesatarisht, rreth 1.2 ha secila dhe me rreth 90% të parcelave më të vogla se 2 ha. Ky fragmentim i strukturës prodhuese është dobësia kryesore e sektorit, por jo e vetmja. Ashtu si ekonomia shqiptare edhe bujqësia vuan të gjitha problematikat e listuara më sipër. Dimensionet e vogla të ndërmarrjeve bujqësore pengojnë shfrytëzimin e ekonomive të shkallës së gjerë (uljen e kostove mesatare dhe rritjen e prodhimit) gjë që arrihet me ndërmarrje të dimensioneve të përshtatshme: 1,2 ha mund të mjaftojnë për rritjen (kultivimin-mbarështimin) e bleteve por, për prodhime të mbjellash, dimensioni i pranueshëm është të paktën 10 herë më i madh. Copëzimi i prodhimit, bashkuar me mungesën e koordinimit mes ndërmarrjeve, krijon luhatje të çmimeve si pasojë e alternimit të tepricës dhe mungesës së ofertës së produkteve. Drejtimi familjar i mikro-ndërmarrjeve, që bëhet pa një kontabilitet të përshtatshëm sipërmarrës, vështirëson aksesin ndaj kredimarrjes (e cila është gjithsesi mjaft e vështirë) dhe pengon futjen e formave të mbrojtjes së të ardhurave të bujqësisë, siç janë sigurimi ndaj rreziqeve natyrore dhe të tregut. Gjithashtu, mungesa e rrugëve të asfaltuara në zonat rurale, mungesa e vend grumbullimeve dhe magazinave frigoriferike, mungesa në territor e ndërmarrjeve agro-industriale për përpunimin e produkteve bujqësore, janë pengesa të forta për zhvillimin e mundshëm të bujqësisë shqiptare. Megjithatë, **sektori bujqësor shqiptar mbetet një sektor me një potencial shumë të madh, falë disa faktorëve:**

- **pozita gjeografike dhe klima** lejojnë zgjerimin e gamës së produkteve të ofruara në tregun evropian me çmime konkurruese;

- **pasuritë e mëdha ujore dhe ekzistenca e një rrjeti kanalesh vaditës dhe kullues** (që pjesërisht duhen rikuperuar);

- **mosha mesatare e popullatës që merret me bujqësi është mjaft e ulët**, me gjithë fenomenin e theksuar të migrimit;

- **rritja e sektorit të turizmit në vend, faktike dhe potenciale, dhe integrimi i tij me bujqësinë dhe agro-turizmin** mund të favorizojë përhapjen e prodhimeve lokale dhe rajonale. Prezenca, gjithmonë në rritje, e investitorëve të huaj, veçanërisht italianë, ne rolin e tyre të dyfishte si porositës dhe financues të prodhimit, e cila lejon krijimin e ekonomive të shkallës, tejkalimin e pengesave të mungesës së likuiditetit për financimin e prodhimit (mungese krediti) dhe përshtatjen e prodhimit bujqësor shqiptar me kërkesat e cilësisë dhe gjurmueshmërisë së prejardhjes së kërkuara nga normativat evropiane.

Për këto arsye, sektori bujqësor, bashke me atë turistik, është resursi kombëtar më i rëndësishëm. Zhvillimi i tij potencial, i kushtëzuar nga tejkalimi i problematikave të sipërpërmendura, mund të shërbejë si motor për rritjen dhe modernizimin e vendit.

Industria

Industria shqiptare kontribuon për rreth një të katërtën e prodhimit të brendshëm bruto.

Aktiviteti industrial është i përqendruar në pak sektorë: siderurgjik, kimik, minerar, mekanik, tekstil dhe i këpucëve. Eksporti i produkteve industriale, i matur në vitin 2013 (në milion dollarë amerikanë USD), pasqyron rëndësinë e secilit prej sektorëve për ekonominë kombëtare: nafta dhe derivatet (619 mln), veshmbathje dhe aksesore (325 mln), këpucë dhe pjesë të tyre (320 mln), hekuri dhe çeliku (206 mln), kromi (91 mln), çimento (68 mln), produkte metali (53 mln), materiale elektrike dhe elektronike (49 mln). Sektori tekstil dhe ai i këpucëve ka përfituar nga delokalizimi i ndërmarrjeve italiane të cilat, në dhjetëvjeçarin e fundit, kanë transferuar në Shqipëri njësitë e tyre të prodhimit për të përfituar nga kosto e ulët e fuqisë punëtore dhe niveli i ulët i regjimit fiskal.

Pjesa më e madhe e stabilimenteve industriale përqendrohet në metropolin industrial Tiranë-Durrës.

Sektori industrial i cili, më shumë se të tjerët, duket se ka perspektiva të mira për një zhvillim të shpejtë, është ai hidroelektrik. Shqipëria ka një sipërfaqe ujore prej rreth 44.000 km², nga të cilat shfrytëzohen vetëm 35%, me një fuqi prodhimi prej rreth 1500 MW, dhe një volum rezervash, akoma të pashfrytëzuara, prej rreth 3000 MW.

Shërbimet dhe turizmi

Si pasojë e zhvillimit të dobët të sektorit industrial dhe efiçencës së ulët të sektorit primar, ekonomia shqiptare është kryesisht e orientuar drejt sektorit terciar, me sektorin e shërbimeve që kontribuon për më shumë se gjysmën e prodhimit të brendshëm bruto:

Megjithëse pjesa e PBB e sektorit të shërbimeve nuk është rritur, në dekadën e fundit sektori terciar (i shërbimeve) ka pasur zhvillime interesante: (i) është rritur dhe është përmirësuar një pjesë e sektorit terciar tradicional, falë rritjes së sektorit të turizmit, me efekte të dukshme në numrin e shërbimeve tregtare, në restoracion (restorante) dhe strukturat e akomodimit (hotelerisë); (ii) është shfaqur një sektorit terciar i avancuar që vazhdon të rritet, falë edhe prezencës së një numri të madh të rinjsh shqiptarë që janë diplomuar në universitetet evropiane dhe në Amerikën e veriut dhe kanë një njohje të mire të gjuhëve të huaja (kryesisht italisht dhe anglisht).

Sektori turistik shqiptar ka pësuar një rritje graduale duke filluar nga fundi i viteve '90, dhe është bërë mjaft i rëndësishëm në vitet e fundit. Numri i turisteve të huaj ka kaluar nga 500.000 në vitin 2005 në 4,2 milion në vitin 2015, me një shpenzim mesatar për turist të vlerësuar rreth 80 euro. Falë këtij zhvillimi eksponencial të xhiros së sektorit, turizmi tashmë kontribuon për më shumë se 10% të

2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
23,5	22,8	22,00	26,40	25,33	29,02	28,21	28,69	28,15	26,45	26,36	25,15

Tabela 3: Industria, vlera e shtuar (% e PBB)

2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
56,80	53,37	54,79	51,55	52,37	50,65	50,88	51,88	51,12	52,19

Tabela 4: Shërbimet, vlera e shtuar (% e PBB)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I ZHVILLIMIT TË TERITORIT TIRANË SEKRETARIA

PBB, duke llogaritur edhe ndikimin që shkakton për tregtinë dhe restoracionin. Vlerësohet se, në vitin 2013, sektori ka prodhuar një fluks hyrjesh nga turistët e huaj prej rreth 1,67 milion USD.

Pasuritë natyrore, arkeologjike dhe kulturore të vendit, gjerësisht të përshkruara në këtë raport, janë një resurs i rëndësishëm dhe shfrytëzimi i tyre komercial është padyshim i destinuar të rritet, falë edhe investimeve të operatorëve të huaj, kryesisht italianë.

Megjithëse pjesa e PBB e sektorit të shërbimeve nuk është rritur, në dekadën e fundit sektori terciar (i shërbimeve) ka pasur zhvillime interesante: (i) është rritur dhe është përmirësuar një pjesë e sektorit terciar tradicional, falë rritjes së sektorit të turizmit, me efekte të dukshme në numrin e shërbimeve tregtare, në restoracion (restorante) dhe strukturat e akomodimit (hotelerisë); (ii) është shfaqur një sektorit terciar i avancuar që vazhdon të rritet, falë edhe prezencës së një numri të madh të rinjsh shqiptarë që janë diplomuar në universitetet evropiane dhe në Amerikën e veriut dhe kanë një njohje të mire të gjuhëve të huaja (kryesisht italisht dhe anglisht).

Sektori turistik shqiptar ka pësuar një rritje graduale duke filluar nga fundi i viteve '90, dhe është bërë mjaft i rëndësishëm në vitet e fundit. Numri i turisteve të huaj ka kaluar nga 500.000 në vitin 2005 në 4,2 milion në vitin 2015, me një shpenzim mesatar për turist të vlerësuar rreth 80 euro. Falë këtij zhvillimi eksponencial të xhiros së sektorit, turizmi tashmë kontribuon për më shumë se 10% të PBB, duke llogaritur edhe ndikimin që shkakton për tregtinë dhe restoracionin. Vlerësohet se, në vitin 2013, sektori ka prodhuar një fluks hyrjesh nga turistët e huaj prej rreth 1,67 milion USD.

Pasuritë natyrore, arkeologjike dhe kulturore të vendit, gjerësisht të përshkruara në këtë raport, janë një resurs i rëndësishëm dhe shfrytëzimi i tyre komercial është padyshim i destinuar të rritet, falë edhe investimeve të operatorëve të huaj, kryesisht italianë.

1.3.1.2 Situata aktuale dhe perspektivat ekonomike të bashkisë

"Demografia Ekonomike" e bashkisë, paraqet një analizë të detajuar të aktiviteteve ekonomike që gjenden në territor, të potencialit dhe të pikave të tyre kritike. Në këtë kapitull bëhet një analizim i situatës aktuale dhe e perspektivave të zhvillimit bazuar në kapitujt e lartpërmendur të këtij dokumenti.

KRUJA

Numri më i madh i sipërmarrjeve në territorin e bashkisë përqendrohet në sektorin bujqësor, i cili numëron 9.851 ndërmarrje të cilat përdorin 13.218 ha tokë, që përbën rreth 40% të territorit. Nga kjo e dhënë del se mesatarisht, dimensioni i tokës së përdorur nga secila njësi prodhuese është pak më i lartë se 1,3 ha, një e dhënë e përafërt kjo me mesataren kombëtare. Sektori bujqësor i Krujës paraqet të njëjtat problematika dhe të njëjtat potenciale me atë kombëtar.

Zooteknia, e cila nuk është shumë e zhvilluar, kryesisht përbëhet nga mbarështimi i lopëve, deleve dhe dhive, ndërkohë që gjendet vetëm një ndërmarrje e cila merret me mbarështimin e pulave dhe që ndodhet në njësinë Fushë-Krujë. Fakt interesant është prezenca jo e vogël e vreshtave dhe ullishtave, prodhimi i të cilave paraqet një mundësi për vlerësimin e produkteve lokale dhe bëhet shkas për zhvillimin e ndërmarrjeve lokale të përpunimit të produkteve bujqësore. Ashtu si në pjesë të tjera të vendit, bujqësia në zonën e Krujës paraqet potenciale të mëdha, por zhvillimi i tyre varet në mënyre rrënjësore nga efikasiteti i ndërhyrjeve strukturore dhe i politikave qeveritare për modernizimin e sektorit.

Industria e bashkisë Krujë përbëhet kryesisht nga industria e nxjerrjes së inerteve dhe gurëve gëlqeror, prodhimi i çimentos dhe mermerit si dhe përpunimi i drurit. Pjesa më e madhe e këtij prodhimi i drejtohet sektorit të brendshëm të ndërtimit, që përbëhet nga rreth 30 firma. Sektori i ndërtimit, nga ana e tij, paraqet një trend rritjeje në nivel kombëtar dhe mendohet të ketë të njëjtën ecuri edhe në nivel lokal.

Perspektivat e këtij sektori duken të qëndrueshme, me mundësi për një rritje të lehtë.

Sektori i shërbimeve dhe i tregtisë duket i baraspeshuar me popullsinë lokale dhe nuk paraqet ndonjë element të veçantë me rëndësi. Sektori turistik, nga ana tjetër, paraqet mundësi zhvillimi me interes, si përgjatë bregdetit ashtu edhe me lidhjen e këtij të fundit me resurset turistike të territorit të brendshëm dhe malor.

1.3.2 Propozimi i përgjithshëm strategjik

Sistemi territorial, i përfshirë në territorin e bashkisë në studimi, mund të konsiderohet si homogjen nga pikëpamja e strukturës së mjedisit. Nga bregdeti drejt pjesës së brendshme të territorit dallojmë:

- **zona bregdetare**
- **ultësira bujqësore**
- **korridori infrastrukturor**
- **sistemi urban përgjatë rrëzë vargmaleve**
- **zona malore përballë detit dhe ajo e brendshme**

Termi "peizazh" është përdorur këtu në kuptimin e tij strategjik të projektimit, si njësi e territorit e karakterizuar nga kushte homogjene nga pikëpamja: (i) e karakteristikave gjeografike, morfologjike dhe hapësinore; (ii) e vendbanimeve njerëzore dhe e përdorimeve kryesore të tokës; (iii) e perspektivës pragmatike dhe e administrimit të transformimeve.

ZONA BREGDETARE

Zona bregdetare përfshin tërësinë e territoreve të ndryshme të tokave, të karakterizuara nga lagunat dhe zonat e gjera moçalore (ligatina, këneta) të alternuara me shirita të shkurtër plazhesh ranore, gjithmonë me interes të lartë mjedisor dhe peizazhistik dhe që mbrohen në forma të ndryshme.

ULTËSIRA BUJQËSORE

Ultësira bujqësore është e karakterizuar nga morfologjia fushore dhe nga rrjeti i kanaleve kulluese dhe vaditëse, të cilat bëjnë që ky territor të jetë pjellor. Gjithashtu ky territor sot është i karakterizuar në disa zona nga fenomeni i shpërhapjes urbane (sprawl).

KORRIDORI INFRASTRUKTUROR

Korridori infrastrukturor, që përshkon në mënyre gjatësore ultësirën bujqësore, përmban infrastrukturën kryesore rrugore me akse me shpejtësi të lartë lëvizjeje, element shumë tërheqës për pozicionimin e aktiviteteve prodhuese të tipit industrial dhe tregtar.

Fig. 20 Evidentimi i pesë peizazheve në zonën e gjerë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARI

SISTEMI URBAN RRËZË VARGMALEVE

Sistemi urban përgjatë rrëzës së vargmaleve përbëhet nga vargu i qendrave urbane të pozicionuara përgjatë rrugës së vjetër kombëtare (të lidhur mes tyre edhe nga hekurudha), si rezultat i mënyrës historike të pozicionimit të qendrave urbane në një kohë kur ultësira nuk ishte një mjedis i përshtatshëm për jetën e njeriut.

ZONA MALORE

Zona malore përfshin, si faqen perëndimore të vargmaleve që zbret drejt zonës fushore, ashtu edhe luginat që gjenden në pjesën e brendshme të territorit, të cilat në kompleks përfaqësojnë një rezervë traditash etno-kulturore dhe natyrore, që duhen ruajtur dhe, sipas rastit, duhen përdorur me qëllime turistike, në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit.

Ky klasifikim i peizazheve kryesore, i bërë vetëm me qëllim strategjik programi, nuk përfshin disa "përjashtime" lokale, të cilat duhen pranuar për të pasur një analizë sa më të plotë:

- peizazhi i kodrave të Krastës (në bashkinë Krujë) i karakterizuar nga prania e shumë guroreve, si në shfrytëzim ashtu edhe të braktisura.

- peizazhi i qytetit të Krujës, i cili për vetë pozicionin gjeografik, përbën një rast të jashtëzakonshëm dhe të veçuar nga sistemi urban përgjatë rrëzës së vargmaleve.

Shpeshherë vazhdimësia e peizazheve zhvillohet pa pasur një bashkëveprim mes tyre. Secili nga peizazhet duket i shkëputur dhe nuk komunikon me të tjerët, duke hequr dorë nga zhvillimi i atyre bashkëveprimeve që do të ishin lehtësisht të aktivizueshme nëpërmjet marrëdhënies frytdhënëse të plotësimit të ndërsjellë të njeri-tjetrit.

Interpretimi i këtij territori, për fasha funksionale paralele me bregdetin, nuk nxjerr në pah mundësinë e madhe që i jep territorit integrimi funksional mes fashave të ndryshme.

Gjithashtu, me gjithë homogjenitetin peizazhistik, morfologjik dhe funksional të këtij territori, udhëzimi strategjik që vjen nga planet kombëtare është divergjent (i trajton këto zona në mënyra të ndryshme).

Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK) zona e Krujës shihet si e integruar me sistemin metropolitan të Tiranës dhe Durrësit. Në Planin e Integruar Ndër-Sektorial Tiranë-Durrës (PINS Tiranë-Durrës) territori i bashkisë Krujë konsiderohet funksional për zhvillimin pasi në këtë territor gjenden disa infrastruktura (aeroporti, sistemi prodhues, hapësira rekreative).

Propozimi strategjik i përgjithshëm, që ky studim kërkon të zhvillojë, mbështetet në konceptin e homogjenitetit në diversitet (ekzistenca shumë elementeve unifikues por në të njëjtën kohe duke ruajtur identitetin vetjak që e karakterizon). Ai bazohet në dy argumente kryesore: (i) mundësia që të konsiderohet si një vlerë homogjeniteti i territorit që shtrihet nga Tirana në Lezhë, edhe pse me zgjidhje të ndryshme funksionale të cilat propozohen në perspektivë; (ii) nevoja e projektimit të modelit të ri të përdorimit të këtij territori duke vënë në ndërveprim mes tyre pesë sistemet e ndryshme, sipas një interpretimi që shikon, në mundësinë e bashkëveprimit mes fashave të ndryshme të peizazhit, resursin e vërtetë të një modeli zhvillimi të integruar dhe sinergjik.



Fig. 21 Fragment nga PINS i Bregdetit

Vizioni hapësinor i Zonës së Gjerë bazohet në integrimin funksional mes pesë sistemeve peizazhistike për të përfituar këto avantazhe:

- integrimi i mundshëm ekologjik mes territorit të bregdetit dhe atij malor, nëpërmjet korridoreve ambientale të përbëra nga akset e lumenjve;

- integrimi i nevojshëm komplementar mes funksioneve urbane të sistemit historik (rruga përgjatë rrëzës së maleve) dhe funksioneve të frytshme të hasura apo për t'u kërkuar e gjetur në afërsi të sistemit të ri infrastrukturor (aksi me shpejtësi të lartë lëvizjeje);

- bashkëveprimi që mund të krijohet mes zonave të mbrojtura natyrore (në bregdet dhe në zonën malore) dhe përdorimi i mundshëm i tyre për qëllime ekonomike, nëpërmjet formave të integruara të turizmit natyror (shfrytëzimi i organizuar i resurseve natyrore);

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- roli i ndryshëm që i duhet dhënë pjesëve të ndryshme të sistemit, pa pësuar mbivendosje dhe dyfishime, por me forma specializimi plotësues të ofertave specifike;

- mundësia që vendeve të ndryshme t'i caktohen funksione territoriale të specializuara, në logjikën e integrimit të ndërsjellë sipas një projekti me funksione komplementare.

Duket qartë që ky propozim kërkon një përcaktim të saktë të elementeve të tërthortë që të jenë të aftë të bëjnë të mundur dhe frytdhënës raportin bashkëveprues mes fushave të ndryshme të specializuara. Në disa raste këto elemente të tërthortë, janë lehtësisht të përcaktueshme, ndërsa në raste të tjera duhen "krijuar" në mënyrë që të bëhen "hapi i parë" i një mënyre të re të organizimit funksional të territorit. Shumë pohime e mbështesin këtë hipotezë:

- peizazhet natyrore të bregdetit dhe ato malore duhet të vihen në kontakt mes tyre nëpërmjet korridoreve ekologjike që garantojnë shkëmbimin biologjik (sistemet lumore);

- dalja në bregdet duhet menduar vetëm nëpërmjet akseve që depërtojnë tërthor me bregdetin të cilat nuk rakordohen me ndonjë aks gjatësor (a cul de sac), pasi vetë natyra moçalore e bregdetit nuk lejon një përdorim të tillë.

- ndarja e territorit nëpërmjet një vargu aksesh tërthor me bregdetin lejon rrallimin e pikave të aksesit në infrastrukturën rrugore (e nevojshme për transformimin e rrugës aktuale me përshkim të shpejtë në një autostrade të mirëfillte);

- raporti funksional mes malit dhe bregdetit mundëson zhvillimin e formave të integruara të turizmit që mund të përfitojnë nga shfrytëzimi total i ofertës së resurseve territoriale;

- sistemi i qendrave urbane duhet të rimarrë rolin dhe funksionin e tij edhe në lidhje me krijimin e qendrave të reja prodhuese dhe funksionale përgjatë akseve të transportit (autostrada dhe hekurudha).

Ideja e vlerësimit në mënyrë strategjike e lidhjeve të tërthorta të pesë sistemeve konkretizohet nëpërmjet përcaktimit të elementëve infrastrukturorë ndërlidhës, të cilët kanë rolin specifik: (i) të favorizojnë shkëmbimet, materiale dhe jomateriale, ndërmjet peizazheve të ndryshme; (ii) të lehtësojnë bashkëveprimin me qëllim plotësimin e ndërsjellë të përdorimeve dhe funksioneve; (iii) të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet ambienteve të ndryshme në të gjitha drejtimet.

Në këtë vizion, sistemet ndërlidhëse të tërthorta janë të dy tipeve të ndryshme:

- **tipi i parë (korridori portokalli)** është më shumë i mbështetur në infrastrukturën rrugore me përshkueshmëri të motorizuar;

- **tipi i dytë (korridori i gjelbër)** është më shumë i frymëzuar nga përshkueshmëria "soft" (korridoret ekologjike, rrugët për biçikleta dhe këmbësorë, lëvizje e ngadaltë/slow mobility).

Në përputhje me natyrën e ndryshme strategjike të dy tipave të ndërlidhjeve të tërthorta, akset e përcaktuara gjejnë role të ndryshme gjatë përshkimit të pesë sistemeve:

"Korridori portokalli" shihet si një sistem ndërlidhjeje strategjik i pesë sistemeve, i cili:

- lejon një lidhje rrugore të shpejtë të bregdetit me malin, duke favorizuar edhe në të kundërt aksesin e motorizuar nga zonat e brendshme drejt bregdetit;

- ne korrespondence me peizazhin malor, tregon drejtimin e zhvillimit të lidhjes rrugore me zonat e brendshme;

- ne korrespondence me sistemin urban në rreze te maleve, favorizon lokalizimin e infrastrukturave të reja në shërbim të sistemit prodhues (qendra biznesi dhe shërbimesh);

- ne korrespondence me korridorin infrastrukturor, percakton pozicionin e pikave kryesore të aksesit në autostradë;



Fig. 22 Korridoret tërthore Lindje-Perëndim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKRETARIA
TIRANË

- në korrespondence me ultësirën bujqësore, favorizon lokalizimin e infrastrukturave në shërbim të aktivitetit bujqësor (qendra grumbullimi të produkteve, pole shërbimi dhe asistence);

- në korrespondence me zonën bregdetare, përcakton një pol zhvillimi të aktivitetit turistik bregdetar (plazh), i pajisur, sipas rastit, me infrastrukturat e nevojshme.

"Korridori i gjelbër", në të kundërt, shihet si një sistem më i "lehtë" ndërlidhjeje i pesë sistemeve, i cili:

- lejon një lidhje ekologjike mes bregdetit dhe zonës malore dhe një lidhje funksionale të bazuar në konceptin e slow mobility (rruge biçikletash dhe këmbësorësh);

- në korrespondencë me peizazhin malor, përcakton pika të mundshme nisjeje të shtigjeve për ekskursione, sipas rastit, të pajisura me infrastrukturat e nevojshme;

- në korrespondence me sistemin urban në rrezë të vargmaleve, mundëson lokalizimin e infrastrukturave dhe shërbimeve për aktivitetin turistik alternativ (kampingje dhe hostele);

- në korrespondencë me korridorin infrastrukturor, i jep zgjidhje temës së kryqëzimit me autostradën nëpërmjet sistemeve të mbikalimit ose të nënkalimit;

- në korrespondencë me ultësirën bujqësore, favorizon lokalizimin e strukturave dhe mjeteve për zhvillimin e agro-turizmit dhe turizmit rural;

- në korrespondencë me zonën bregdetare, përcakton një qendër për turizmin natyror me impakt të ulët ambiental dhe ekologjikisht të përshtatshëm.

Edhe për qëllimet që i përkasin në mënyrë me specifike urbanistikës, përcaktimi i pesë sistemeve jep udhëzime të nevojshme për strategjinë e ndërhyrjes. Është e dukshme që veçoria aktuale dhe e programuar e sistemeve të ndryshme, mund të japë udhëzime të dobishme për një trajtim të diferencuar të zonave të ndryshme urbane.

Zona e përcaktuar si urbane nga Vendimi nr.5 i datës 29.12.2014 i Këshillit Kombëtar të Territorit, mund të artikulohet në brendësi, duke njohur lloje të ndryshme morfologjie urbane, të cilat mund të jenë objekt i politikave të përshtatshme të ndërhyrjeve, të diferencuara sipas peizazhit

	KORRIDORI PORTOKALLI (rrugë automobilistike)	KORRIDOR I GJELBËRT (itinerar ekologjik)
A. (bregdeti)	plazh	turizëm mjedisor
B. (ultësira)	shërbime për bujqësinë	agro-turizëm
C. (infrastruktura)	hyrje/dalje në autostradë	mbikalim / nënkalim
D. (fasha urbane)	shërbime – ekonomi	shërbime për turizmin
E. (zona malore)	akses zonave të thella	turizëm malor

Fig. 23 Matrica e territorit

në të cilin ndodhen. Me fjalë të tjera, nga mbivendosja e llojeve të ndryshme të tipologjive urbane me pesë sistemet e përcaktuara, do të jetë i mundur artikulimi, në zonat e ndryshme, i politikave të administrimit të transformimeve.

Tipizimi i morfologjive urbane është përcaktuar këtu për t'i dhënë territorit strategji të ndryshme për administrimin e transformimeve urbanistike, edhe në raport me llojet e ndryshme të peizazhit në të cilin rezultojnë të përfshira.

ZONA URBANE E KONSOLIDUAR

Zona urbane e konsoliduar përfshin pjesët (zonat) më qendrore të vendbanimeve të një farë rëndësie: ajo përfshin në një "morfotip" të vetëm, si zonat historike (të cilat, sipas rastit, mund të njihen si nën-bashkësi), ashtu edhe zonat e reja (rezultat i një ideje qyteti të konsoliduar de facto apo të planifikuar në mënyre të mirëfillë).



Fig. 24 Zonat urbane të miratuara (Vendimi Nr.5, dt. 19.12.14 i KKT)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

ZONA SUB-URBANE E ZGJERUAR

Zona sub-urbane e zgjeruar përfshin në një kategori të vetme të gjitha format e ndryshme të zgjerimit të zonave të urbanizuara që ka ndodhur në dekadat e fundit (pas viti '90): lagjet e reja periferike, shpërhapja sub-urbane (sprawl), ndërtimi i shpërndarë me një farë dendësie, zgjerimet informale.

VIJA NDËRTIMORE

Vija ndërtimore përbëhet nga zonat me ndërtime pak a shumë të vazhdueshme përgjatë rrugëve të cilat nuk mund të njihen si zona të mirëfillta urbane.

ZONA INFORMALE

Zona informale e njohur ligjërisht është ajo zone që është përcaktuar me vendim specifik të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) ose Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH).

ZONA EKONOMIKE

Zona ekonomike përbëhet nga një bashkësi ndërtesash me funksione të ndryshme prodhimi (industriale, artizanale, tregtare, shërbimesh) të krijuara në afërsi të elementëve infrastrukturorë territorialë (rrugë, hekurudha etj.).

Fig. 25 Evidentimi i morfologjive të zonave urbane

ZONA RURALE

Fshati rural përfshin ato raste përqendrimi të ndërtimeve jashtë zonave urbane që, për arsye historike ose funksionale, përbejnë një vendbanim kompakt.

Kryqëzimi mes tipeve të ndryshme të "peizazheve" dhe i "morfologjive urbane" përcakton udhëzimet strategjike për administrimin e transformimeve urbanistike:

URB/01
Njohje e qendërsisë urbane, mundësi e dendësimit urban, mundësi ndërtimi në trojet e përfshira, përshtatje e rrjeteve teknike (parësore), përshtatje dhe zhvillim i shërbimeve të tjera urbane (dytësore dhe tretësore).

URB/02
Njohje e periferialitetit urban, mundësi ristrukturimi urbanistik, përshtatje e rrjeteve teknike dhe shërbimeve (parësore) bazë.

RUR/01
Njohje e kushteve të jetesës së decentralizuar, mundësi ristrukturimi të ndërtesave, përshtatje e rrjeteve teknike dhe shërbimeve të njësisë territoriale.

RUR/02
Njohje e vendbanimeve ekzistuese, mospërputhshmëri me nevojat e mbrojtjes së ambientit dhe peizazhit, përshtatje e rrjeteve teknike dhe ngrirje "ngurtësim" i gjendjes faktike aktuale.

IND/01
Njohje e zonës ekonomike ekzistuese, përshtatje e rrjeteve infrastrukturore dhe ndërhyrje për racionalizimin dhe organizimin urbanistik.

Si përfundim, në kontekstin e vizionit të përgjithshëm hapësinor në "Shkallë të gjerë", secili prej territoreve bashkiake mund të ketë një specializim funksional që e karakterizon (pa bërë që kjo të përcaktojë ekskluzivitete funksionesh apo përdorimesh).

Në rastin specifik, për territorin e Krujës (Fushë-Krujës) specializimi do të jetë padyshim i lidhur me zhvillimin e sistemit infrastrukturor dhe me logjistikën e integruar (në mënyrë koherente me udhëzimet e planeve kombëtare), lidhur edhe me faktin e ekzistencës së modaliteteve më të rëndësishme të transportit (aeroporti, autostrada, hekurudha).

	A (bregdeti)	B (ultësira)	C (korridori)	D (rrëza e malit)	E (zona malore)
1. (zona urbane e konsoliduar)	URB/01	URB/01	URB/01	URB/01	URB/01
2. (zona sub-urbane e zgjeruar)	URB/02	URB/02	URB/02	URB/02	URB/02
3. (vijë ndërtimore)	RUR/02	RUR/01	RUR/01	RUR/01	RUR/02
4. (zonë informale)	URB/02	URB/02	URB/02	URB/02	URB/02
5. (zonë ekonomike)	RUR/02	URB/02	IND/01	IND/01	RUR/02
6. (fshat rural)	RUR/01	RUR/01	RUR/01	RUR/01	RUR/01

Tabela 5: Udhëzimet strategjike për ndërhyrjet në territor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

Tri linjat e veprimeve strategjike, të identifikuara për territorin e Krujës, janë të renditura si më poshtë:

- INFRASTRUKTURË DHE LOGJISTIKË
- TURIZËM KULTUROR
- INOVACION NË PRODHIM

1.3.3 Vizioni hapësinor territorial

Në mbështetje të komenteve të përfshira në paragrafët e mësipërm, vizioni udhëzues në shkallë të gjerë të zonës, përkufizohet si më poshtë.

TOKA E NDËRMJETME
Përkufizimi:

Territor i sigurt, tokë pjellore bujqësore, trashëgimi historike, trashëgimi natyrore, traditë artizanale në përpunimin e produktit vendor, pasuri kombëtare agro-ushqimore.

Korridoret infrastrukturorë gjatësorë, me vlerë kombëtare dhe ndërkombëtare, integrohen dhe përfitojnë nga rizbulimi dhe përforcimi i korridoreve të tërthorta të rrjeteve ekologjike dhe ambientale, të rrjeteve të ekonomisë prodhuese dhe punësimit, të prodhimeve agro-ushqimore cilësore dhe të qëndrueshme, të lëvizjes së ngadaltë dhe lokale, që lidhin mes tyre zonat e mbrojtura të rezervateve ekologjike malore dhe bregdetare.

Këto korridore ndërtojnë bazën dhe projektimin e strukturës territoriale për riorganizimin progresiv të modeleve ekzistuese të vendbanimeve; atyre rreth qendrave të gjerdanit rrëzë vargmaleve, të ristrukturuara dhe të rigjeneruara rreth rindërtimit dhe përmirësimit të sistemit ekzistues hekurudhor, shtylla kurrizore e rendit të ri zgjidhjes, së bashku me korridorin kombëtar të infrastrukturës, të rehabilituar; në polet e industriale dhe prodhuese; në pikat e reja të shkëmbimit dhe lëvizshmërisë, deri te rrjeti i porteve dhe i zbarkimeve bregdetare.

Rrjetet

Territori në studim është i pasur me peizazhe cilësore, të ndryshme (kur flasim për peizazhin, i referohemi mjedisit dhe vlerave mjedisore), që janë dhe shprehje e pasurisë kulturore, e prodhimit dhe biodiversitetit. Këto peizazhe ruhen dhe ushqehen nga kjo strategji, nëpërmjet mundësive të reja, të propozuara, të zhvillimit të qëndrueshëm, të kryqëzuar me përmirësimin e rrjeteve ekzistuese të lëvizjes dhe me krijimin e rrjeteve të reja, me korridoret ekologjike, si dhe me shtigjet e zbulimit dhe shfrytëzimit të pasurive historike-kulturore-natyrore.

Peizazhet

Një territor i përbërë nga peizazhe, të cilave iu korrespondojnë regjime të ndryshme të planifikimit (lloj në mbrojtje, mbrojtje e pasurive natyrore dhe historiko-kulturore, mundësi zgjerimi dhe zhvillimi të qëndrueshëm), si dhe strategji të ndryshme të ndërhyrjeve dhe të rregullatorëve të statuseve:

1. Resurset malore, të cilat sot janë tokë e braktisur dhe me paqëndrueshmëri hidrogjeologjike, janë mundësia e të ardhmes për oferta turistike dhe për ripopullim të brendshëm, si një habitat me cilësi të lartë të jetës;

2. Gjerdani urban, i përbërë nga qytete dhe fshatra;

3. Kruja, e cila duhet të konsiderohet veçanërisht, për shkak të karakterit të saj të rëndësishëm historik, te vendndodhjes gjeografike dhe të peizazhit që e karakterizon;

4. Resurset ekologjike dhe kulturore historike në det/bregdet



Fig. 26 Hierarkia e zonave urbane dhe sistemet e infrastrukturës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

5. Korridori kombëtar gjatësor i flukseve dhe i prodhimit, rreth të cilit, i ristrukturuar si autostradë rajonale, riorganizohen vendet e prodhimit në grupime zonash industriale që plotësojnë kërkesat ekologjike, si dhe qendrat e reja territoriale dhe urbane (qendra intermodale e Fushë-Krujës, Ky riorganizim rreth këtij korridori vjen edhe prej rimëkëmbjes dhe ristrukturimit të korridorit hekurudhor, si vlerë kombëtare dhe lokale;

6. Niveli i rikuperimit të tokave bujqësore, që nënkupton resurset agro-ushqimore, ku lloji që mbrohet është toka dhe aftësia e saj për të prodhuar ushqim cilësor dhe burime ushqimore të përsosura;

7. Kodrat e Krujës, të cilat gradualisht janë degraduar nga aktiviteti i nxjerrjes së mineraleve, duhet të kthehen të jenë vend prodhimi i burimeve ushqimore të cilësisë së lartë; duhet të rikthehen të jenë zona e hyrjes në parkun historiko-arkeologjik të Krujës, "park" ky që lidhet me historinë dhe figurën e Skënderbeut, hero kombëtar;

8. Resursi i madh dhe i vazhdueshëm bregdetar, ku strategjitë aktive të mbrojtjes (Planet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura) ulin dhe zbusin, në masë të përshtatshme, dëmet ndaj mjedisit, produkteve ekologjike dhe peizazhit. Këto dëme kanë ardhur kryesisht nga programet e zhvillimit të vendbanimeve të ndërtuara tashmë në zonën turistike bregdetare, në proces apo të planifikuara. Zbutja e këtij dëmi propozohet të bëhet në logjikën e një riorganizimi të vendbanimeve ekzistuese, që artikulon tipologjitë e ndërtimit në lidhje me kushtet e kontekstit. (qendra turistike hoteliere, banesa me ndikim të ulët në mjedis, fshatra ekologjike).



Fig. 27 Skema e zhvillimit të funksioneve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Ekonomitë

Një territor i përbërë nga ekonomi të ndryshme (bujqësore, blegtorale, pyjore, detare, turistike, mjedisore, artizanale, transporti etj.), të cilat bashkëjetojnë dhe marrin përfitime të ndërsjella:

1. Ekonomia bujqësore cilësore
2. Ekonomia urbane (tregtia dhe shërbimet)
3. Ekonomia e turizmit bregdetar, natyror, kulturor, dhe malor
4. Ekonomia shkëmbimeve dhe e logjistikës
5. Ekonomia e prodhimit artizanal
6. Ekonomia nxjerrjes dhe e çimentos
7. Ekonomia e peshkimit dhe aktiviteteve detare
8. Ekonomia pyjore blegtorale (në zonat e thella malore)
9. Ekonomia e burimeve energjetike të rinovueshme

Mënyra e të jetuarit dhe stili i jetës

Një territor i karakterizuar nga morfologji urbane të ndryshme. Ky shpreh kontekstet e ndryshme të stileve të jetës urbane, treguese të formave të vjetra dhe të reja të mënyrës së të jetuarit, të të ndërtuarit, me një gjurmë më të vogël ekologjike.

Paraqitja e vizionit hapësinor

A. PEIZAZHET

a. Peizazhi bregdetar

Fig. 28 Peizazhi Bregdetar

b. Peizazhi bujqësor

Fig. 29 Peizazhi Bujqësor

c. Korridori infrastrukturor dhe prodhues



Fig. 30 Peizazhi Infrastrukturor

d. Fasha urbane rrëzë vargmaleve

Fig. 31 Peizazhi urban rrëzë vargmaleve

e. Peizazhi malor

Fig. 32 Peizazhi Malor

B. STRUKTURAT TERRITORIALE

B.1 Korridoret e gjelbërta

B.2 Korridoret portokalli

B.3 Grup vendbanimesh rurale ose malore

C. SISTEMI I VENDBANIMEVE

C.1 Niveli urban

- Qendra kryesore (përmbajnë shërbime të nivelit territorial: shkolla të mesme, spitale, zyra administrimi lokal kryesor ose dytësor, qendra kulturore dhe biblioteka bashkiake)

- Qendra dytësore (përmbajnë shërbime të nivelit urban: shkolla nëntëvjeçare, qendra mjekësore, zyra administrimi lokal dytësor, parqe edukative, biblioteka lokale)

- Qendra lokale të specializuara (janë qendra të pajisura me funksione specifike, si rrjedhoje e afërsisë me qendra të rëndësishme ose me infrastruktura apo shërbime territoriale (shiko pikën E.)

- Qendër rurale ose malore në shërbim të një grupi vendbanimesh
- Qendra rurale dhe malore
- Fshatra ekologjike bregdetare
- Fshatra ekologjike malore

C.2 Morfologjitë e vendbanimeve

- Zonë urbane e konsoliduar
- Zonë e periferisë urbane të zgjeruar në vitet e fundit
- Vijë ndërtimore
- Zonë informale e njohur ligjërisht
- Zonë ekonomike (industriale)
- Vendbanim rural ose malor

D. SISTEMI INFRASTRUKTUROR

- Korridor infrastrukturor kombëtar (Autostradë) – pjesë ekzistuese
- Korridor infrastrukturor kombëtar (Autostradë) – pjesë e propozuar
- Rrugë kombëtare
- Rrugë rrëzë malit
- Rrugë dytësore
- Rrugë rurale dhe malore
- Kryqëzim autostrade në disnivel – ekzistues ose i parashikuar
- Rrugë hekurudhore kryesore
- Rrugë hekurudhore dytësore
- Stacione hekurudhore ekzistuese
- Stacione hekurudhore urbane të parashikuara
- Stacione hekurudhore ekologjike të parashikuara

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL TIRANË SEKRETARIA

Fig. 33 Sistemi natyror

E. PAJISJET TERRITORIALE

- Aeroporti ndërkombëtar Nënë Tereza dhe qendra "Tirana Business Park" (projekt)
- Qendër intermodale Fushe-Krujë
- Fabrikë çimento Krujë
- Llixha Bilaj

F. ZONAT E MBROJTURA

- Parku i Qafështamës
- Parku i Malit të Dajtit
- Qendrat e pritjes për vizitorët e parqeve
- Struktura ndihmëse në shërbim të parqeve

G. SISTEMI UJOR

- Rrjedhë ujore kryesore - Lumë
- Rrjedhë ujore dytësore - Përrua
- Liqen ose rezervuar artificial
- Kanal vaditës ose kullues kryesor
- Hidrovor

Fig. 34 Sistemi ujor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Fig. 35 Sistemi bujqësor

Fig. 36 Sistemi urban

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Fig. 37 Sistemi infrastrukturor

- Rrjet vaditës për përdorim bujqësor
- Rrjet ujësjellësi kryesor
- Rrjet për shpërndarje urbane të ujit të pijshëm
- Burim ujor natyror
- Pus ose depozitë uji të pijshëm
- Rrjet i kanalizimeve të ujërave të zeza
- Impiant pastrimi
- Mulli ose impiant industrial që përdor energjinë e ujit
- Kanal ujor në shërbim të mullinjve
- Digë ose hidrocentral

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL
TIRANË
SEKRETARIA

02 / Strategjia territoriale



2.1 IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE, POTENCIALEVE DHE PENGESAVE

2.1.1 Analiza e thelluar e territorit

2.1.1.1 Metodologjia

Analiza e thelluar e nevojave, e potencialeve dhe e kufijve për zhvillimin e zonës së Krujës bëhet nëpërmjet ndërtimit të disa tablove interpretuese në shkallë bashkie. Këto tablo ndërtohen nga tërësia e çështjeve që janë vendimtare për perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të territorit në fjalë, dhe gjithashtu nga analiza SWOT e çdo sistemi territorial, tashmë të analizuar dhe të përcaktuar në terma të përgjithshme; analizë e bërë në lidhje me vizionin hapësinor të bashkisë, në pesë sistemet përkatëse: sistemin natyror (N), sistemin ujor (U), sistemin bujqësor (B), sistemin urban (UB) dhe sistemin infrastrukturor (IN).

Ndërtimi i këtyre pesë sistemeve tregohet grafikisht në hartat e mëposhtme:

- Harta e trashëgimisë historiko-kulturore-natyrore
- Harta e degradimit dhe braktisjes
- Harta e riskut hidrologjik dhe të rrëshqitjeve
- Harta e elementëve përjashtues
- Harta e projekteve në zbatim dhe të miratuara për zbatim

Këto harta kanë përmbajtje të informacionit të prezantuar në fazën e parë të punës, të përpunuara më tej nga të dhënat e mbledhura arkivore, publicistike, nëpërmjet sondazheve të mëtejshme në terren, si dhe nga studimet e prodhuara gjatë viteve të fundit për rastin në fjalë.

Tërësia e të dhënave të paraqitura në këto harta, të cilat në paragrafët e mëposhtëm nxirren në dukje në formë të përmbledhur, është element themelor i një sistemi njohjeje, me qëllim marrjen e vlerës së "Kornizës së përbashkët njohëse" të Planit të Përgjithshëm. Këtij sistemi të njohjes i korrespondon, në perspektivë, një sistem i hartave të identifikimit të vendndodhjeve, rrugëve dhe zonave me interes të madh, të ndërtuara në një sistem të komunikimit dhe pjesëmarrjes nëpërmjet platformës GIS, të cilat do të zhvillohen gjatë procesit të studimit të mëtejshëm.

2.1.1.2 Harta e trashëgimisë historiko - kulturore - natyrore

Kjo hartë identifikon dhe lokalizon elementet me me vlerë në territorin e Bashkisë Krujë, të mbledhura nga dy kategori të përgjithshme:

Fig. 38 Territori i bashkisë Krujë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- SISTEMI NATYROR;
- SISTEMI URBAN – trashëgimia historiko-kulturore

Sistemi i parë përfshin:

- Zonat e pyllëzuara dhe mjediset gjysmë-natyrore, mjediset e lagështa dhe mjediset e ujit, që rrjedhin nga analiza e hartës së Corine Land Cover deri në nivelin e 3-të. Harta, nëpërmjet ngjyrave, dallon këto mjedise edhe vlera gjeo-botanike, sipas një klasifikimi cilësor që i cakton vlerën më të ulët specieve dhe sistemeve natyrore jo-endemike (është rasti i pyjeve halore, që paraqesin ende një vlerë mbrojtje të tokës nga erozioni, të cilat duhet të merren parasysh në veçanti), dhe vlerën më të lartë të gjitha sistemeve vendase që karakterizohen nga peizazhe natyrore të origjinës;

- Tokat bujqësore të punuara, edhe këto të klasifikuara në klasën e tretë të Cover Corine Land. Edhe për këto sisteme është ekspozuar një vlerësim të vlerës cilësore, e cila cakton vlerën më të lartë për territoret e përdorura me të mbjella të përhershme, veçanërisht ullishte dhe vreshta, të cilat janë në këtë mënyrë arsye për mbrojtjen dhe promovimin e kulturave të të mbjellave në këto zona, veçanërisht në peizazhe kodrinore, ku këto të fundit, janë tashmë të pranishme në masë të madhe.

Ky identifikim, siç është e kuptueshme, formon bazën e politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe përmirësimit të mjedisit, që përbëjnë arsyen për zgjedhjen e paragrafëve të mëposhtëm.

Harta, gjithashtu, tregon disa tregues të jashtëzakonshëm, që lidhen me mallrat si: pemë monumentale, burime, kanione, gryka, zona të veçanta gjeologjike, shpella dhe shpella karstike.

Duhet të theksohet se ky sistem i identifikimit, klasifikimit e lokalizimit në harta, paraprin një sistem më sistematik të inventarit territorial, i cili do të jetë një burim i thellimit në zhvillimin e mëvonshëm të studimit, ose pjesë e projekteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, të shtjelluara më poshtë, në kapitullin 3 – 'Veprimet strategjike dhe projektet e zhvillimit'.

Sistemi i dytë i listuar, që mbulon të gjithë trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, përfshin, në detaje, zonat arkeologjike, komplekset monumentale-historike, qendrat historike, pazaret, kështjellat dhe sistemet e fortifikuara, kishat, xhamitë dhe objekte apo vende të tjera të kultit dhe vende të tjera të caktuara, subjekt i ngjarjeve të veçanta fetare dhe etnografike.

Edhe në këtë rast, ky sistem identifikimi, klasifikimi dhe lokalizimi në hartë paraprin një sistem më sistematik të inventarit hapësinor, i cili mund të jetë arsye për thellimin në zhvillimin e mëvonshëm të studimit, ose pjesë e projekteve të PPV-së. Në analizën e parë, për vendet kryesore të interesit kulturor, është paraprirë në hartë një vlerësim që përdor një metodologji të zhvilluar gjatë një studimi të kohëve të fundit në Universitetin e Pescara-s, i cili funksionon duke i caktuar një vlerë cilësore nga 1-5, disa faktorëve të vlerësimit, të cilat në përgjithësi kanë të bëjnë me gjendjen e aksesit publik, dëmtimit të mjedisit, gjendjen e ruajtjes fizike (konservimit), ligjshmërinë e përdorimit, kushtet e pronësisë (publike ose private), praninë e shërbimeve të turizmit.

Kjo metodologji shoqëron, përcaktimin e projekteve pilotë dhe strategjikë, kur ata ndërveprojnë me vlera të veçanta kulturore, arkeologjike, peizazhistike dhe natyrore.

Në mbështetje të elementeve të përshkruara, harta gjithashtu tregon parametrat e zonave të mbrojtura dhe parqeve, të përmbledhura në kategoritë e mëposhtme:

- zonat e mbrojtura (parqe kombëtare);
- zonat që i përkasin Rrjetit Emerald.

Zona e Bashkisë Krujë është prekur në mënyrë të veçantë nga një pjesë e Parkut Kombëtar të Malit të Dajtit, dhe ngjitur Parkut Kombëtar i Qafështamës, i gjendur në një distancë të shkurtër nga qendra historike e Krujës.

Harta gjithashtu tregon vendndodhjen e IBA-"Zonat e Rëndësishme për Zogjtë" (Important Bird Areas), zona të rëndësishme për zogjtë. Siç dihet: "Për t'u njohur si një IBA, një vend duhet të ketë të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme: të presë një numër të konsiderueshëm të një ose më shumë specieve të kërcënuara në nivel global; të bëjë pjesë në një lloj të zonave të rëndësishme për ruajtjen e specieve të veçanta (të tilla si ligatinat ose kullotat apo shkëmbinjtë e thatë ku ndërtojnë fole shpendët detarë); të jetë një zonë ku përqendrohet një numër veçanërisht i lartë i shpendëve shtegtarë.

Kriteret, me të cilat identifikohen vendet e IBA-s, janë shkencore, të standardizuara dhe të aplikuara në rang ndërkombëtar. Rëndësia e IBA-s dhe vendeve të rrjetit Natyra 2000, shkon përtej mbrojtjes së zogjve. Meqenëse zogjtë janë tregues efektivë të biodiversitetit, ruajtja e IBA-ve siguron ruajtjen e një numri shumë më të madh të llojeve të tjera të florës dhe faunës, edhe pse rrjeti IBA përcaktohet në bazë të shpendëve.

2.1.1.3 Harta e degradimit dhe braktisjes

Kjo hartë lokalizon zonat dhe vendet me kushte të veçanta të degradimit, veçanërisht të mjedisit dhe të shëndetit dhe higjienës, së bashku me zonat e shënjuara nga braktisja e përdorimit pararendës të tokës.

Aktualisht, vizatimi, i bazuar në interpretimin fotografik dhe ballafaqimin ndërmjet imazheve satelitore të periudhave të ndryshme (burimi: Google Earth, periudha referencë 2002-2015) dhe pjesërisht në vizitat dhe rilevimet e kryera në terren, është pika e



Fig. 39 Harta e trashëgimisë historiko – kulturore - natyrore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

fillimit të një pune të detajuar që përfshin zonat urbane dhe kontekstet që do të bëhen motiv i thellimit analitik e planifikues në fazën e tretë të Planit të Përgjithshëm Vendor. Megjithatë, në këtë fazë, nënvizohet se si kjo lloj qasjeje është tashmë në gjendje të drejtojë zgjedhjet e Planit Strategjik për zonat dhe kontekstet më të prekur nga degradimi dhe neglizhenca, kushte shpesh të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Për sa i takon territorit në fjalë, harta tregon pa mëdyshje gjendjen e rëndë të kodrave që ndërhyjnë në zonat e brendshme malore dhe fushës bujqësore, si pasojë e veprimit të rëndë të nxjerrjes së materialeve gëlqerore, që ka dëmtuar pothuajse tërësisht cilësinë origjinale të këtyre vendeve.
Rezulton shumë i përkeqësuar edhe imazhi i përgjithshëm i qytetit të lashtë të Krujës, i cili gjithashtu mban peshën e degradimit të mjedisit të ardhur nga zhvillimi urban i pakontrolluar, në të gjitha drejtimet, edhe në aërsi të pjesës më të vjetër dhe të kalasë, një nga vendet me vlera identifikuese për të gjithë kombin.

Analiza, edhe për shkak të shkallës grafike, nuk eshtë ne gjendje të përshkruajë kushtet komplekse të degradimit të cilat veprojnë në këtë nivel në shumë zona të territorit, apo dëmtimin e rrjedhave të lumenjve, shpesh të përdorura për depozitimin e mbeturinave urbane ose të mbeturinave të tjera me karakter industrial, shpesh në forma të fshehta dhe ilegale.

Kjo hartë nënvizon urgjencën dhe nevojën për vëmendje në lidhje me përhapjen dhe mungesën e tanishme te formave te konfliktit publik dhe perhapjes së fenomeneve kolektive që përbëjnë një frenim të fortë mbi mundësitë e zhvillimit te territorit, të përshtatshme në mënyrë të qartë për turizmin natyror dhe kulturor, dhe një pengesë e dukshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve lokale.

Krijimi i formave te kontrollit dhe sinjalizimit te degradimit dhe situatave te lëna pas dore, mund te jete rast per projekte te veçanta te komunikimit dhe qytetarisë aktive,



Fig. 40 Harta e degradimit dhe braktisjes

ne modele, si për shembull, projekti "Dekor Urban", ne te cilin janë bashkuar shumë komuna italiane.

2.1.1.4 Harta e riskut hidrologjik dhe të rrëshqitjeve

Ne kete hartë, jepen disa informacione ne lidhje me situatat që përfshijnë humbjen e mundshme te vlerës se mallrave dhe/apo njerëzve ne lidhje me praninë e faktorëve te rrezikut hidrologjik, gjeologjik, industrial. Një kusht i përhapur i rrezikut dërrmues karakterizon një pjesë te mirë te shpateve te brendshme ne zonat malore, si dhe ne zonat e pjerrëta te sistemit malor ku mbështetet dhe qendra kryesore, Kruja, si dhe fshatrat e kësaj zone.
Zonat me te ekspozuara ndaj rrezikut hidrologjik janë ato te shënuara nga sistemi hidrografik i përbërë nga lumi Ishëm dhe degët e tij, i cili duket se nuk është i afte te drenazhojë tokat ne rastet e ngjarjeve te jashtëzakonshme meteorologjike - te cilat po ndodhin gjithnjë e më shumë kohët e fundit, siç dëshmohet nga ngjarjet e fundit te përmbytjeve që kanë prekur tokat ndërmjet Fushë-Krujës dhe Kepit te Rodonit ne grykëderdhjen e Ishmit.

Për këtë arsye, sigurimi i një pjesë te mirë te territorit te bashkisë, tregohet edhe ne kete fazë pasi eshtë ne nga objektivat specifike te fazës se tretë te Planit te Përgjithshëm Vendor.

2.1.1.5 Harta e elementëve përjashtues

Qëllimi i kësaj harte eshtë, që te përkthejë ne një imazh sintetik, kompleksitetin e sistemit te rregullave te mbrojtjes dhe te përjashtimit, që dalin gjithmonë nga normativat e rregulloreve, por pothuajse gjithmonë te pa shoqëruara nga përfaqësitë grafike, te paraqitura tashmë ne materialin e fazës se parë, brenda te cilit janë analizuar ne detaje te gjitha ligjet dhe rregulloret që ndikojnë apo pengojnë zhvillimin, sidomos ne aspektin e ndërtimit, ne fusha te ndryshme te territorit.
Harta përmban ne radhë: kufijtë nga varrezat, distancat e largimit te ndërtimit nga trupi i rrugëve, te klasifikuara

Fig. 41 Harta e riskut hidrologjik dhe rrëshqitjeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT TIRANË SEKRETARIA

në lidhje me Kodin Rrugor Kombëtar, zona e aeroportit, zona aeroportuale e zhvillimit dhe korridori ajror kufizues i fluturimit, zonat e respektimit të shtretërve të lumenjve, përrenjve dhe syprinave të tjera ujore.

Harta, gjithashtu tregon, me ngjyra të ndryshme, ndërtimet e realizuara deri në vitin 2007 (burim ALUIZNI) dhe e përditësuar me ndërtimet e mëvonshme deri në vitin 2016, me një krahasim të shpejtë nëpërmjet fotove satelitore më të fundit (Google Earth), meqenëse nuk disponohej burim tjetër zyrtar.

2.1.1.6 Harta e projekteve të realizuara në vitet e fundit, projekteve në zbatim dhe projekteve të miratuara për zbatim

Ky vizatim i fundit, i përpunuar, rindërton kompleksin e zgjidhjeve urbane të implementuara në territor, së bashku me sistemin e infrastrukturave të mobilitetit, të artikuluar në bazë të gradës dhe funksionit (lloj trafiku rrugor dhe hekurudhor), dhe vendbanimet urbane.

Vendbanimet janë identifikuar në nivel hapësinor si vendbanime të konsoliduara (me ngjyrë të kuqe) dhe me gri "perimetri i zonave urbane", në bazë të Vendimit nr. 5, dt. 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit, dhe në nivel të morfologjisë së ndërtimeve, të tilla si:

- Ndërtesa me përdorim kryesisht banim;
- Ndërtesa me përdorim kryesisht prodhuese, artizanale dhe tregtare;
- Ndërtesa për shërbime dhe objekte publike;
- Ndërtesat për përdorime të tjera.

Ky vizatim, në këtë mënyrë, paraqet problemet e shumta të situatës aktuale, në mënyrë të veçantë për sa i përket respektit të munguar karshi rrugës nacionale, hekurudhës dhe në shumë raste edhe shtretërve të lumenjve. Kjo harte është bazë për identifikimin dhe lokalizimin e veprimeve si publike ashtu edhe private, me interes të konsiderueshëm për zonat urbane në studim. Kombinimi i këtyre veprimeve është klasifikuar si më poshtë:

- Veprime të kryera kohët e fundit (në 15 vitet e fundit);
- Veprime në punë e sipër;
- Veprime në plan për tu kryer (që do te thotë ekzistenca e projekteve apo programeve me vlerë ligjore dhe administrative dhe të shoqëruara nga angazhimet financiare);
- Masat e paraqitura dhe të planifikuara nga planet urbanistike në fuqi, në datën e formimit të këtij studimi, ose të miratuara nga qeveria lokale, para reformës administrative kombëtare.

Qëllimi i këtij dokumenti, është të ndërtojë një kontekst aktual të planifikimit të sistemit të zgjidhjes, por edhe nga proceset më të fundit të shlyerjes, së bashku me një evidentim fillestar të nevojave dhe pritshmërive për ndërhyrjet që do parashikohen (me fokus në sektorin e ndërtimit dhe të turizmit), tashmë të dëshmuar nga instrumentet e planifikimit që kanë humbur sot vlerën e tyre ligjore, por që janë, përsëri, një dëshmi e vlefshme, sa e pritshmërive, aq edhe konflikteve të mundshme, mjedisore dhe peizazhistike, të krijuara shumë shpesh.



Fig. 42 Harta e elementëve përjashtues



Fig. 43 Harta e projekteve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

2.1.2 Analiza SWOT për secilin nga pesë sistemet territoriale (N, U, B, UB, IN)

2.1.2.1 Metodologjia e përdorur

Analiza SWOT, siç dihet, përbën një metodologji të përdorur gjerësisht, me qëllim evidentimin në mënyrë të shpejtë dhe efikase të atyre faktorëve, të brendshëm të sistemit (pikat e forta dhe të dobëta) ose të jashtëm (mundësitë dhe rreziqet) të cilët luajnë, ose mund të luajnë, një rol vendimtar në strategjitë e Planit, nëse interpretohen dhe vlerësohen në mënyrën e duhur.

Perdorimi i një metodologjie kaq të afirmuar dhe te praktikuar nga një sëre studimesh, mbart me vete edhe rreziqe, i pari ndër të cilët është bërja e analizës në forme rituale ose teorike, ose si një përmbledhje e thjeshte e analizave të mëparshme që janë të tejkaluara dhe që janë treguar joefikase.

Për të evituar këtë, dhe për t'i dhënë analizës rolin e saj vlerësues të faktorëve që bashkëveprojnë në ndërtimin e objektivave dhe strategjive të planit, përveç studimit dhe mbledhjes së studimeve ekzistuese, është kërkuar të paraprihet me realizimi i analizës së detajuar për secilin sistem territorial. Qe në këtë fazë dalin në pah gjurmë të cilat sugjerojnë mundësi projektesh, duke i paraprirë përputhjes së elementeve SWOT dhe objektivave të planit për përcaktimin e projekteve e cila do të trajtohet dhe argumentohet në paragrafët e mëposhtëm.

Me poshtë është bërë përcaktimi i pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve për secilin nga sistemet, duke iu referuar edhe aktoreve të interesuar (stakeholder, subjekte publike, sektori i tretë) dhe, në disa raste, rolit që secila nga pikat luan në perspektivat e zhvillimit dhe rigjenerimit territorial të zonës së studiuar. Një trajtim i përgjithshëm i elementeve SWOT për të gjithë territorin e bashkisë Kruje eshte bere ne fillim te këtij paragrafi.

2.1.2.2 Analiza e përgjithshme

PIKAT E FORTA

- Pozicion gjeografik i favorshëm, në brendësi te një territori që përfshin zona malore dhe bregdetare, në afërsi me detin dhe me një klimë te këndshme.
- Identitet i fortë historik dhe kulturor, veçanërisht e rëndësishme në perceptimin e kësaj vlere në nivel kombëtar (historia e Skënderbeut, hero kombëtar)
- Përfshirja e territorit te Krujës në parashikimet e Planit te Përgjithshëm Kombëtar dhe Planeve Ndërsektoriale
- Afërsi me zonën metropolitane Tirane-Durrës
- Pjesë e zonës territoriale me vlerë dhe funksion te lartë ekonomik te vendit (motor kombëtar ekonomik)
- Pjesë e Fashës C "Trashëgimi Kulturore Kombëtare"
- Përqindje e larte e popullsisë me moshë te re, popullsi aktive
- Vetëdije e pushtetit vendor te rolit te tij me dëshirën për te kontrolluar zhvillimin e tokës në një bazë te qëndrueshme
- Prirje e komuniteteve lokale drejt veprimeve te solidaritetit dhe mbrojtjes së përbashkët ndaj rreziqeve

PIKAT E DOBËTA

- Nivel i konsiderueshëm i te papunëve dhe rritje e ulët ekonomike
- Nivel i te ardhurave mesatarisht te ulëta ne popullsinë lokale

- Prezenca e zonave me periferialitet urban, varfëri dhe përjashtime sociale
- Nivel i lartë i informalitetit, qoftë ne ekonomitë ashtu edhe ne proceset urbane
- Nivel i ulët i resurseve publike lokale
- Niveli i ulët i ofertës se aftësive teknike dhe profesionale lokale, për shkak te zhvendosjes se fuqisë punëtore te kualifikuar dhe te kuadrove teknike dhe profesionale ne qendrat e mëdha urbane (Tiranë dhe Durrës)
- Mungesa e planeve urbanistike te bazuar ne analiza dhe interpretime te sakta te gjendjes faktike
- Paqartësia e pengesave, ruajtjes dhe mbrojtjes se te mirave te përbashkëta urbane
- Prani e ulët e shoqatave ne mbrojtje te pasurisë publike.
- Pasiguri mbi te drejtën e pronës
- Fragmentim i lartë i pronës se tokave bujqësore, me ndërmarrje te tipit familjar që prodhojnë kryesisht për vetëkonsum
- Mungese infrastrukturash per magazinimin dhe transportin e mallrave
- Nivel i ulët i kreditimit bankar, shpeshherë i paaksesueshëm nga ndërmarrjet e vogla dhe shumë te vogla
- Mungese e menaxhimit te duhur te ciklit te mbetjeve urbane
- Nivel i larte i ndotjes, që pengon shfrytëzimin e bregdetit dhe zhvillimin e një bujqësie biologjike me vlere te shtuar te lartë
- Mungese e infrastrukturave te tjera ne pjesë te mëdha te territorit, si rrjetet e kanalizimeve, uji i pijshëm, rrjeti rrugor, rrjeti hekurudhor (tashme pothuajse jashtë përdorimit) etj.

MUNDËSITË

- Potencial i lartë ekonomik ne industri dhe bujqësi
- Zhvillimi i shërbimeve ndaj turizmit ne raport me rritjen e kërkesës turistike brenda dhe jashtë vendit
- Çmim i ulët i truallit, i fuqisë punëtore dhe i faktorëve përbërës te ndërtimit
- Prioritet i zhvillimit territorial i caktuar nga planet e niveleve me te larta (Planet e integruara, planet sektoriale, Planet Kombëtare)
- Mundësia e përfitimit nga afërsia territorial me Tiranën dhe Durrësin ne bazë te lidhje se mirë ekzistuese infrastrukturore.
- rritja, faktike dhe potenciale, e sektorit turistik te vendit, integrimi i te cilit me bujqësinë dhe agro-turizmin mund te ndihmoje ne shpërhapjen e produkteve lokale dhe rajonale.
- Prezenca ne rritje e investitorëve te huaj , që mundëson krijimin e ekonomive te shkallës, tejkalimin e pengesave te mungesës se likuiditetit per financimin e prodhimit dhe përshtatjen e prodhimit bujqësor shqiptar me kërkesat e cilësisë dhe gjurmueshmërisë te kërkuara nga normativat evropiane.

Rreziqet

- Varfëria, përjashtimi social dhe informaliteti ne proceset prodhues dhe urbane mund te shndërrohen ne probleme sociale
- Braktisje ne rritje e vendbanimeve rurale dhe malore te brendshëm dhe i zonave bujqësore me përdorim bujqësor dhe blegtoral

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Migrim drejt zonave urbane fushore

- Zaptim i tokave prodhuese bujqësore për përdorim rezidencial, edhe në mungesë të drejtës së pronësisë

- Paaftësi e sistemit territorial lokal për të tërhequr projekte dhe investime në prodhim, për shkak të faktorëve të shumtë të dobësisë territoriale (mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve)

- Degradim territorial ne rritje, si pasoje e paaftësisë së kontrollit të zhvillimit të territorit dhe në orientimin e zhvillimit dhe rinovimit urban

- Mungesa e koordinimit dhe marrëdhënieve efikase midis organeve të ndryshme të qeverisjes administrative (administratat lokale dhe rajonale)

- Mungesa e riorganizimit te "makinës" administrative lokale në periudhën pas reformës administrative

2.1.2.3 Analiza SWOT - Sistemi Natyror

PIKAT E FORTA

- prezenca e aseteve të shumta natyrore, si:

a. Parku i Qafë Shtamës

b. Kodrat e Krastës

c. Mali i Krujës

d. Monumentet e shumtë natyrorë

- Biodiversitet i lartë i pranishëm në territor, i shprehur nga pasuria e florës dhe e faunës e karakterizuar nga lloje të shumta endemike (që nuk gjenden në vende të tjera) dhe nga prezenca e specieve që motivojnë përcaktimin e zonave të mbrojtura ekologjike mjedisore (rrjeti Emerald i Bashkimit Europian), si : ujku, ariu, breshka e tokës dhe e detit.

PIKAT E DOBËTA

- Mungesa e mjeteve të kontrollit dhe pengimit te modifikimit dhe shkatërrimit te peizazhit natyral dhe resurseve ekologjike nga ana e administratave publike.

- Ndërgjegjesim i ulët publik ne masat dhe mjetet e kontrollit mjedisor

- Përhapja e vendbanimeve joformale dhe spontane në zonat e mbrojtura dhe me ndjeshmëri të lartë mjedisore, (shtretërit e lumenjve, rripat bregdetarë)

- Degradim progresiv i cilësisë mjedisore te përgjithshme, për shkak te mungesës se sistemeve te trajtimit, rimëkëmbjes, riciklimit dhe ripërdorimit te mbetjeve solide urbane.

- Mungesë analoge e sistemeve te përshtatshme te trajtimit te mbetjeve solide urbane, sidomos ne kontekstin bujqësor dhe përhapjen urbane

- Mungesa e masave te kompensimit dhe lehtesimit te impakteve mjedisore te prodhuara nga komplekset e mëdha industriale (fabrikat e çimentos) dhe nga aktivitet e minierave (guroret e gëlqeres ne kodrat e Krastës dhe impiantet e tjera minerale te rajonit)

MUNDËSITË

- Mundësia e zhvillimit te turizmit natyror, ekskursionistik, sportiv, kulturor dhe arkeologjik, qoftë ne zonat e brendshme ashtu edhe ne zonat bregdetare

- Mundësi e turizmit dhe e aktiviteteve te kerkimit dhe eksperimentimit ne fushën mjedisore dhe ne zonat e mbrojtura

- Përmirësimi i përgjithshëm i ekuilibrave ekologjik dhe i faktorit te biodiversitetit për politika te përshtatshme te mbrojtjes dhe progresit ekologjik lokal

- Permirësimi i përgjithshëm i cilësisë se jetesës ne qendrat dhe ne kontekstet urbane për realizimin e ndërhyrjeve te zbutjes dhe kompensimit te ndikimeve te prodhuara nga impiantet industriale, aktivitetet e nxjerrjes se mineraleve, ndotja nga infrastrukturat rrugore dhe aeroportuale

RREZIQET

- Rritje e metejshme e vdekshmërisë dhe e sëmundjeve si pasoje e aktiviteteve industriale dhe te minierave jo te rregullta ne aspektin mjedisor

- Rritja e shtrirjes urbane ne dëm te zonave me interes dhe vlera mjedisore dhe peizazheve

- Humbja e resurseve ujore prej ndotjes se akuiferëve sipërfaqësorë dhe nëntokësorë

- Ulja e cilësisë se ajrit dhe mjedisit për shkak te shpyllëzimit progresiv te zonave malore, zonave liqenore, bregdetare dhe te shtretërve te lumenjve.

- Rrezik i lartë zjarresh për shkak te mungesës se kontrollit, menaxhimit te aktiviteteve pyjore dhe blegtorale, mungesa e kundërvënies ndaj krimit te organizuar

- Humbje progresive e biodiversitetit te kafshëve, zvogëlimi i specieve te mbrojtura, për shkak te mungesës se rregullave, kontrolleve dhe programimeve te aktivitetit te gjuetisë

2.1.2.4 Analiza SWOT – Sistemi Ujor

PIKAT E FORTA

- Prania e resurseve te pasura ujore si ne nëntokën dhe ne sipërfaqe

a. rrjedha uji gjithëvjeçare

b. basene ujore natyrore

c. basene ujore artificiale

d. rrjeti i kanalizimeve artificiale per përdorim bujqësor

PIKAT E DOBËTA

- Rrezik i larte nga përmbytjet ne zonat urbane dhe bujqësore

- Mungesa e mirëmbajtjes se rrjetit te ujitjes dhe te hidrovoreve

- Shkarkimi i mbetjeve urbane ne shtratin e rrjedhave te ujit natyrore dhe artificiale

- Shkarkimi i ujërave te zeza ne rrjetin e kullimit sipërfaqësor

- Mungesa e furnizimit te drejtpërdrejtë me ujë te pijshëm ne shumë fshatra dhe qendra te vogla urbane

- Kapacitet i ulët i furnizimit me ujë i te gjitha qendrave urbane

- Mungesa e te ardhurave te përshtatshme nga tarifimi i resurseve ujore

MUNDËSITË

- Permirësimi dhe zhvillimi i sistemeve ekzistuese te ujitjes për bujqësinë

- Shfrytëzimi i potencialit hidroenergjetik akoma te papërdorur.

- Racionalizimi i përdorimit te resurseve ujore te pijshme, nëpërmjet masave dhe mjeteve te menaxhimit me te mirë te resurseve te tilla

- Fuqizimi i sistemeve te menaxhimit dhe te shpërndarjes se ujërave publike, te menduara si te mira te përbashkëta

- Rikualifikim dhe rigjenerim ne aspektin ekologjik mjedisor te trupave kryesorë ujorë, me dobi te ekosistemeve lokale dhe te një zhvillim te mundshëm te turizmit sportiv.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA KOMBËTARE E ZHVILLIMIT TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

RREZIQET

- Përkeqësimi i ekosistemeve lokale për shkak të ndotjes së trupave ujor natyralë dhe artificial

- Humbje progresive e pakthyeshme e resurseve ujore të pijshme, për shkak të ndotjeve industriale, bujqësore për shkak të pesticideve dhe plehrave kimike, mbetjet solide dhe të lëngshme urbane, puset e ujërave të zeza të shpërndara gjerësisht në zonat bujqësore urbane

- Përmbytjet dhe aluvionet periodike, lidhur edhe me përshkallëzimin e fenomeneve meteorologjike, si pasojë e ndryshimeve klimaterike dhe të rritjes së temperaturave mesatare

- Humbja e jetëve njerëzore, dëme ndaj njerëzve dhe materialeve, shkatërrimi i ekonomive, infrastrukturave dhe pasuri e patundshme si pasojë e fenomeneve të sipërpërmendur

- Modifikimi dhe humbja e cilësisë së peizazheve bregdetare dhe lumore

- Mungesa e vlerësimit si në terma ekonomik të resurseve ujore dhe termale ashtu edhe në terma turistik (turizmi termal, turizmi sanitar)

2.1.2.5 Analiza SWOT – Sistemi Bujqësor

PIKAT E FORTA

- Prezenca e aktiviteteve të konsiderueshme bujqësore

- Predispozitë e mirë e rrjeteve ujore, edhe pse duhet mirëmbajtur dhe rigjeneruar

- Klima e favorshme dhe ecuria e reshjeve në rajon, favorizojnë rritjen e kulturave të ndryshme bujqësore

PIKAT E DOBËTA

- Fragmentimi i lartë i pronave bujqësore, përmasa të vogla të prodhimit dhe të punësimit të ndërmarrjeve bujqësore lokale

- Gjendje e përhapur problematike në lidhje me pronësinë e tokës.

- Mungese organizimi e sektorit të prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore

- Mungesa e shërbimeve dhe infrastrukturës në mbështetje të sektorit

- Mungesa e qendrave të magazinimit të ushqimeve, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore në tregjet lokale dhe kombëtare

- Niveli përgjithësisht i ulët i teknologjisë dhe njohurive të sektorit, nivel i ulët i arsimit dhe njohurive të punëtorëve të sektorit.

MUNDËSITË

- Mundësia e eksportit të produkteve tipike bujqësore organike në tregjet lokale, në zonën metropolitane dhe në perspektivë, në tregjet e Ballkanit dhe vendeve të Adriatikut

- Mundësia e rritjes së prodhimit në sera dhe hidroponike

- Mundësia e rinovimin dhe zhvillimin të llojeve të reja dhe të vjetra të bimëve cilësore, në lidhje me bujqësinë organike, në territoret kodrinore dhe të rrëzës së malit (sidomos në kultivimin e ullirit, vreshtave dhe pemëtarisë)

- Zhvillimi dhe rimëkëmbja e pylltarisë, bujqësisë dhe aktivitete blegtorale në zonat rrëzë malit, në lugina dhe zonat malore të brendshme, edhe në fushën e bimëve aromatike dhe mjekësore, të kulturës së peshkut në zonat kënetore dhe bregdetare.

- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i aktiviteteve blegtorale në zonat fushore dhe aktiviteteve blegtorale në zonat kodrinore dhe malore

- Organizimi i fermerëve të vegjël dhe të mesëm në forma të shoqatave kooperative.

- Trajnimi dhe mbështetja për formimin e kopshteve urbane të shpërndara në zonat e margjinalizim të madh dhe varfërisë urbane

- Krijimi i qendrave kërkimore në fushën agro-ushqimore dhe të edukimit në ushqim e mirëngrënie, madje edhe në sferën arsimore-edukative

- Zhvillimi i një sistemi të ofertave te hotelerisë cilësore, lidhur me vlerësimin e produkteve dhe traditave ushqimore lokale, kultivimin e peshkut dhe peshkimin.

RREZIQET

- Rritja progresive e përdorimit të tokës bujqësore për banim, që sjell fragmentimin e tokave dhe përfitimit bujqësor

- Problemet e pasojave territoriale të lidhura me sistemin e pronësisë

- Humbja e tokës bujqësore për shkak të përmbytjeve të mundshme të përsëritura të lumenjve (pasojat ekonomike të rrezikut të pakontrolluar hidro-gjeologjike)

- Humbja e tokës dhe kulturës së specializuar bujqësore për shkak të braktisjes dhe degradimit mjedisor që rrjedh prej tij

- Humbja e cilësisë dhe vlerës së peizazhit - kodrat e Krastës - për përhapjen pa kontroll të aktiviteteve nxjerrëse të guroreve, planet mjedisore të riaftësimit dhe për shkaqet e braktisjes së kulturave të specifike (ullinj, vreshtat, pemëtoret)

- Humbja progresive e traditave dhe kulturës agro-ushqimore lokale, me pasoja në karakterin e përgjithshëm të kulturave dhe traditave lokale

2.1.2.6 Analiza SWOT – Sistemi Urban

PIKAT E FORTA

- Prania e zonave urbane me mundesi dendësimi te ndërtesave dhe të rritjes së faktorëve urbanë (urbanizim dhe shërbime)

- Prania e ndertimeve te reja ose e ndertesave me moshë mesatare, pa probleme serioze strukturore

- Zona urbane te karakterizuara nga funksione mikse, pa probleme të dukshme ndarjeje

- Kosto të ulëta ndërtimi

- Prania e zonave industriale

- Prania e një qendre historike me impakt kombëtar dhe ndërkombëtar (Kruja), subjekt i ndërhyrjeve rimëkëmbjes urbane në kohët e fundit.

- Prania e zonave me interes historik dhe kulturor (kështjella e Krujës, zona arkeologjike e Zgërdheshit) Pikat e dobëta

- Mungesa e hapësirave të gjelbra në zonat rezidenciale

- Mungesa e hapësirave të dedikuara lojërave të fëmijëve dhe kohës së lirë të të moshuarve

- Mungesa e ndërtesave publike me funksion specifik të lidhur me kulturën, artin dhe turizmin

- Degradimi i zonave urbane, urbanizim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

• Prani e gjerë e ndërtimeve informale dhe e ndërtesave edhe në zona bujqësore në mungesë totale të veprave të urbanizimit primare dhe sekondare

• Prania e problematikave të ndryshme të lidhura me akomodimin, në veçanti lidhur me kërkesën e ndërtimit social

• Rritje urbane spontane përreth kornizës infrastrukturore dhe rurale. Zhvillimi është i tipit spontan, jo i planifikuar dhe është i karakterizuar së pari nga intensifikimi i të ndërtuarit në zonat qendrore dhe pranë rrugëve kryesore të qarkullimit

• Mungesa e hapësirave publike dhe cilësi e dobët e atyre ekzistuese.

• Mungesë e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave urbane

• Prania e ndërtimeve të reja ose me moshë mesatare, që nuk respektojnë normat ndërkombëtare të sigurisë sizmike dhe të kursimit të energjisë

• Prania e një pjese të konsiderueshme të ndërtesave publike tashmë të ndërtuara, me cilësi të ulët ose të keqe të ndërtimit, paqartësi pronësie, që nuk respektojnë standardet normale të ndërtimit dhe natyrisht standardet ndërkombëtare të mbrojtjes sizmike dhe të kursimit të energjisë, me aspekt ose shumë pak vlerë ekonomike

• Mungesë e respektit për zonat me vlerë të madhe historike, me impakt të rëndësishëm në terma të peizazheve vizuale dhe pikëpamjeve të përgjithshme (qendra historike e Krujës)

MUNDËSITË

• Rehabilitimi administrativ dhe urbanistik i ndërtesave informale në proces legalizimi

• Mundësi e zhvillimit të zonave industriale me anë të prodhimit cilësor në sektorin e mobilieve, e përbërësve të ndërtimit, e sektorëve prodhues, të transporteve, lidhur edhe me prezencën e aeroportit ndërkombëtar Nënë Tereza

• Përmirësimi i sistemit të lëvizshmërisë, nëpërmjet realizimit dhe riorganizimit të rrjetit automobilistik dhe integrimit dhe rritjes së rrugëve pedonale dhe pistave çiklistike

• Zhvillimi i sektorit turistik në lidhje me historinë dhe kulturën, sportin dhe natyrën, fenë , itineraret eno-gastronomike (turizmi me bazë ushqimet lokale), lidhur me ofertat e reja pritëse (hotele, bed&breakfast, agro-turizmi, hostelet rinore, kampingjet) dhe me shërbimet plotësuese të turizmit (zona sportive, golfi, qendrat e hipizmit, shtigjet e kalërimit, qendrat sportive të integruara, parqet për aventura, etj.)

• Mundësia e ndërtimit të ndërtesave publike (shërbime publike) në terrenet në pronësi të bashkisë, ose në formën e kompensimeve të të drejtës së pronësisë mbi prona private, sipas programeve të barazisë urbanistike

• Mundësia e realizimit të veprave të urbanizimit në formën e një konsorciumi për zbritjen e kostove të urbanizimit ose nëpërmjet operacioneve Project Financing (projekte të vetëfinancuara)

RREZIQET

• Degradimi i përgjithshëm i gjendjes së banesave dhe i mjedisit urban

• Humbja e karakterit dhe e identitetit të qendrave historike

• Ndotje progresive dhe rritje e rrezikut mjedisor që vjen nga industritë ekzistuese (në veçanti fabrikat e çimentos, industritë e minierave dhe guroret e gëlqeres)

• Humbje progresive e jetës sociale në qendrat e vogla rezidenciale

• Braktisje dhe degradim progresiv, zvogëlim i dendësisë së popullsisë në zonat malore lindore, si pasojë e pamundësisë së shtrirjes së shërbimeve

• Prirja për vazhdimësinë e fenomeneve te ndertimit te paligjshëm, për shkak të mungesës së rregullave, kontrollet dhe rregullat sanksionuese, si faktor alternimi i tregut të ligjshëm të banesave dhe të shërbimeve, dhe si gjendje degradimi të përgjithshëm urban.

2.1.2.7 Analiza SWOT – Sistemi Infrastrukturor

PIKAT E FORTA

• Pozicioni dhe afërsia me korridoret e mëdha kombëtare të trafikut dhe me nyjet kryesore te transportit (Aeroporti, Porti i Durrësit, Hekurudha, Korridori Veri-Jug)

• Mbulim i plotë nga rrjeti elektrik i zonës kryesore urbane

• Prania e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza"

PIKAT E DOBËTA

• Infrastruktura rrugore në gjendje të keqe

• Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të zeza

• Mungesa e një sistemi racional te largimit te mbetjeve urbane

• Mungesa e një rrjeti te transportit publik mes qendrave urbane dhe në brendësi te qytetit

• Braktisja dhe mospërdorimi i rrjetit hekurudhor

• Mosrespektim i distancave te ndërtimeve te reja nga kufiri i rrugeve, veçanërisht përgjatë aksit kombëtar dhe rrugës së vjetër kombëtare

• Rrezikshmëri e lartë dhe nivel i lartë aksidentesh ne kryqëzimet dhe nyjet lidhëse (kryqëzimet në disnivel) te rrjetit rrugor kryesor dhe dytësor

MUNDËSITË

• Rivitalizimi i rrjetit hekurudhor, qoftë nga pikepamja e lidhjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (lidhje me Malin e Zi) dhe si bazë e riorganizimit te marrëdhënieve ne shkallë metropolitane dhe lokale

• Zhvillimi i turneve tematike ne mbështetje te turizmit kulturor dhe mjedisor dhe te lidhur me vlerësimin e resurseve bujqësore dhe ushqimore lokale

• Zhvillimi i një rrjeti te lëvizshmërisë te ngadaltë, te integruar me realizimin e rrjetit ekologjik rajonal dhe kombëtar. Mundësi e lidhjes direket midis Krujës dhe Tiranës

• Mundësia e transformimit te Krujës dhe Qafë Shtamës ne pika kryesore te terheqjes se flukseve te turizmit kulturor dhe mjedisor te kryeqytetit dhe te zonës metropolitane te Tiranës

• Mundësia e krijimit te një qendre logjistike strategjike te lidhur me afërsinë me aeroportin ndërkombëtar dhe nga porti kryesor turistik dhe tregtar i vendit (Durrësi)

• Mundësia e zhvillimit dhe integrimit e zonave te tipit Qendra Biznesi pranë aeroportit ndërkombëtar

RREZIQET

• Zhvillim urban përgjate akseve infrastrukturore dhe lidhjeve te tyre, qe sjell rreziqe reciproke per efiçencën e brendshme si te sektorit te sistemeve urbane ashtu edhe te mobilitetit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Degradim progresiv i rrjeteve ekzistuese i pazbutur dhe i papërballur për shkak të mungesës së resurseve të përshtatshme dhe nga nevoja në rritje për investime

- Mungesa e fondeve për mirëmbajtjen e duhur të rrjeteve dhe infrastrukturave

- Rreziqe të lidhura me realizimin e infrastrukturave të reja, pa ndërhyrjet e duhura të masave zbutëse: ndotja e resurseve natyrore, rritja e pakontrolluar urbane, impakt mbi peizazhin dhe mbi zonat natyrore.

2.1.3 Analiza metabolike

2.1.3.1 Hyrje

Sipas përcaktimeve të VKM 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të territorit", analiza metabolike është pjesë e hartimit të strategjisë territoriale të PPV dhe një model për analizën dhe identifikimin e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Në një vështrim të përgjithshëm, qyteti shihet si një organizëm i gjallë që ka nevojë për energji dhe burime për të funksionuar dhe që nga funksionimi i tij prodhohen mbetjet. Modeli krijon mundësinë e studimit të ndërveprimit midis sistemeve natyrore dhe njerëzore në një rajon. Kjo analizë studion flukset në territorin urban. Analiza zhvillohet përmes identifikimit të hyrjeve dhe daljeve kryesore në sistemin urban. Metabolizmi mund të përcaktohet si tërësia funksionale e proceseve sociale, ekonomike dhe teknike që ndodhin në qytete, si pasojë e rritjes së tyre, prodhimit të energjisë si dhe asgjësimit të mbetjeve. Analiza i shërben VSM duke ndihmuar identifikimin e ndotjes së ujërave dhe ajrit, shpërdorimin e burimeve, humbjen dhe degradimin e tokës, energjinë e nevojshme që harxhohet, si dhe lidhjen që kanë qytetet me periferinë. Ky është në thelb një bilanc i ndikimit të qytetit në mjedis që përcakton masa përmirësuese apo neutralizuese të ndikimit negativ. Praktikisht, metabolizmi i një sistemi urban është një përmbledhje e numrit të hyrjeve dhe daljeve (input-output) dhe mënyrës së përdorimit të ujit, energjisë, ushqimit, mbetjeve etj. në të.

Hyrjet në sistemin urban (toka, uji, ajri, energjia, burimet e tjera) ndryshojnë pasi kalojnë në të, duke u transformuar në dalje (mbetje dhe shkarkime në ajër, ujë dhe tokë). Nëpërmjet analizës kryhet bilanci i burimeve natyrore të shfrytëzuara (hyrjet), mënyrës së përdorimit të tyre dhe ndotjeve e humbjeve që shkaktohen në sistemin urban (daljet). Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyres së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që mundësojnë funksionimin e territorit si një i tërë. Strategjia e mbështetur në analizën metabolike, mbështetet mbi parimet e qëndrueshmërisë dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban.

Metabolizmi konsiderohet si një proces dinamik fluksesh në një vend të dhënë, në një moment të dhënë, në një stad të dhënë të zhvillimit urban, dinamikë e cila shpjegohet me konceptin e vazhdimësisë ekologjike. Me "vazhdimësi ekologjike" kuptohen proceset e ndryshimeve në strukturën e specieve të një bashkësie ekologjike përgjatë kohës; ky proces varet nga kushtet klimatike, tokës dhe ndërhyrjet njerëzore.

Fluksi i energjisë dhe ujit do të kenë një analizë paraprake në shkallë rajoni e më pas në shkallë bashkie meqenëse këto burime menaxhohen në rang kombëtar dhe nuk gjenerohen tërësisht në territorin e bashkisë. Sidomos burimet ujore, kalojnë në disa sisteme urbane (lumenjtë) duke mbartur me vete edhe ndotjen që shkaktohet nga këto sisteme.

Për matjen e flukseve është përzgjedhur metoda LCA (Life Cycle Assesment) e cila mundëson vlerësimin e ciklit të jetës së burimeve. Gjithashtu, LCA vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore, qe nga shkaku (fillimi) deri në eliminimin total të tyre.



Fig. 44 Harta e flukseve në territorin e Bashkisë Krujë

2.1.3.2 Energjia dhe uji në rajon

Bashkia Krujë shtrihet ndërmjet Rajonit Qendror dhe atij Verior të vendit dhe në aspektin gjeografik dhe zhvillimor lidhet me bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Tiranë, Vorë dhe Kamëz. Në bilancin e energjisë dhe burimeve për bashkinë Krujë na duhet të konsiderojmë një rajon më të gjerë që mundëson një vlerësim të plotë e të qartë të flukseve dhe ndërveprimit në shkalle territoriale. Në këtë kuadër, rajoni në analizën metabolike nënkupton bashkinë Krujë si dhe njësitë e tjera administrative dhe territoriale që bashkëveprojnë në mënyrë të ndërsjellë me këtë territor.

Energjia

Shqipëria ka një potencial të madh hidroenergjitik, prej të cilit është shfrytëzuar vetëm 35.4 % e tij. Në shkallë vendi, kapaciteti i fuqisë së instaluar është 1,466 MW dhe prodhimi mesatar i energjisë arrin në 5.283 GWh. Rezervat totale hidroenergjitike lejojnë instalimin e një rrjeti energjitik prej 4,500 MW dhe prodhimi vjetor i energjisë mund të arrijë deri në 16 TWh. Në mbarë vendin janë 107 kontrata koncesionare në proces me një kapacitet total prej 1,386 MW që do të mundësojnë rritjen e burimeve energjetike të rajonit. Energjia hidrike në rajon shfrytëzohet përmes HEC- eve kryesisht në lumin Drin dhe Mat.

Hidrocentralet e mëdha

Numri i hidrocentraleve në funksionim është 7 hidrocentrale të mëdha dhe 38 të vogla.

Mbi lumin Drin ndodhen tre hidrocentrale në funksionim me një fuqi të instaluar në total prej 1,350 MW: në Vaun e Dejës, në Koman dhe Fierzë. Një kontratë koncesionare është nënshkruar për ndërtimin e një hidrocentrali tjetër në Ashtë, mbi lumin Drin, midis Qeverisë Shqiptare dhe dhe kompanisë austriake " Österreichische Elektrizitätsëirtschafts - Aktiengesellschaft ", me një kapacitet të instaluar 48.2 MW.

Mbi lumin Mat ndodhen dy hidrocentrale në funksionim, Ulëza dhe Shkopeti, me një fuqi të instaluar prej 49 MW.

Hidrocentralet e vogla

Në shkallë vendi numërohen 70 hidrocentrale të vogla me kapacitete që renditen midis 20 dhe 9,200 kW. Vetëm 38 prej tyre janë funksionalë, ndërsa të tjerët janë jo operacionalë. Midis tyre, 32 hidrocentrale funksionojnë në bazë të kontratave koncesionare (kapacitet i instaluar 24.4 MW), 16 janë privatizuar dhe operojnë me një kapacitet të instaluar 2,047 MW dhe 22 janë pronë shtetërore me një kapacitet të instaluar 11 MW.

Qëllimi i ndërtimit të këtyre hidrocentraleve të vogla është furnizimi me energji i zonave të thella malore. Ato janë të tipit me derivacion dhe përdorin ujin e rrjedhave ujore në afërsi të tyre.

Nr.	Hidrocentrali	Fuqia e instaluar (kW)	Kapaciteti prodhues vjetor (kWh)
1.	Ulëza (Mat)	25.000	120.000.000
2.	Shkopeti (Mat)	24.000	90.000.000
3.	Bistrica I (Sarandë)	22.500	100.000.000
4.	Vau i Dejës (Shkodër)	250.000	1.000.000.000
5.	Fierza (Tropojë)	500.000	1.800.000.000
6.	Komani (Pukë)	600.000	2.000.000.000

Tabela 6 Fuqia dhe kapaciteti i hidrocentraleve në vend



Fig. 45 Ndarja në zona sipas shpejtësisë së erës dhe orëve vjetore

Burimet alternative

Burimet energjetike alternative janë shumë pak të shfrytëzuara. Energjia diellore, ajo e erës apo energjia gjeotermale nuk kanë gjetur ende përdorim të gjerë. Potencialisht, ka mundësi të mira për shfrytëzimin e këtyre tre formave të energjisë për bashkinë e Krujës. Zonat fushore të bashkisë kanë një potencial të lartë për përdorimin e energjisë së erës.

Energjia e erës përdoret për pompimin e ujit, mullinjtë me erë dhe në dekadat e fundit, vëmendja është përqendruar në prodhimin e energjisë elektrike. Makineritë që operojnë me energjinë e erës kanë një kapacitet të instaluar që ndryshon nga disa kW deri në 5 MW dhe po përdoren me sukses në zona të veçuara. Energjia e erës është një potencial i konsiderueshëm si burim energjie dhe është e shpërndarë njëtrajtësisht në çdo cep të botës. Mullinjtë me erë mund të instalohen shpejt dhe përdorin një sipërfaqe të vogël toke. Në shumicën e shteteve, instalimet e mullinjve me erë përballen me një shqetësim të përbashkët, mungesën e matjes së vazhdueshme të shpejtësisë së erës dhe me mungesën e erës së përhershme.

Për këtë arsye, shoqëritë e ndryshme që duan të investojnë në këtë sektor e kanë të vështirë të marrin një vendim nëse ia vlen të investohet në një rajon të caktuar pa këto të dhëna të domosdoshme. Të dhënat e marra nga stacione të ndryshme meteorologjike në Shqipëri janë të përafërta dhe jo shumë të besueshme, sepse nuk janë mbledhur me qëllimin specifik të matjes së energjisë së erës.

Ekzistojnë plane të mëdha për zhvillimin e energjisë së erës në Shqipëri në vitet e ardhshme me investime të konsiderueshme, me një total të centraleve të erës të licencuar me fuqi 1,300 MW. Duke pasur si qëllim vlerësimin e potencialit të këtij burimi, është vlerësuar niveli i prodhimit të parqeve eolike të planifikuar për ndërtim në Shqipëri.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Emri i shoqërisë	Vendndodhja	Kapaciteti i instaluar (MW)	Faktori i ngarkesës	Fuqia mesatare efektive gjatë një viti (MW)	Prodhimi vjetor (GWh, vlerësim i kompanisë)	Prodhimi vjetor (GWh, vlerësimi i studimit)	Afati për vënien në punë	Data e lëshimit të licencës
HERA sh.p.k	Bilisht Kapshticë	150	23.8 %	35	330	312	2014	Nëntor 2007
Alb Wind Energy sh.p.k	Grykëderdhja e Shkumbinit Tërpan	225	20.7 %	46	484	407	2013	Janar 2008
Enpower Albania sh.p.k	Karaburun Llogara	500	25.9 %	129	1,369	1,134	2015	Tetor 2008
Ers-08 sh.p.k	Kryevidh Kavajë	40	21.0 %	8	68	73	2013	Qershor 2008
Biopower Green Energy sh.p.k	Shëngjin, Kodrat e Rencit Lezhë	230	22.0 %	50	450	481	2013	Gusht 2008
Unione Eolika Albania sh.p.k	Kryevidh Kavajë	150	24.3 %	36	300	319	2012	Gusht 2008
E-Vento Albania sh.p.k	Butrint Markat	72	23.2 %	17	65	146	2012	Korrik 2008
TOTALI		1,367			3,066			

Tabela 7: Lista e parqeve eolike për të cilat është dhënë licenca për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë elektrike

Disponueshmëria e parkut eolik ose faktori i ngarkesës (përqindja e kohës gjatë së cilës turbinat e erës janë në gjendje pune me ngarkesë të plotë), konsiderohet universalisht si problemi më i madh për energjinë e erës. Pasiguria mbi sasinë që do të prodhojë një park eolik është një sfidë më vete. Metodologjia e parashikimit dhe vlerësimet e burimeve të erës janë detyra të specialistëve. Matjet mesatare vjetore të erës ndërmjet 5.8 m/s deri në 7 m/s në zonat e kërkuara janë premtuese. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet që faktorët e ngarkesës në mënyrë tipike variojnë nga 22 % deri në 25 %.

Gjatë periudhës 2010 - 2014, ka vazhduar dhënia e licencave, dhe deri në fund të dhjetorit 2014 në Shqipëri, totali i tyre shkon përafërsisht në 2,548 MW, në bazë të informacionit të dhënë nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me potencial prodhimi energjie prej rreth 5 TWh/vit. Kapaciteti i sistemit elektrik shqiptar për të dërguar dhe përthithur energjinë e erës është vlerësuar përafërsisht deri në 180 - 200 MW. Duke qenë se era është një burim energjie me probabilitet të ulët, është i nevojshëm realizimi i balancimit. Kombinimi i erës dhe i burimeve hidrike është një opsion i mirë. Centralet hidrike mund të futen në punë në çdo moment, prandaj janë një balancues i shkëlqyer për centralet e erës.

Ekziston një shumëllojshmëri burimesh gjeotermale, të cilat mund të klasifikohen në: burimet hidrotermale,

rrymat e nxehta të ujit dhe shkëmbinjtë e shkrirë. Nga këto tre grupe, deri më tani, vetëm burimet hidrotermale kanë gjetur përdorim praktik në Shqipëri. Burimet hidrotermale, shumicën e kohës janë burime energjie gjeotermale që prodhojnë ujë të nxehtë dhe përdoren në disa shtete për ngrohje të ambienteve te ndryshme.

Një teknikë e re përdorimi e energjisë gjeotermale është injektimi i ujit të ftohtë në puse të thella nafte dhe gazi natyror, të cilat tashmë nuk përdoren më, për t'u ngrohur. Uji injektohet me një temperaturë 7 - 8 °C dhe del në sipërfaqe me një temperaturë 22 - 25 °C. Në Shqipëri ka pak shpresa për të prodhuar avull nga burimet gjeotermale, por ka disa burime hidrotermale me temperaturë më të ulët.

Burimet më të rëndësishme gjeotermale të eksploruara deri më tani në Shqipëri janë:

- Sipërfaqja gjeotermale e Krujës, e cila është zona me burimet më të mëdha gjeotermale në Shqipëri, me një sipërfaqe 18 km gjatësi dhe 4,5 km gjerësi, e cila përmban rezerva të një game 5.9 x 108 - 5.1 x 109 GJ.

- Zona gjeotermale e Ardenicës ku uji del nga thellësia me një temperaturë 32 - 38°C dhe rrjedh në sipërfaqe me një prurje me 15 - 18 l/s.

- Zona gjeotermale e Peshkopisë ku ndodhen disa burime gjeotermale të vendosur pranë njëri-tjetrit. Prurja e ujit është rreth 14 - 17 l/s dhe temperatura është 35 - 43,5°C.

Energjia diellore në rajon është lehtësisht e shfrytëzueshme në të gjithë territorin e Bashkisë. Numri i lartë i orëve me diell (2300-2500 orë / vit), dhe rrezatimi në vlerat 1400 – 1500 kWh/m² në vit mundëson rendiment mjaft të lartë në përdorimin e këtij burimi.

Shfrytëzimi i burimeve alternative të energjisë do të mund të nxisë modelet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të garantojë ruajtjen e mjedisit dhe ekosistemit.

Nr.	Vendndodhja e burimit hidrotermal	Temperatura (°C)	Emri i pusit	Temperatura e ujit në sipërfaqe (°C)
1	Karmë-Sarandë	34	Ishmi-1/b	60
2	Langaricë-Përmet	26 - 31	Kozan-8	54
3	Sarandapori-Leskovik	26 - 27	Galigati-2	45
4	Tërvoll-Gramsh	24	Bubullima-5	48 - 50
5	Llixha-Elbasan	58	Seman-1	35
6	Kozan-Elbasan	57	Ardenica-12	32 - 38
7	Shupal-Elbasan	29 - 30		
8	Mamurras-Kurbin	21		
9	Peshkopi	35 - 43.5		

Tabela 8: Burimet gjeotermale në Shqipëri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Fig. 46 Energjia diellore në Shqipëri

Uji

Rajoni është i pasur me ujra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Territori i rajonit përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Mati dhe Ishmi si dhe ndikohet nga afërsia me lumenjtë Drin, Buna, Fan, Erzen dhe Shkumbin. Shfrytëzimi i lumenjve për prodhimin e energjisë është potenciali kryesor me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e rajonit. Në zonën veriore të rajonit ndodhen edhe HEC-et kryesore të cilat furnizojnë me energji një pjesë të konsiderueshme të territorit të Shqipërisë (Ulëza, Shkopeti, Fierza, Komani, Vau i Dejës, dhe Ashta).

Rrjeti hidrografik i territorit të Bashkisë së Krujës përbëhet prej disa lumenjve ku ndër më kryesorët janë Lumi i Zezës, që kalon nëpër qytetin e Fushë Krujës, i cili pasi bashkohet me Lumin e Gjolës formojnë Lumin e Ishmit. Ujërat nëntokësore në territorin e rajonit ndodhen kryesisht në zhavorret ujëmbajtëse të akuiferit Fushë - Kuqe, Fushë - Milot, Laç. Shfrytëzimi intensiv i këtij akuiferi ka filluar që në vitin 1964 me kryerjen e një sërë shpimesh me rrotullim dhe me goditje në zonën e Fushë - Kuqes dhe Adriatikut. Pas vitit 1966 hynë në shfrytëzim edhe shpimet e Milotit nga ku merren rreth 460 l/s. Po ashtu shpimet e Laçit japin rreth 250 l/s. Në këtë mënyrë nga zhavoret aluviale të pjesës jugore të pellgut të Matit (akuiferi Adriatik - Fushë - Kuqe - Laç - Milot) merren mbi 1500 l/s.

Perveç sasisë së ujërave nëntokësore që merren si në krahun verior të Lumit Mat, ashtu dhe në krahun jugor të zonës, zonë tjetër në perspektivë për marrjen e burimeve ujore suplementare është edhe grykëderdhja e vetë Lumit Mat.

Kjo pjesë kufizohet nga Rrila e Planës në veri të Lumit Mat dhe që vazhdon me Gurrzën, Fushë-Milotin dhe vetë zallishten e lumit Mat, përbën zonën më me perspektivë të pellgut të Matit. Shpimet e kryera në këtë zonë kanë kapur zhavore me trashësi mbi 100 m, të

cilat formojnë një shtresë ujëmbajtëse me parametra hidraulike shumë të lartë dhe me cilësi uji shumë të mirë. Bazuar në llogaritjet e bëra, në këtë zonë mund të merren rreth 2500 l/s ujë, pa ndikuar në regjimin e akuiferëve të tjerë.

Ujërat nëntokësorë në territorin e Bashkisë së Krujës ndodhen kryesisht në zhavorret ujëmbajtëse të akuifereve bregdetare të pellgut ujëmbledhës të Lumit Gjole dhe Ishëm. Akuiferi më i rëndësishëm në këtë zonë është akuiferi i Fushë - Krujës. Shfrytëzimi intensiv i këtij akuifereve ka filluar që në vitet '70 (rreth 800 l/s ujë qytetit të Fushë Krujës, Vorës e Durrësit). Në këtë mënyre nga zhavorret aluviale merren mbi 1500 l/s. Ky akuifer është vazhdim i akuiferit të madh me porozitet kokrrizor të shkrifët me ujëpërcjellshmëri shumë të lartë Tiranë-Adriatik. Përfaqësohet nga depozitime zhavorore ujëmbajtëse të Kuaternarit. Ai ka një sipërfaqe të madhe që shtrihet nga Rinasi, Fushë - Preza, Larushk-Hasan, Ura e Gjoles, Bilaj, Gramëz, Thumanë, në Dukagjin të Ri deri në Adriatik. Përfaqëson një depresion të mbushur me depozitime Kuaternare, kryesisht zhavoror, produkt i materialit të ngurtë aluvial që kanë sjelle lumenjë Tirana, Tërkuza, Zeza, Gjolja dhe Ishmi. Shfrytëzimi i resurseve të akuiferit është një potencial për përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave të banuara.

Në këtë akuifer janë kryer e vënë në shfrytëzim një numër shpimesh për furnizimin me ujë të pijshëm si stacioni Ura e Gjoles, Fushë Kruja, Gramëz, Thumanë. Një numër shpimesh shfrytëzohen për ujë teknologjik dhe ujitje. Në disa raste këto shpime janë kryer shumë afër shtratit të lumenjve duke u rrezikuar nga ndotja që mbartin lumenjtë.

2.1.3.3 Analiza e bashkisë Krujë

Analiza e metabolizmit të territorit të Bashkisë Krujë merr në konsideratë disa faktorë kryesorë që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Bashkia e Krujës ka një sipërfaqe prej 339.02 km2 dhe një popullsi prej 59,814 banorë (Censusi, 2011). Flukset e analizuar në kuadër të analizës së metabolizmit janë energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analiza për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Per te analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin prej tyre, për të kuptuar problemet mjedisore dhe humbjet.

2.1.3.4 Fluksi i energjisë

Fluksi i energjisë tregon raportet midis sasisë së energjisë së prodhuar dhe asaj të konsumuar në territorin e bashkisë Krujë. Këtu trajtohen edhe burimet potenciale që mund të shfrytëzohen duke balancuar burimet e mbishfrytëzuara.

Energjia hidrike e lumenjve brenda territorit të bashkisë Krujë shfrytëzohet në nivele të ulëta pasi edhe lumenjtë që kalojnë në këtë territor nuk janë të shumtë dhe me prurje të konsiderueshme.

Kruja ka potenciale të larta të prodhojë energji gjeotermale pasi përreth qytetit të Krujës janë burimet dhe puset me energji gjeotermale të entalpisë së ulët, që fontanojnë ujë të nxehtë. Ato bëjnë pjesë në zonën gjeotermale të Krujës, e cila është një nga zonat me burime gjeotermale më të mëdha në Shqipëri. Ajo ka një shtrirje të përgjithshme prej 180 km dhe gjerësi 4 - 5 km. Zona fillon nga bregdeti i Adriatikut në veriperëndim të Tiranës dhe vazhdon në juglindje, në Përmet dhe në territorin grek. Kjo zonë ka burime gjeotermale të identifikuara 5.87 x 108 - 5.08 x 109 GJ dhe rezerva specifike 38.5 - 39.6 GJ/m2.

Këto ujëra termale përbëjnë ende një pasuri të pashfrytëzuar. Informacion interesant kanë dhënë shpimet e naftës në strukturat e Ishmit dhe Kozanit, ku gjatë shpimit është evidentuar prania e ujërave me debite të kënaqshme dhe temperatura që luhatet në vlerat 60 - 87 °C.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL · TIRANË · SEKRETARIA

Mundësia e shfrytëzimit të këtyre ujërave termale për prodhimin e energjisë është reale, sidomos duke pasur parasysh faktin se futen në grupin e burimeve natyrore të pashtershme dhe të rinovueshme.

Një burim alternativ energjie që ka potencial për t'u përdorur në territorin e Krujës, është energjia diellore. Kruja ndodhet ndërmjet izolinjave 1450 – 1500 kWh/m2 në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të Tiranës luhatet nga 1.55 në muajin dhjetor deri në 6.78 në muajin korrik. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1 % dhe shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me kolektorë diellorë. Energji tjetër potenciale në Krujë mund të jetë energjia e erës. Në pjesën perëndimore të Bashkisë Krujë shpejtësia e erës arrin deri në 3 m/s.

Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Krujë dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011 sipas INSTAT numri mesatar i personave në një familje është përafërsisht 4 anëtarë. Numri total i Njësive Ekonomike Familjare është: 722,600 familje. Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet (2,587,535)/nr. e familjeve (722,600) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 Mwh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë numrin e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë.

Popullsia banuese gjithsej	**2,821,977**
Numri gjithsej i njësive ekonomike familjare	**722,600**

Tabela 9: Popullsia banuese në Shqipëri (INSTAT, 2011)



Fig. 48 Fluksi i energjisë



Fig. 49 Konsumi i energjisë

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	82,074	35,149	46,925
Dru	42,574	6,537	36,037
Energji elektrike	10,434	8,653	1,781
Gaz	19,242	14,289	4,953
Lloj tjetër energjie (panele diellore, qymyr, naftë, etj.)	365	221	144
Pa ngrohje	9,459	5,449	4,010

Tabela 10: Njësitë ekonomike familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale (INSTAT, 2011)



Fig. 47 Hidrocentralet në territorin e Shqipërisë

Emërtimi	Energjia (MWh)
Energji në dispozicion (Burimi)	7,532,055
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Humbje në rrjet	2,179,157
Familjet	2,587,907
Të tjera	2,443,667

Tabela 11: Bilanci i energjisë elektrike, 2011 (INSTAT, 2011)

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në Bashkinë Krujë, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 51.87 % të NjEF në Bashkinë Krujë përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (23.44 %) dhe më pas nga energjia elektrike (12.71 %).

2.1.3.5 Fluksi i ujit

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në territorin e Bashkisë Krujë dhe sasinë e konsumuar të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, imbotilim (uji i mbushur në shishe), shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdoret për banorët, bizneset, industritë, institucionet etj.

Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në territorin e Bashkisë Krujë, në këtë rast) mund të nxjerrim sasinë totale të ujërave në territor (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia e ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 3.35 km² në të gjithë territorin e Bashkisë Krujë. Pjesë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

të rëndësishme në territorin e Krujës, nga pikëpamja e ujërave sipërfaqësore, zënë kanalet ujitëse.

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse ndodhen në akuiferin e Krujës. Sasia e ujit që mund të shfrytëzohet nga burimet ujore është nga 1500 l/sek. Këto ujëra nëntokësore përdoren për pirje, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike etj.

Nga të dhënat e marra nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Krujë rezulton se territori i qyteteve ka mbulim të mirë me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve (100 % dhe 93 %). Zona e qytetit e merr shërbimin nga UK Krujë, ndërsa njësitë administrative e marrin shërbimin nga puse shpimi. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm nga UK Krujë merr ujë nga ujëmbledhësi i Krujës. Sasia totale e ujit që shfrytëzohet për shërbimin e ujësjellësit në Bashkinë Krujë është 30 l/sek.

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat e UK Krujë dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë dhe numrin e banorëve për çdo km2 në të gjithë territorin e Bashkisë Krujë. Konsumi mesatar i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 50 litra/banorë/ditë.

2.1.3.6 Fluksi i ushqimit

Fluksi i ushqimit, analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Krujë do të analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për thithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast, për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturat ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport.

Sipas të dhënave nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në territorin e Krujës prodhohet një sasi e lartë e produktesh bujqësore dhe blegtorale, të cilat kanë ndikim në rang kombëtar e jo vetëm për territorin e kësaj bashkie.

Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në Bashkinë Krujë është 13,218.88 ha, ndër të cilat 519,7 ha është tokë arë e kultivuar. Toka shumë e përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore e ka bërë Krujën shumë të rëndësishme në nivel kombëtar për prodhimet bujqësore.

Per të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur te dhënat e INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Siç mund të kuptojmë nga fluksi, hyrjet (prodhimet) janë më të larta sa daljet (treg dhe eksport) sepse një pjesë e këtyre produkteve shkojnë për konsum vetjak, një sasi e caktuar është humbje dhe një pjesë tjetër shkon për shitje në mënyrë informale. Në disa raste vëmë re që sasia e produkteve që shkon në treg dhe eksport është shumë herë më e lartë se sasia që prodhohet, sepse burimi i të dhënave është i ndryshëm, prodhimet janë përcaktuara nga QTTB, ndërsa të dhënat për treg dhe eksport janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.



Fig. 50 Potenciali energjetik

Fig. 51 Fluksi i ujit

Komuna	Ferma gjithësej	Nga këto: Ferma Bujqësore		Ferma Blegtorale		Të tjera	
	Nr.	Nr.	ha	Nr.	Krerë	Nr.	Koshere/pula
Kruje	174	122	835.8	50	4415	2	120
Fushe-Kruje	2458	2432	2415.09	20	2562	6	700380
Thumane	3381	3352	4904.48	24	1230	5	3400
Nikel	1787	1774	2151.46	6	490	7	490
Bubq	1589	1555	2394.06	33	2327	1	201
Cudhi	692	616	517.99	75	7251	1	112
Rrethi Krujë	10081	9851	13218.88	208	18275	22	704703

Tabela 12: Fermat në Bashkinë Krujë (QTTB dhe MBZHRAU, 2014)

Përbërës niveli I		Përbërës niveli II	Prodhimi
		Drithëra (Ton)	14,173
		Perime (Ton)	17,482
		Patate (Ton)	2,016
		Fasule (Ton)	899
		Bime industriale (Ton)	1
	Prodhimet e arave	Farogjere (Ton)	160,579
		Peme frutore (Ton)	1,849
		Ullinj (Ton)	2,842
		Agrume (Ton)	108
Prodhime bimore	Drufrutor	Rrush gjithsej (Ton)	2425
		Qumësht (Ton)	25861
		Mish (Ton)	2351
		Lesh (Ton)	21
		Veze (000/kokrra)	14313
Prodhimi Blegtoral	Prodhim Blegtoral	Mjaltë (Ton)	57

Tabela 13: Prodhimi bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Krujë (INSTAT, 2012)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TIRANES SEKRETARIA

2.1.3.7 Fluksi i mbetjeve

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia Krujë). Në territorin e Krujës shërbimi ofrohet në nivel 80 – 100 %. Venddepozitimi i mbetjeve në Krujë nuk është inxhinierik-sanitar dhe ndodhet pranë zonave të banuara, përgjatë rrugës për Krastë. Diferencimi i mbetjeve në burim nuk kryhet dhe rezulton në mungesë të riciklimit apo përpunimit të mbetjeve. Treguesi i mungesës së diferencimit të mbetjeve është edhe niveli i lartë i mbetjeve që importohen për t'u ricikluar nga kompanitë e riciklimit të vendosura në Shqipëri. Në vitin 2013 në Shqipëri janë importuar 207,690 ton mbetje dhe janë eksportuar vetëm 30,704 ton mbetje nga të cilat 35,055 ton janë mbetje të riciklueshme.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit (për lejet mjedisore), në territorin e bashkisë Krujë operon vetëm një kompani riciklimi që riciklon vajra dhe nënprodukte te tij.

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve bashkiake në territorin e Bashkisë Krujë, jemi mbështetur në metodologjinë e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg (qytete) dhe 0.4 kg (fshatra). Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara siç është qyteti i Krujës dhe Fushë Krujës. Sasia e gjeneruar në këto dy qytete, në zonën urbane, arrin vlera 1300-3100 ton/ për km² në vit.

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e bashkisë Krujë është përafërsisht 78.6 %, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 47 %, 15 % plastika dhe 12 % letra. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi.

2.1.3.8 Përfundime

Analiza e metabolizmit tregon se si funksionon territori i bashkisë në lidhje me disa nga flukset kryesore te burimeve të tij, nga prodhimi deri në konsumim.

Në territorin e Bashkisë Krujë energjia diellore është një potencial i pashfrytëzuar. Energjia diellore mund të përdoret kryesisht në mënyrë individuale nëpërmjet kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit dhe paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike por edhe nëpërmjet fermave diellore (centrale fotovoltaike). Në këtë mënyrë ulet sasia e energjisë që shpenzohet aktualisht për ngrohje dhe konsum, që përftohet kryesisht nga energjia elektrike dhe drutë e zjarrit duke ulur ndjeshëm impaktin ndaj mjedisit.

Shpejtësia mesatare e erës luhatet nga 2.5-3 m/s, çka tregon për potencialin e prodhimit të energjisë duke përdorur erën si burim. Nëse të gjitha potencialet që ka Bashkia Krujë për prodhimin e energjisë përdoren, siç janë energjitë e rinovueshme, sasia e energjisë do të mbulojë një pjesë të mirë të nevojave që ka ky territor për furnizim me energji. Gjithashtu, përdorimi i burimeve alternative mbron mjedisin dhe përdor burimet në mënyrë efikase. Shërbimi i furnizimit me ujë duhet të shtrihet në të gjithë territorin nën administrimin e Bashkisë Krujë. Ky shërbim ofrohet më tepër në zonën urbane të bashkisë dhe sistemi i shpërndarjes është konvencional (rrjet tubacionesh), por mund të përdoren edhe puset për në zona të caktuara, në këtë mënyrë sigurohet edhe një mbulim më i mirë i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm. Sasia e ujit që prodhohet për pirje aktualisht është 108,000 m³/orë ndërkohë që kërkesa aktuale për ujë është 85,000 m³/orë, pra prodhohet 1.27 herë më tepër se kërkesa aktuale.

Duke pasur parasysh këtë potencial që ka Bashkia Krujë për fluksin e ujit, duhet që shërbimi i furnizimit me ujë të ofrohet në të gjithë territorin.



Fig. 52 Konsumi i ujit



Fig. 53 Fluksi i ushqimit



Fig. 54 Fluksi i mbetjeve

Nga fluksi i ushqimit mund të kuptojmë që Kruja është e specializuar në prodhimin e foragjerëve, perimeve, drithërave, rrush, vreshtarisë, ullishtave dhe pemë frutore. Territori i Krujës ka sipërfaqe të konsiderueshme natyrore të cilat janë potencial për mbjelljen e drufrutorëve, duke rritur kështu prodhimin e këtyre kulturave bujqësore. Duke iu referuar edhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme për Krujën janë: ullinjtë, vreshtat dhe pemët frutore (më tepër qershi dhe pjeshkë). Kulturat blegtorale me prodhimin më të lartë janë qumështi, mjalti dhe vezët.

Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim ose në qendrën e përzgjedhjes eventualisht e integruar brenda ven depozitimit; në këtë mënyrë do të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Për këtë pushteti vendor duhet të përdorë stimuj që nxisin procesin e diferencimit të mbetjeve që në burim. Vend depozitimi që ndodhet rrugës për Krastë duhet transferuar diku tjetër pasi kjo zonë është e papërshtatshme dhe e pakontrolluar nga ana inxhinierike. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve duhet të ofrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Krujë dhe jo vetëm në disa qendra urbane.

2.1.4 Analiza e vlerësimeve demografike

Ky studim ka për qëllim ndërtimin e disa supozime rreth proceseve demografike dhe drejtimit që ka marre në vitet e fundit zhvillimi urban në Bashkinë Krujë, të cilat mund të merren si referencë në strategjinë e zhvillimit dhe planifikimit rajonal.

Ky studim, limitohet nga mungesa e të dhënave të hollësishme, duke u mbështetur tek të dhënat bazë të grumbulluara dhe të paraqitura në raportin e fazës së parë, të cilat janë të përmbledhura këtu, të ripunuara dhe të komentuara në këndvështrimin e supozimeve dhe hipotezave interpretuese duke iu referuar proceseve më të përgjithshme që prekin vendin.

2.1.4.1 Të dhëna mbi popullsinë

Sipas të dhënave të Censusit 2011, popullsia e bashkisë Krujë (duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj) ka një numër prej 59 814 banorë, ndërsa sipas regjistrit të gjendjes civile 79 608 banorë. Mbi bazën e këtyre të dhënave llogaritet dendësia 176.43 banorë/km² sipas Censusit, ndërsa sipas Regjistrit të gjendjes civile dendësia është 234.81 banorë/km².

Arsyeja e paraqitjes së të dhënave të ndryshme nga INSTAT-i dhe Regjistri i gjendjes civile janë lëvizjet brenda vendit pas vitit '89, të cilat nuk shoqëroheshin gjithmonë me procedurat e regjistrimit në Regjistrin e gjendjes civile të zonës ku vendoseshin. Gjithashtu, edhe dukuria e emigracionit ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë.

Nga të dhënat e mëposhtme, vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të banorëve në njësinë administrative Cudhi dhe në Krujë, ndërsa njësitë administrative Fushë Krujë dhe Nikël kanë rritje të numrit të banorëve. Kjo rritje ka ritme shumë të shpejta në 10-vjeçarin e parë të periudhës së marr në studim (vitet 1989-2001). Pas vitit 2001, edhe pse me ritme të ulëta, janë të vetme njësi administrative me rritje të popullsisë së Bashkisë Krujë. Ndërkohë nga të dhënat e Regjistrit të gjendjes civile, ecuria e popullsisë të bashkisë së Krujës për dy vitet e fundit, është sipas tabelës së mëposhtme. Vihet re që lëvizjet vjetore të popullatës në njësitë administrative luhaten nga +/- 0.2 – 3.2 %.

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikël	Thumanë
Popullsia 2011	5951	1812	18477	11721	9518	12335
Ndr. i popullsisë 1989/2001 (në %)	-8.28	-54.84	29.2	-14.74	46.88	4.9
Ndr. i popullsisë 2001/2011 (në %)	-3.6	-52.91	0.2	-10.36	6.6	-5.49

Tabela 14: Ndryshimi i popullsisë 1989-2011 (INSTAT)

Njësia Administrative	Bubq	Cudhi	Fushë Krujë	Krujë	Nikël	Thumanë
Popullsia 2014	8442	3134	26081	16365	10430	15998
Popullsia 2015	8525	3093	26380	16400	10099	16400
Diferenca 2015-2014	83	-41	299	35	-331	402

Tabela 15: Popullsia 2014-2015 (Bashkia Krujë)

Në tërësi, popullsia e bashkisë ka pësuar rritje të ndjeshme në periudhën 1989 – 2001 (rreth 12%) ndërsa në periudhën 2001 – 2011 ka pësuar rënie (rreth 6%). Këto shifra tregojnë një rritje prej rreth 5.3% të popullsisë në 22 vite me një mesatare vjetore rreth 0.24 %. Kjo tendencë në vitet e fundit ka rezultuar në rënie duke u shoqëruar edhe me zvogëlim të numrit të banorëve në rang bashkie në dhjetëvjeçarin 2001-2011. Migrimi i brendshëm ka ndodhur nga zonat periferike drejt qendrave urbane dhe zonave me akses kundrejt infrastrukturës. Frenimi i zhvendosjeve masive të popullsisë në rang vendi në fundin e viteve '90 solli edhe reduktimin e popullsisë së ardhur nga zonat e thella. Në përmbledhje mund të themi se Bashkia Krujë ka tendenca për të mos pësuar rritje të kosiderueshme të popullsisë, duke ruajtur kryesisht numrin aktual të popullsisë, ose duke u reduktuar në zona të caktuara (zonat e thella) dhe do të vazhdojë të ketë lëvizje të brendshme popullsie nga zonat e thella drejt qendrave ekonomike, atyre të shërbimeve dhe infrastrukturës.

Për sa i përket strukturës së popullsisë, përveç migrimit, ulja e lindshmërisë dhe vdekshmëria kanë ndikim të rëndësishëm. Sipas të dhënave të INSTAT-it, 21.4% e popullsisë është nën moshën 15 vjeç dhe 9.42% është mbi moshën 65 vjeç (INSTAT, Popullsia dhe dinamika e saj në Shqipëri). Këto të dhëna tregojnë që grupi i popullsisë aktive 15-64 vjeç zë përqindjen më të madhe. Koeficienti i varesisë (numri i personave nen 14 vjeç dhe mbi 65 vjeç, përkundrejt numrit të personave në moshë aktive 15-64 vjeç) shprehur në përqindje është 49.22, shifër kjo ndjeshmërisht më e ulët se niveli kombëtar. Kjo nënkupton një zvogëlim të barrës së personave të varur brenda njësive ekonomike familjare.

2.1.4.2 Lëvizjet natyrore dhe hapsinore

Nga të dhënat e INSTAT në 22 vite ('89-'11), del se popullsia e Bashkisë Krujë është në rritje, mesatarisht me rreth 0.24% në vit paçka se vitet e fundit vihet re rënie e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Shtesa natyrore e popullsisë deri në vitet 90' ka qënë e lartë falë politikave sociale dhe ritmeve të larta të lindshmerisë të shoqeruara nga ulja e vazhdueshme e treguesve të vdekshmërisë. Pas viteve '90 vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të lindjeve. Shkak kryesor është migracioni i theksuar për moshën 20-35 vjeçare, ndryshimi i mentalitetit dhe ndryshimi i nevojës për krahë pune në bujqësi.

Lëvizja hapësinore e popullsisë karakterizohet nga dy forma tradicionale të saj: migracioni i brendshëm dhe emigracioni jashtë kufinjve të vendit. Kjo levizje e popullsisë dhe të gjitha hapat e zhvillimit ekonomik të zonës me ulje-ngritjet e saj, janë reflektuar dhe në punësimin e familjeve me grup-moshë aktive.

Gjithashtu mbas viteve 90' ka ndikuar dhe lëvizja e lirë e njerëzve për t'u punësuar në rrethinat më të zhvilluara brenda vendit, sidomos në zonën Tiranë-Durrës. Kjo u shoqërua me rritje të ndjeshme të popullsisë me prurje nga zonat e thella të vendit që u zhvendosën në territore pranë zonës ekonomike Tiranë Durrës dhe aksit kombëtar Tiranë – Lezhë. Ky fenomen ka qënë dhe vazhdon të jetë aktiv. Ka lëvizje të njerëzve nga fshatrat e thella, drejt fshatrave të cilat janë me afër zonave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

me përparësi urbane dhe nga qytetet e vogla, drejt qyteteve më të mëdha, që ofrojnë më shumë mundësi punësimi dhe jete sociale.

Kruja, si gati gjithë Shqipëria, ka më shumë se 20 vjet që është përfshirë nga eksodi i orientuar drejt qyteteve, zonave fushore dhe jashtë kufirit të Shqipërisë. Kjo ka të bëjë sa me burimet e pakëta natyrore, apo me pamundësinë e shfrytëzimit të tyre si duhet, aq edhe me shkallën e ulët të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të disa territoreve. Banorët janë në kërkim të një jete më të mirë, veçanërisht për fëmijët e tyre, mundësive të rritjes së prodhimit bujqësor, mundësive më të mira për punësim e për shanse më të favorshme. Infrastruktura e sotme: rrugët, rrjeti elektrik dhe ai ujësjellës, shkolla, qendrat shëndetësore, qendrat kulturore dhe argëtuese, janë zhvilluar në mënyrë jo të njëtrajtshme në territorin e vendit, duke krijuar diferenca të ndjeshme dhe nevojën e natyrshme për migrim.

2.1.4.3 Projeksioni i popullsisë

Analizat dhe vlerësimet në vijim, bazohen në faktorët e mëposhtëm:

a. parashikimet e prirjes demografike sipas të dhënave të INSTAT;

b. vlerësimi i kërkesave të mëparshme për banim ;

c. shqyrtimi i ndërtimeve për banim, të realizuara vitet e fundit (2007-2015);

d. kapaciteti i ngarkesës së territorit, duke nënkuptuar disponueshmërinë e tokës, ujit, kapaciteti i sistemeve aktuale urbane për të menaxhuar prodhimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme nga vendbanimet aktuale të banimit dhe nga ato të parashikuara për të ardhmen;

e. strategjia e përgjithshme e planit, që synon të rrisi dendësimin dhe forcimin e vendbanimeve ekzistuese, sidomos përreth dhe në brendësi të sistemit urban rrëzë vargmaleve, dhe atyre përgjatë infrastrukturës, duke ruajtur zonat bregdetare, malore e bujqësore nga konsumi mëtejshëm i tokës.

Përmes këtyre faktorëve, **strategjia e ndërtimit është përkthyer në objektiva të veçantë, të cilët janë:**

a. përcaktimi i duhur i **hierarkisë urbane** për të gjitha grupet e sistemit urban (qendra të nivelit të parë dhe qendra të nivelit të dytë, qendra të specializuara, fshatra, etj.);

b. **ruajtja dhe rritja e popullsisë ekzistuese**, e shprehur si një përqindje duke marrë si referencë të dhënat e fundit të popullsisë të regjistruara nga INSTAT (2011);

c. **popullsia që duhet arritur në 2031 në çdo njësi administrative dytësore** (njësi që përkojnë me komunat e vjetra para reformës); në fazën e tretë të planit këto objektiva do artikulohen edhe për çdo nën-njësi, në përputhje me parimet e përgjithshme të strategjisë territoriale;

d. **njësitë e reja të banimit për rritjen e numrit të banorëve**, të parashikuara në lidhje me rritjen e pritshme të popullsisë;

e. **njësitë e banimit të planifikuara për zëvendësimin e banesave të amortizuara** (kjo vlerë është llogaritur paraprakisht si një vlerësim në përqindje i ndërtesave ekzistuese të ndërtuara para vitit 1991, të dhënat e INSTAT; hipoteza e supozuar është se 70% e kësaj trashëgimie ndërtimi ka nevojë të rehabilitohen apo rindërtohen);

f. **njësitë e banimit të planifikuara për zëvendësimin dhe zhvendosjen e ndërtesave ekzistuese nën rrezik dhe në zonat e mbrojtura apo ato buferike** (përqindje e vlerësuar e totalit të ndërtesave ekzistuese);

g. **njësitë e reja të banimit e parashikuara për rregullimin e ndërtimeve ekzistuese me standardet e ndërtimit** (25-30 m²/banor); përsëri si përqindje e totalit të vlerësuar të ndërtesave ekzistuese.

Përveç llogaritjes së parashikuar të popullsisë dhe të banesave të reja, është bërë edhe një parashikim se si ky vëllim ndërtimi mund të shpërndahet në dy një pjesë; 50% duhet të realizohen nëpërmjet rinovimit dhe rindërtimit të objekteve ekzistuese, pa konsumuar sipërfaqe toke të re, dhe 50% të tjera që do të ndërtohen në tokë të re, duke konsumuar sa më pak tokë bujqësore, aty ku zonat do mendohen të urbanizohen. Bazuar në këtë vlerësim, është bërë edhe një përllogaritje e përdorimit të mundshëm të tokës për urbanizimin e ri, duke përdorur standardin paraprak prej 500 metra katror për objekt banimi (100 m² për 4 njerëz).

Së fundi, për çdo njësi administrative është përcaktuar një përqindje udhëzuese e ndërhyrjes që do të zbatohet si një ndërhyrje publike (strehim social). Për të gjitha njësitë administrative të bashkisë është hamendësuar vlera prej 50% e ndërtimit që zhvillohet në tokë të re.

Pavarësisht të dhënave kontradiktore për popullsinë, duke u nisur nga analiza të treguesve, si dhe duke ju referuar edhe projeksionit të INSTAT për qarkun Durrës (+0.25% / vit), mund të themi se rritja e popullsisë prej 0.23% në vit mendohet reale, e qëndrueshme dhe pjesë e një modeli të besueshëm, si rrjedhim, popullisa e Bashkisë Krujë, në vitet 2030 do të jetë rreth 62,500 banorë (referuar të dhënave të INSTAT).

Strategjia e propozuar e bashkisë Krujë përdor dispozitat e përgjithshme, si më poshtë:

1. **Projeksioni i popullsisë në vitin 2031 parashikohet një shifër prej rreth 62.547 banorë, krahasuar me shifrën e 59.814 banorëve, INSTAT 2011; me një rritje të përgjithshme, për periudhën e planit, prej 5.00%. Ky objektiv është ndërtuar duke supozuar një rritje në kohë të qendrës së Fushë-Krujës prej 8%; Kodër-Thumanës prej 4%, Niklës prej 6%, dhe popullsia e njësive të tjera administrative është përllogaritur pa rritje, në përputhje me vlerat e 2011-tës**. Ky projeksion demografik i shfuqizon të dhënat e parashikimit INSTAT, të cilat japin të gjitha njësitë e mesme administrative në rënie të madhe, me përjashtim të Fushë-Krujës dhe Niklës, e cila është e prekur nga afërsia me aeroportin dhe kryeqytetin. Vendimi për të parashikuar zhvillimin e qendrave të rrëzës së vargmaleve është një zgjedhje e Strategjisë së Planit të Përgjithshëm, që ka për qëllim të veprojë në ri balancimin e zonës së ndërtuar dhe asaj me vlerë të madhe bujqësore, për të arritur zhvillim në qytet dhe jo ndërtim të shpërhapur në territor.

2. Rritja mesatare prej 5% në periudhën e zbatimit të planit;

3. Parashikimi prej 6,330 i objekteve të banimit, 50% prej të cilave (3,165 objekte) për rindërtim e rinovim, pa përdorur tokë të re, pra pa prekur tokën bujqësore;

4. Përdorimi i tokës bujqësore për urbanizimin e ri, me përdorim rezidencial të parashikuar prej 158,27ha, e barabartë me 0.47% të të gjithë sipërfaqes së tokës së bashkisë (33.560,96 hektarë).

Vlerësimi i kërkesave për ndërtimet e reja për banim, dallohet edhe nga vrojtimi i rritjes së ndërtimeve për banim, që janë realizuar këto 8 vitet e fundit, e vlerësuar me llogaritje të drejtpërdrejtë nga sondazhet foto-satelitore të 2015 (krahasuar me dokumentimin zyrtar që është i 2007) dhe nga rilevimi i hollësishëm në terren. Ky parashikim vjen edhe si studim i krahasimit të ndërtimit në 15 vjet, dhe llogaritet me një vlerë prej 3.165 banesave të reja, me një mesatare prej 211 objekte në vit, ndërkohë që në periudhën 2008-2015 kjo shifër është 199 objekte. Këtij parashikimi duhet t'i shtohet edhe një parashikim analog, i veçantë, për objektet ekzistuese që do rinovohen.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

2.2 STRATEGJIA TERRITORIALE, VIZIONI STRATEGJIK DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT

2.2.1 Identifikimi i mundësive kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të bashkisë

2.2.1.1 Hyrje

Territori i bashkisë Krujë paraqitet homogjen në drejtimin vertikal, duke paraqitur një strukturë të resurseve territoriale ose pesë tipologjive të mjedisit të cilat, nga pikëpamja ekonomike, mund të ndahet në tri fasha gjatësore

• Fasha bregdetare, ku turizmi, peshkimi dhe kultivimi i peshkut, përfaqësojnë resurse të çmuara, të cilat janë në gjendje të krijojnë procese zhvillimi lokal, siç tregon rasti i zonës së Shëngjinit.

• Fasha e ndërmjetme, e përfshirë midis bregdetit dhe fashës urbane, që paraqitet si një ultësire e përbërë më së shumti nga toka bujqësore, të përdorura për mbjellje ose kullota, në varësi të pjellorisë. Kjo fashë përfshin korridorin infrastrukturor, autostradën që lidh Tiranën dhe Durrësin me veriun e vendit dhe me Kosovën.

• Fasha urbane rrëzë malit, e cila paraqitet e pajisur me një sërë resursesh mjedisi dhe arkeologjike, të shfrytëzueshme nga pikëpamja turistike, dhe aktivitete prodhimi të produkteve ushqimore, si vera dhe vaji, për të cilët kërkesa ndërkombëtare është në rritje.

Megjithatë, aktivitetet industriale janë modeste. Me përjashtim të aktiviteteve tekstile dhe të këpucëve me pak rëndësi, industritë me aktive janë të përqendruara në sektorin e ndërtimit dhe atë të nxjerrjes së mineraleve.

Sektori turistik, i cili, me zgjerimin e tij të shpejtë dhe të theksuar në nivel kombëtar, ka më shumë premisa për gjenerim përfitimi dhe për punësim, edhe në një horizont kohor të shkurtër. Nga ana tjetër, bujqësia dhe blegtoria, kanë një potencial të madh zhvillimi socio-ekonomik për zonën, por problemet strukturore të këtij sektori bëjnë të kuptohet se, kohëzgjatja derisa efektet e ndërhyrjeve të ndihen, do të jetë më e madhe.

Kjo kornizë tregon qartë se vizioni i sistemit të ndërhyrjeve që synojnë zhvillimin e territorit, duhet të ketë si qëllim nxjerrjen në pah të vlerave ekonomike të tri fashave të lartpërmendura, si në drejtimin horizontal ashtu edhe në atë vertikal

Në drejtimin horizontal, duke krijuar marrëdhënie dhe bashkëpunime midis resurseve turistike të fashës bregdetare dhe fashës urbane të rrëzës së malit. Induktimi i sektorit turistik, nga ana e tij, nxit zinxhirin e shkurtër të prodhimit lokal të ushqimeve, të ardhura nga bujqësia dhe blegtoria e fashës së ndërmjetme të territorit.

Në drejtimin vertikal, përgjatë tri fashave që përshkojnë territorin, më qëllim që të shfrytëzohen ekonomitë e shkallës dhe spill-over që do të lindin nga shfrytëzimi i resurseve turistike përgjatë fashës bregdetare dhe fashës urbane. Në mënyrë analoge, krijimi i strukturave logjistike për depozitimin, ngrirjen (frigoriferike) dhe shpërndarjen

e produkteve bujqësore dhe blegtorale – të nevojshme për modernizimin e sektorit bujqësor kombëtar dhe lokal – do të krijoje ekonomi shkalle dhe bashkëveprime mes ndërmarrjeve bujqësor dhe blegtorale që operojnë në fashën e ndërmjetme të territorit.

Në bazë të këtij vizioni të sistemit, që synon zhvillimin e integruar dhe të bashkërenduar të resurseve ekonomike territoriale, bashkësia e ndërhyrjeve për zhvillimin e bashkisë përfshin si sektorin turistik, ashtu edhe atë bujqësor dhe logjistikën e territorit. Ndër këto ndërhyrje, ka disa që i konsiderojmë specifikë dhe me prioritet për secilën bashki, pa zvogëluar rëndësinë e projekteve të tjera të zhvillimit të cilët janë plotësuesit natyralë të tyre. Për bashkinë Krujë, është e nevojshme që të vlerësohet pozicioni i saj gjeografik për zhvillimin e një poli logjistik multimodal.

Është me vend të nënvizohet që suksesi i projekteve të propozuara për secilën bashki varet në mënyrë thelbësore nga efikasiteti i projekteve bazë të treguar në këtë studim. Në veçanti, është e rëndësishme që të ndërhyhet në drejtim të:

• përmirësimit të rrjeteve teknike, pra rrjetet rrugore, ujësjellës dhe kanalizime;

• zvogëlimit të niveleve të ndotjes së lumenjve dhe brigjeve si dhe mbrojtja e ujërave nëntokësor;
• organizimit të një sistemi të përshtatshëm të asgjësimit të mbetjeve urbane;

• rikthimit të funksionalitetit të rrjetit të kanalizimeve si sistem ujitjeje dhe drenazhimi si dhe përmirësimi i mbrojtjes ndaj fenomenit të përmbytjeve.

2.2.1.2 Burimet turistike dhe roli logjistik potencial të Bashkisë Krujë

Qyteti i Krujës gëzon një pozicion strategjik nga pikëpamja logjistike dhe turistike. Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), kjo bashki është pjesë e zonës ekonomike industriale Tiranë-Durrës. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nisur një projekt për zhvillimin e integruar të rajonit Tiranë-Durrës (plani Durana, nga bashkimi i emrave të dy qyteteve), i cili përfshin projekte të rëndësishme për infrastrukturën e rajonit.

Në fakt, zona Tiranë-Durrës luan një rol të madh në logjistikën e vendit. Ajo shtrihet në kryqëzimin e seksionit shqiptar të Korridorit VIII (që lidh Bullgarinë dhe Greqinë me Shqipërinë dhe Italinë, nëpërmjet lidhjeve midis porteve italiane të Barit e Brindisit me portin e Durrësit) dhe aksit rrugor Veri-Jug. Porti i Durrësit, nëpërmjet të cilit kalojnë 1,601,321 ton mallra në vit, duke transportuar rreth 66,000 kontejnerë dhe 1,162,321 pasagjerë (të dhëna të 2010), është struktura portuale më e madhe në vend. Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës "Nënë Tereza", që ndodhet në veri-perëndim të kryeqytetit përgjatë aksit të autostradës veri-jug, ka transportuar pothuajse dy milionë pasagjerë gjatë vitit 2015. Lëvizjes së mallrave për shkak të importeve dhe eksporteve të vendit, që realizohet kryesisht përmes portit të Durrësit, i shtohet edhe ai i krijuar nga aktivitetet industriale kombëtare, të cilat janë të përqendruara kryesisht në zonën ekonomike Tiranë-Durrës. Një pjesë e kësaj lëvizje mallrash dhe një pjesë e trafikut turistik, kalon në rrugën kryesore Tiranë-Shkodër, E762, përgjatë së cilës shtrihet qyteti i Fushë-Krujës, pranë kryqëzimit me rrugën SH38.

Kjo vendndodhje strategjike e Fushë-Krujës meriton të shfrytëzohet me anë të realizimit të një qendre logjistike. Është e nevojshme që ky pol logjistik të jetë multimodal, në mënyrë që të menaxhojë si transportin automobilistik ashtu dhe atë hekurudhor. Për këtë qëllim është i rëndësishëm rehabilitimi i hekurudhës së vjetër, e cila kalon paralel me aksin rrugor veri-jug. Kjo propozohet për të ndërhyrë në afat të shkurtër në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL TIRANË SEKRETARIA

• krijimi i një qendre logjistike uni-modale, e dedikuar për transportin e mallrave në rrugë automobilistike, përmes krijimit të një grupimi strukturash (cluster) të dedikuara për lëvizjen, ruajtjen në magazina dhe ftohjen (ne magazina frigoriferike) të mallrave, e për të menaxhuar trafikun e mallrave që transportohen me kontejnerë.

• riaktivizimi i hekurudhës së vjetër dhe dy stacioneve hekurudhore në Bubq.

Këto ndërhyrje fillestare në infrastrukturë dhe logjistikë duhet të pasohen pastaj nga veprimet afatmesme dhe afatgjata.

Linjat e tjera të veprimit të propozuara për bashkinë e Krujës janë shfrytëzimi i resurseve turistike dhe nxitja e inovacionit.

Qyteti i Krujës - me Kalanë, Pazarin e Vjetër dhe Muzeun Etnografik; Parku malor i Qafështamës dhe Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis), në rrëzën e vargmaleve; si dhe Ilixhat në Bilaj, në fushat e Bubqit, janë burime që me siguri mund të thithin një pjesë të fluksit ne rritje të turistëve të huaj, që vizitojnë vendin. Për momentin hoteleria e kësaj zone, duket se kufizohet në vetëm dy hotele në qytetin e Krujës, Hotel Panorama dhe Hotel Grand, një në zonën fushore, Nord Park, që ndodhet në gjysmë të rrugës mes Ilixhave në Bilaj dhe Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza". Gjithashtu mund të përmendim edhe shërbimet e hotelerisë në Zonën e Zhvillimit të Aeroportit.
Projektet e zhvillimit lokal për të shfrytëzuar potencialin turistik të zonës janë:

• përmirësimi i trashëgimisë historike e kulturore të qytetit të Krujës, Kalasë dhe Pazarit të Vjetër, përmes aktiviteteve promovuese;

• përforcimin e kapaciteteve të hotelerisë së zonës, në qytetin e Krujës, në afërsi të aeroportit dhe të Ilixhave në Bilaj;

• promovimi i turizmit natyror dhe i ecjeve në zonën malore të Qafështamës;

• realizim i një projekti që synon shfrytëzimin turistik të Kalasë së Zgërdheshit (Albanopolis);

• promovimi i ujërave termale në fshatin Bilaj, ku është aktualisht një qendër e rëndësishme kurative termale (Ilixha), "Ibrahim Kupi", e cila duhet integruar në promovimin turistik të qytetit të Krujës.

Këtyre projekteve, në fund, i bashkëngjitet propozimi për të krijuar një shkollë të trajnimit të menaxhimit dhe një inkubator për inovativ start-up, në mënyrë që të përfitojnë nga afërsia ndaj polit te aeroportit dhe pranisë së universiteteve private në territorin përreth.

2.2.2 Vizioni hapësinor lokal për territorin e bashkisë Krujë

2.2.2.1 Metodologjia e përdorur

Kuptimi i këtij paragrafi, që sqaron ndërtimin e strategjisë së zhvillimit lokal dhe planifikimit rajonal të Bashkisë së Krujës, është për të shoqëruar vlerësimet dhe parashikimet e zhvillimit socio-ekonomik, një vizion referimi që merr parasysh aspektet hapësinore dhe gjeografike të zonës në studim.
Kjo analizë paraprin përcaktimin e "strategjisë së zhvillimit vendor", e cila përkthen objektivat dhe qëllimet e përgjithshme, në projekte të natyrave të ndryshme (projekte bazë/parësore, strategjike, pilote), por jo para se të ketë përcaktuar "strategjitë bazë", të përcaktuara si "parakushte" për zhvillim. Shqyrtimi i aspekteve gjeografike dhe hapësinore të territorit dhe roli i luajtur prej tyre në aspektin e "vizionit hapësinor lokal" bëhet veçanërisht i rëndësishëm edhe për shkak të shkallës së gjerë të territorit në fjalë, si dhe për shkak të konsistencës së krijuar nga Bashkia

e re e Krujës, (si rigrupim i komunave të ndryshme, të mëparshme, administrative, të cilat, deri në reformën e fundit administrative, kishin autonomi specifike), si dhe nevojën për të rishikuar, në termat e referencës "vizionin hapësinor", me statusin e ri urban, sipas një rindërtimi të hierarkisë së qendrave urbane si qendra kryesore, dytësore, fshatra dhe grumbullime të reja urbane.

Një aspekt tjetër për t'u marrë parasysh në këtë "vizion hapësinor të referimit", ende në terma metodologjikë dhe klasifikues, lind nga mundësia për ta riparë atë si një perspektivë reference, vizion, një ripërcaktim i rolit dhe rëndësisë së strukturave ekzistuese të lëvizjes, ose atyre të projektuara për tu bërë të reja.

E njëjta konsideratë mund të kryhet edhe në lidhje me organizimin dhe statusin e zonave të mbrojtura natyrore dhe zonave të mbrojtura të trashëgimisë historiko-kulturore si dhe monumenteve të natyrës, që operojnë në sistemin e trashëgimisë kulturore dhe mjedisore (përmbledhja dhe identifikim i nxjerrë ne hartën e trashëgimisë historiko-kulturore-natyrore, e cila ndihmon në analizën e thelluar të territorit).

2.2.2.2 Ripërcaktimi i organizimit dhe hierarkisë urbane

Aktualisht, Bashkia e Krujës përfshin, në territorin e saj, 6 njësi administrative, të cilat përmbajnë qytetet dhe fshatrat, si më poshtë:
Bashkia paraqet, një situatë veçanërisht të artikuluar, të përbërë nga 2 qytete (Kruja dhe Fushë-Kruja), si dhe nga 50 fshatra, me një total prej 52 zona urbane.

Harta e zonave urbane të njohura në bazë të Vendimit nr.5 të KKT, për zonat e urbanizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë (Ministria e Zhvillimit Urban), paraqet një numër edhe më të madh të zonave urbane. Në kuadrin e evidentimit të zonave urbane, ndërtimet informale vlerësohen si një realitet i pranishëm në territorin e bashkisë, i cili nuk mund të neglizhohet.

Bashkia	Njësitë administrative	Nr. i zonave urbane	Qytetet dhe fshatrat
Bashkia Krujë	Krujë	(1) Qytet (3) Fshatra	Qytet: Krujë Fshatra: Barkanesh, Picërragë, Brret
	Fushë-Krujë	(1) Qytet (11) Fshatra	Qytet: Fushë-Krujë Fshatra: Fushë-Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luz 2, Larushk 2, Arrameras 2
	Bubq	(7) Fshatra	Fshatra: Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë e Madhe, Mazhë e Vogël, Mallkuç, Murqinë
	Nikël	(9) Fshatra	Fshatra: Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurçaj, Zezë
	Thumanë	(10) Fshatra	Fshatra: Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër
	Cudhi	(10) Fshatra	Fshatra: Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi-Kant, Kroi Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë
Gjithsej	6 njësi administrative	52 zona urbane	

Tabela 16: Përbërja strukturore e territorit të bashkisë Krujë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL TIRANË SEKRETARIA

Gjatë analizës së thelluar të gjendjes ekzistuese, është bërë evidentimi i zonave dhe ndërtimeve informale si nëpërmjet dokumentacionit, ashtu edhe nëpërmjet mbledhjes së të dhënave në terren. Ky informacion është pjesë e të dhënave që disponohen dhe konsiderohen situatë faktike mbi të cilën do të zhvillohen propozimet strategjike.

Në këtë dokument, zonat dhe ndërtimet informale, të legalizuara, në proces legalizimi apo të përjashtuara, konsiderohen pjesë e sistemit urban dhe vlerësohen sipas karakteristikave të tyre morfologjike, territorit dhe peizazhit në të cilin zhvillohen, infrastrukturës urbane dhe sociale me të cilën janë pajisur etj. Në këtë optikë, trajtimi i ndërtimeve informale do të jetë integruar me pjesën tjetër të sistemit urban dhe qasja strategjike do të orientohet kryesisht drejt karakteristikave të sistemit.

Mbështetur në sa më sipër, lind i nevojshëm riklasifikimi i të gjitha zonave urbane, duke pasur parasysh morfologjitë e ndryshme urbane të identifikueshme. Ky klasifikim do realizohet mbi vlerësimin e gjendjes urbane, disponueshmërisë së shërbimeve dhe objekteve urbane, si dhe rolit e funksionit në vizion e ri urban, duke ndjekur rendin dhe përkufizimin e mëposhtëm.

Rangu urban	Përcaktimi	Njësia urbane	Morfologjia urbane	Peizazhi i referencës
Qendër kryesore	Përmban bërthamën e bashkisë, shërbimet e nivelit më të lartë (shkolla të mesme, spitale, administrata)	Fushë-Krujë	Zonë urbane e konsoliduar dhe ekspansioni	Fushat bujqësore
Qendër dytësore	Përmban njësitë administrative dytësore (kanë të detyrueshme shkollat)	Krujë	Qendër historike	Zona malore
Qendër tretësore	Përmban struktura bazë	Të gjitha fshatrat e papërcaktuara në kategoritë e tjera		
Qendër lokale e specializuar	Përmban struktura të specializuara	Bubq (hekurudha, llixhat) Zgërdhesh Nikël Fshatrat pranë aeroportit	Struktura të pajisura me shërbime dhe infrastrukturë	Fusha bujqësore / peizazh natyror
Qendra rurale e malore që shërbejnë si pika shërbimi për fshatrat përreth	Hapësira publike, hapësira shërbimi, qendra asistence speciale	Cudhi		Zona malore
Fshatra ekologjike rurale	Vendbanime të reja me përdorim rezidencial-turistik, me gjurmë ekologjike të ulët, por me gjenerim të lartë të punësimit dhe të ardhurave	Fshatrat pranë shtratit të lumit Ishëm		Peizazh natyror
Fshatra ekologjike malore	Vendbanime të reja me përdorim rezidencial-turistik, me gjurmë ekologjike të ulët, por me gjenerim të lartë të punësimit dhe të ardhurave	Për tu lokalizuar		Zona malore

Tabela 17: Klasifikimi i njësive urbane në nivel bashkie

Klasifikimi i njësive urbane sipas rendësisë funksionale dhe strategjike, morfologjisë urbane kryesuese, peizazhit referencë:

2.2.2.3 Hierarkia e infrastrukturës dhe strukturave të reja të lëvizjes

Vizioni i ri hapësinor njeh korridorin kombëtar të infrastrukturës, si rrugë rajonale, së bashku me rehabilitimin dhe zhvillimin e linjës hekurudhore. Gjithashtu, stacionet ekzistues hekurudhorë trajtohen si projekte rehabilitimi, për t'i transformuar ato në pole të reja qendërzimi urban, për të rindërtuar përreth tyre sistemin e hapësirave publike dhe ndërlidhjen intermodale të sistemit të transportit publik e privat, duke përfshirë edhe lidhjen me korridoret e gjelbërt lokale (rrugët çiklistike urbane dhe territoriale).

Vizioni i ri hapësinor, gjithashtu, njeh si korridore portokalli dhe korridore të gjelbër, sipas këtyre përkufizimeve, elementet e tërthorta te meposhtëm:

- Korridoret portokalli, dmth. linjat territoriale te riorganizimit dhe dendësimit të funksioneve te banimit dhe urbane

- Korridoret e gjelbër, struktura te rigjenerimit te marrëdhënieve mjedisore ndërmjet ekosistemeve vendore, te shoqëruara me strukturat e qëndrueshme te lëvizjes/mobilitetit (pista çiklistike dhe këmbësore)

- Grupimet e vendbanimeve malore dhe rurale, te projektuara si një bashkëveprim funksional dhe i lëvizshmërisë, ndërmjet fshatrave rurale dhe malore,

Korridor	Tipologji	Evidentimi i gjurmës	Gjatësi	Shënime
Ca.1	Korridor portokalli	Krujë - Fushë Krujë - Qendër intermodale Bubq	13,8 km	Disnivel maksimal 425 m
Ca.2	Korridor portokalli	Fushe Krujë – Borizanë - Kodër Thumanë - Dukagjin i ri	14,4 km	
Cv.1	Korridor i gjelbër	Krujë – Rinas – Budull – Bubq - Mallkuç – grykëderdhje Ishmi	33,4 km	
Cv.2	Korridor i gjelbër	Halil – Fushë Krujë – Lumi Ishëm – Gramëz - Bregdet	14,8 km	
Cv.3	Korridor i gjelbër	Krujë - Kodër Thumanë – Bregdet	19,2 km	
Cm.1	Grupimet e vendbanimeve malore	Mafsheq – Nojë – Cudhi - Cudhi Kamt - Shkretë		
Cm.2	Grupimet e vendbanimeve malore	Barkanec – Kurçaj – Buran - Mukje		

Tabela 18: Korridoret dhe grupimet e vendbanimeve malore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIAT

riorganizuar rreth një qendre kryesore, me funksione të veçanta të shërbimi për këtë grupim zonash

Vizioni lokal përcakton në territorin e Bashkisë Krujë, 2 korridore portokalli, 3 korridore të gjelbër dhe 2 grupime vendbanimesh malore, sipas përkufizimeve dhe karakteristikave të mësipërme.

2.2.2.4 Riorganizimi, modifikimi dhe zgjerimi i zonave të mbrojtura

Vizioni i ri hapësinor konsideron me interes vlerën e kodrave të qytetit të Krujës, e cila mund të konsiderohet si një zonë e mundshme ku mund të shtrihet zgjerimi i mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë edhe projekte të ripyllëzimit dhe kompensimit të dëmit mjedisor peizazhistik të shkaktuar nga zhvillimi i pakontrolluar i aktivitetit të nxjerrjes së mineraleve dhe guroreve (guroret e çimentos dhe gëlqeres). Vizioni gjithashtu, parashikon dhe programin e ndërtimit të një rrjeti të korridoreve mjedisore, të ndërtuar rreth rrjedhave kryesore të lumenjve, që synon forcimin e marrëdhënieve ekologjike midis zonave malore të mbrojtura (Parku Kombëtar i Malit të Dajtit, Parku i Qafështamës) dhe zonave bregdetare (Kepi i Rodonit, Laguna e Patokut). Në tërësi, në përputhje me direktivat e PPK dhe planeve ndërsektoriale, kufijtë e zonave të mbrojtura ruhen ose zgjerohen. Gjithashtu, për bashkinë Krujë propozohen edhe zona të reja të mbrojtura me qëllim ruajtjen e peizazhit dhe mjedisit dhe krijimin e një sistemi të gjelbër në mbështetje të sistemit urban dhe aktivitetit turistik.

Më konkretisht, zonat e mbrojtura natyrore në këtë strategji paraqiten si më poshtë:

- Parku kombëtar i Qafë Shtamës – Parashikohet zgjerimi i kufijve aktualë të parkut

- Parku kombëtar i Dajtit – Parashikohet ruajtja e kufijve aktualë në territorin e bashkisë Krujë

- Zona e mbrojtur 'Patok – Fushë Kuqe – Ishëm' – Parashikohet ruajtja e kufijve aktualë të zonës në territorin e bashkisë Krujë

- Parku rajonal i Krastës – Parashikohet mbrojtja e kurorës së kodrave të Krastës

- Parku rajonal i Kodrave të Ishmit – Parashikohet mbrojtja e kurorës së kodrave të Ishmit, duke përfshirë hapësirën Prezë – Bubq – Ishëm – Kep i Rodonit

- Peizazhi i Malit të Skënderbeut – parashikohet mbrojtja e peizazhit të malit si sfond i peizazhit urban dhe historik të qytetit të Krujës

- Korridoret e gjelbra – Parashikohet mbrojtja e territoreve ku do të kalojnë korridoret e gjelbra dhe zhvillimi i tyre në përputhje me përcaktimet e PPV

2.2.2.5 Impakti i fashës së bregdetit

Në përputhje me parashikimet e PPK dhe PINSB, si dhe sipas parashikimeve strategjike për zhvillim të integruar të territorit, bashkia Krujë preket tërthorazi nga korridori i peizazhistik dhe fasha detare 12 milje. Këto elemente të zhvillimit kanë një impakt të jo të drejtpërdrejtë në territor, bashkia Krujë integrohet me fashën bregdetare përmes korridoreve tërthore të propozuara në këtë strategji të cilat bëjnë të mundur lidhjen det-mal dhe aksesin më të mirë si në fashën bregdetare, ashtu edhe në zonat e trashëgimisë dhe turizmit kulturor.

Korridori peizazhistik

Ne planet kombëtare të miratuara së fundmi parashikohet një rruge me karakter peizazhistik e cila përben një udhëzim strategjik për zhvillimin dhe integrimin e zonave te ndryshme me interes turistik qe ndodhen përgjatë bregdetit.

Ne Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK) kjo rruge përshkruhet si një itinerar me impakt te ulët dhe si i tillë nuk parashikohet si një aks i ri infrastrukturor. Gjithashtu në PPK, janë evidentuar disa zona natyrore te mbrojtura si dhe disa zona rreziku hidrologjik.

Ndërsa në lidhje me këtë korridor PINS Bregdeti na orjenton:

1- Lidhjen e infrastrukturave segmentare të transportit automobilistik përgjatë bregdetit shqiptar, në një rrjet të vazhdueshëm me shërbime publike në fushën e turizmit, i cili integron lokalitetet që janë më në afërsi me plazhet e vijës bregdetare të Shqipërisë dhe lehtëson aksesin e dyanshëm nëpër asetet natyrore, kuturore, mjedisore, plazhe etj.

2- Lidhja e infrastrukturave lokale dhe vlerave natyrore, mes tyre, për të mundësuar aksesin që nga bregdeti në drejtim të brendësisë së territorit.

Në Planin e Integruar Ndërsektorial te Bregdetit e gjithë zona bregdetare nga Shëngjini deri tek Kepi i Rodonit konsiderohet si zone qe duhet mbrojtur dhe që përbën Parkun Natyror Rajonal. Sa më sipër, zhvillimi i mundshëm i Korridorit Peizazhistik Bregdetare është përcaktuar në zonën perëndimore te superstradës Tirane-Shkodër dhe njëkohësisht pa prekur zonat me vlera mjedisore.

Lidhja gjatësore e tipit peizazhistik (turistik) mund te garantohet, në përputhje me udhëzimet e planeve kombëtare, nëpërmjet zhvillimit te një itinerari qe lidh mes tyre korridoret e tërthortë. Ky itinerar mund te rikuperoje rrugët ekzistuese me karakter lokal qe lidhin qendrat e banuara përgjatë bregdetit dhe që ndodhen ne perëndim te superstradës, por jashte kufirit të zonave te mbrojtura bregdetare.

Si rrjedhim, propozim strategjik që rrjedh nga instrumentat kombëtar të planifikimit, përjashton një lidhje të re infrastrukturore pranë dhe përgjatë bregdetit. Propozimi gjithashtu, bazohet në vështirësitë teknike të realizimit të një infrastrukture të re duke konsideruar morfologjinë e terrenit dhe pengesat e karakterit ligjor pasi shumë nga segmentet bregdetare janë përcaktuar si zona të mbrojtura mjedisore.

Përdorimi i fashës detare 12 milje

Bazuar në përcaktimet e PINS për Bregdetin, zona detare 12 milje përbën hapësirën detare e Republikës së Shqipërisë, se bashku me faunën dhe floren, pasurite e ujit, duke përfshirë edhe vijën bregdetare, plazhet, portet, radat dhe territoret tokësore të tyre, lagunat, grykëderdhjet e lumenjve, liqenet e vijës së ujit, që komunikojnë me detin.

Brezi 12 milje detare është zonë me potenciale të larta turistike, ekonomike dhe mjedisore. Planifikimi dhe integrimi i këtij brezi me hapësirën tokësore shikohet si një ndërhyrje kyç që do të sillte një zhvillim të balancuar. Si rrjedhim kjo zonë duhet trajtuar si një vlerë e shtuar, e cila me aktivitete të ndryshme do të ndikojë drejtpërdrejt në diversifikimin e paketës turistike. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve turistike natyrore si lagunat, parqet kombëtare, shpendët e rrallë apo karakteristikat fiziko kimike të ujit të detit, rërës, ajrit ne zonat pyjore, mund të sjellin perspektiva pozitive për zhvillimin ekonomik të zonës.

Aktivitetet kryesore ekonomike dhe rekreative që ndodhin në të janë:

- transporti detar
- turizmi detar; aktivitete sportive ne lidhje me ujin
- zhvillimi i akua kulturës,
- industrisë së peshkimit, kultivimi i peshkut
- ekstraktimi dhe përpunimi i kripës
- kantierë ndërtimi mjetesh lundëruese, peshkimi, transporti turistik, barka turistike, barka me vela, etj
- përdorimi i shërbimeve kurative, qendra SPA, etj
- qendra kerkimore ne lidhje me florën dhe faunën detare,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TIRANË

• qendra edukative lidhur me traditën e lundrimit në detet Adriatik dhe Jon

2.2.2.6 Objektivat e zhvillimit socio-ekonomik

Vizioni lokal hapësinor propozon vendndodhjen e një "poli logjistik të integruar", i dedikuar për transportin e mallrave në rrugë automobilistike, nëpërmjet krijimit të një grupi strukturash qe kanë si synim lëvizjen, magazinimin dhe ngrirjen në magazina frigoriferike të mallrave, si dhe menaxhimit të trafikut të mallrave të transportuara me kontejnerë. ". Ky vend duhet të jetë në afërsi të qendrës kryesore, Fushë-Krujë, në një pozicion qendror, në mes të korridorit të infrastrukturës kombëtare dhe linjës hekurudhore kombëtare.

Në vijim kujtojmë vendet me interes të projekteve të zhvillimit lokal, për të rritur potencialin e turizmit të bashkisë:

• Qendra historike e Krujës, Kalaja dhe Pazari i vjetër

• Përforcimi i kapacitetit hotelier dhe të shërbimeve të avancuara terciare (White collar economy) në afërsi të aeroportit ndërkombëtar

• Promovimi i ujërave termale në fshatin Bilaj, ku ka një qendër të rëndësishme kurimi termal, "Ibrahim Kupi", për t'u integruar me promovimin turistik të qytetit të Krujës

• Promovimi i turizmit natyror dhe të ekskursionit në zonën malore të Qafështamës

• Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis)

2.2.3 Strategjia e zhvillimit lokal

Vizioni "hapësinor i shkallës së gjerë" dhe thellimi i tij i mëtejshëm në "vizionin hapësinor lokal" evidentojnë në territor temat e mëdha strategjike të sistemit urbanistik, të nevojshme për përcaktimin e kushteve të favorshme për arritjen e objektivave të zhvillimit. Një sistem urbanistik funksional dhe i qëndrueshëm, si në shkallë territoriale ashtu edhe urbane, është një nga kushtet e domosdoshme për favorizimin e realizimit të programit. Por projektimi i vizionit hapësinor lokal ka nevojë për strategji specifike për t'u realizuar. Këto strategji duhet, nga njëra anë të ndjekin përmbajtjen e propozimit strategjik të shkallës së gjerë dhe nga ana tjetër të përcaktojnë veçoritë funksionale për secilin territor bashkie, por pa krijuar ekskluzivitet funksionesh apo përdorimesh.

Për secilin territor të marrë në studim, "parakushti" strukturor për nisjen e zhvillimeve strategjike është tejkalimi i mungesave në sisteme dhe infrastruktura ekzistuese. Asnjë program nuk mund të zhvillohet në një territor i cili nuk garanton nivelet minimale të funksionalitetit të sistemeve të tij bazë. Nevoja e përmbushjes së hendeqeve të territorit lokal është një parakusht i pamënjanueshëm për nisjen e programeve të zhvillimit strategjik.

Në këtë kuptim, mund të konsiderohen si strategji të mirëfillta themelore:

• politikat që synojnë zgjidhjen e nyjeve strukturore të komunitetit lokal (përcaktimi i aseteve të pronësisë, rregullat për taksimin lokal, normat për qeverisjen e miratuar të transformimeve);

• programet që synojnë të garantojnë kushtet minimale të funksionimit teknik të vendbanimeve urbane (efiçenca e rrjeteve, efikasiteti i mënyrave të menaxhimit, aksesi i lirshëm ndaj resurseve);

• ndërhyrjet që kanë për synim garantimin e qëndrueshmërisë së zonave të banuara (vënia në siguri e territorit, mbrojtja e trupave ujore, mbrojtja e resurseve mjedisore);

• projektet që synojnë sigurimin e një sistemi urban të jetueshëm (organizimi i sistemit të transportit, krijimi i qendrave urbane, pajisja me shërbime).

Për secilin territor duhet përcaktuar misioni kryesor i programit afatmesëm strategjik të zhvillimit. Bëhet fjalë për përcaktimin e sektorit (ose sektorëve) në të cilët do të investohet në një periudhe afatshkurtër, për të shpresuar që në periudhën afatmesme të konstatohen efektet pozitive që do të kenë aftësinë nxitëse të cikleve të zhvillimit. Evidentimi i këtyre sektorëve kyçe nuk përjashton mundësinë, që të njëjtat aktivitete të mund të jenë të zbatueshme diku tjetër. Bëhet fjalë për evidentimin e prioriteteve dhe veçorive të secilit territor, të cilat ndihmojnë në orientimin e investimeve publike dhe private.

Së fundmi, strategjia lokale duhet të mbështetet në disa projekte të cilat duhet të jenë të realizueshme në një kohë të shkurtër, me qëllim që të tregojnë aftësinë vepruese të zgjedhjeve të bëra, nëpërmjet disa ndërhyrjeve të cilat do të shërbejnë edhe si shembuj për projektet e ardhshme (projekte pilot).

2.2.3.1 Strategjia Lokale

Hyrje

Në territorin e Bashkisë Krujë pesë sistemet e përcaktuara në "vizionin hapësinor të shkallës së gjerë" kanë një shtjellim të veçantë pasi ky territor është i influencuar në pikëpamjen funksionale nga afërsia me Tiranën dhe gjithashtu, nga pikëpamja morfologjike, ky territor është i ndryshëm nga të tjerët.

Në të vërtetë Kruja nuk ka një bregdet, nëse konsiderohen kufijtë administrativë të bashkisë, por dalja në det nga banorët e Krujës (dhe shpeshherë të Tiranës) bëhet në zonën e grykëderdhjes së lumit Ishëm (Gjiri i Rodonit) dhe në Gjirin e Lalzit.

Ultësira bujqësore shtrihet vetëm në zonën e Bubqit dhe Thumanës, por shfaq në të njëjtën mënyrë fenomenet e përmbytjeve dhe të mbivendosjes së funksioneve.

Tema infrastrukturore, në territorin e Bashkisë Krujë, shfaq problematika të veçanta. Problemi i vendosjes së aktiviteteve prodhuese përgjatë rrugës kombëtare (si p.sh. industria e mobiljeve në Nikël) është tashmë i tejkaluar nga aksi i ri i autostradës, që pritet të realizohet nga Thumana në Tiranë.

STRATEGJITË BAZË (kushtet fillestare për zhvillim)	
Politikat strukturore	Përcaktimi i aseteve të pronësisë
	Rregulla për taksimin lokal
	Norma për qeverisjen e miratuar të transformimeve
Funksionimi teknik	Efiçenca e rrjeteve
	Efikasiteti i mënyrave të menaxhimit
	Akses i lirshëm ndaj resurseve
Qëndrueshmëria e zonave të banuara	Vënia në siguri e territorit
	Mbrojtja e trupave ujorë
	Mbrojtje e resurseve mjedisore
Jetueshmëria e sistemit urban	Organizimi i transportit
	Krijimi i qendrave urbane
	Pajisja me shërbime

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Tabela 19: Strategjitë bazë

Sistemi urban rrëzë vargmaleve zhvillohet përgjatë rrugës së vjetër kombëtare (shumë e amortizuar) dhe përfshin qendrat urbane Nikël, Fushë-Krujë, Borizanë dhe Thumanë.

Zona malore karakterizohet nga prezenca e qytetit të Krujës dhe e kalasë së saj, së bashku me qendrën historike. Më në brendësi të territorit ekzistojnë resurse të tjera të rëndësishme, si: Sarisalltiku, i cili përveç interesit fetar, është gjithashtu një pikë vrojtimi panoramike, Parku Kombëtar i Qafështamës, fshatrat malore në Cudhi etj. Në përputhje me këtë vizion strategjik, në territorin e Krujës fokusi do të përqendrohet në zhvillimin e tri aseteve kryesore:

- ekzistenca e një potenciali të rëndësishëm, të lidhur me kushtet intermodale të transportit dhe logjistikës, në përputhje me drejtimet strategjike të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe projektet e planifikuara (INFRASTRUKTURE dhe LOGJISTIKE);

- resursi i rëndësishëm kulturor, i përfaqësuar nga Kruja dhe malet e saj, por edhe nga burime të tjera të rëndësishme ekzistuese, për realizimin e turizmit antropogjen historik (TURIZËM KULTUROR);

- prania e sylhave inovative që mund të çojnë në një periudhë afatmesme, në një program të zhvillimit të sektorit prodhues (INOVACION PRODHIMI).

Në mënyrë të veçantë, për territorin e Krujës (veçanërisht në Fushë-Krujë) specializimi është i lidhur padyshim me logjistikën (në përputhje dhe me udhëzimet e planifikimit kombëtar), që lidhet edhe me ekzistencën e modaliteteve më të rëndësishme të transportit (aeroport, autostradë, hekurudhor). Projekti strategjik prioritar për këtë bashki është ai i krijimit të një "poli logjistik të integruar".

Për të rritur nivelin e vëmendjes karshi cilësisë së jetës, do të ishte i dobishme dhe i nevojshëm monitorimi i nivelit të ndotjes së ajrit (nga pluhurat e imta), nëpërmjet realizimit të një stacioni eksperimental për kontrollin e cilësisë së ajrit.

Vepra të tjera me efekte të menjëhershme mund të jenë: (i) projektimi dhe zbatimi i një strukture që do të shërbejë si inkubator për ndërmarrjet e reja (start-up) si dhe një shkollë trajnimesh profesionale për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë; (ii) projekt shembull për rikuperimin e një guroreje të braktisur në zonën e Krastës me qëllim që të tregohet se është i mundur eliminimi i një elementi shqetësues për peizazhin dhe gjetja e një funksioni të ri; (iii) përmirësimi dhe zhvillimi i lidhjeve rrugore me bregdetin.

Lista e projekteve strategjike

- Përmirësimi i rrjeteve teknike.
- Mbrojtje e akuiferëve.
- Pastrimi i lumenjve.
- Mbrojtje ndaj përmbytjeve.
- Pastrimi i mbetjeve urbane.
- Përmirësimi i rrugës së vjetër kombëtare Fushë-Krujë – Borizanë – Thumanë.
- Përmirësimi i hekurudhës.
- Planifikim i detajuar vendor.
- Plani i emergjencave civile.
- Qendra kulturore në zonat urbane.
- Qyteti mik i fëmijëve.
- Transformim i stacionit hekurudhor në Budull.
- Rikuperim i një guroreje të braktisur në Krastë.
- Korridori i gjelbër Albanopolis – Lugina e Ishmit - Bregdet
- Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis).
- Inkubator ndërmarrjesh dhe shkolle profesionale.
- Rindërtim i Urës së Tubit.
- Rruga Prezë-Budull.
- Lidhja e Thumanë me Bubqin.

- Pol logjistik i integruar në Fushë-Krujë.
- Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës.
- Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës.
- Kalaja e Krujës dhe Pazari i Vjetër.
- Pikë me interes religjioz dhe panoramik në Sarisalltik.
- Ndërtimi i baxhove eksperimentale.
- Zonë tregu lokal
- Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe shëndetit.
- Aksi i ri Thumanë – Tiranë.
- Rruga Krujë-Tiranë.
- Sistemi i aeroportit "Nënë Tereza".
- Lidhja e Bubqit me bregdetin.
- Rruga lidhëse Krujë-Mamurras.
- Rruga Krujë-Burrel.
- Ujërat termale në Bilaj.
- Turizëm malor në Qafështamë.

Përmbajtja e projekteve strategjike paraqitet e zgjeruar në kapitullin 3.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

2.3 HARTËZIMI I STRATEGJISË TERRITORIALE

2.3.1 Strategjia territoriale për secilin nga pesë sistemet territoriale të Bashkisë Krujë (N, U, B, UB, IN)

Strategjia territoriale, është shtjelluar për secilin sistem territorial në listat e objektivave strategjike të sektorit, përcaktimi i të cilave bëhet edhe në bazë të rezultateve të analizës SWOT të secilit sistem.

Përmbledhja krahasuese e rezultateve të analizës SWOT, shoqëruar me listën e këtyre objektivave, sqaron këtë marrëdhënie dhe formon bazën për përcaktimin e projekteve që plotësojnë dhe japin rezultatin faktik të Planit Strategjik për Bashkinë Krujë. Në vijim paraqiten direktivat e zhvillimit për secilin nga pesë sistemet territoriale.

2.3.1.1 Sistemi Natyror (N)

N 1. Mbrojtja dhe zgjerimi i biodiversitetit të territorit.

N 2. Zbutja dhe ulja e ndikimit të vendbanimeve ekzistuese urbane brenda dhe përreth zonave natyrore të mbrojtura.

N 3. Zvogëlimi progresiv dhe zhdukja e niveleve aktuale të ndotjes së lumenjve dhe vijës bregdetare, në harkun kohor të të dy dekadave për të cilat parashikohet plani vendor.

N 4. Zgjerimi dhe përmirësimi sistemeve aktuale operative dhe menaxhimi i ciklit të mbeturinave të ngurta urbane.

N 5. Fuqizimi i rrjeteve urbane teknike, në veçanti rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.

N 6. Rivendosja në punë e rrjetit të kanaleve të vaditjes e kullimit të tokave bujqësore dhe hidrovoreve, gjë e cila do shërbejë edhe si një masë mbrojtëse nga përmbytjet.

N 7. Zbutja dhe ulja e ndikimit të zonave dhe objekteve industriale dhe të minierave ekzistuese brenda dhe përqark zonave urbane.

N 8. Rritja e zonave pyjore në zonat kodrinore, malore dhe bregdetare.

N 9. Promovimi i turizmit natyror dhe të ekskursionit.

N 10. Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjetit ekologjik territorial, si një lidhje strukturore midis zonave me vlerë dhe pasuri të madhe të biodiversitetit.

N 11. Promovimi dhe përgatitja e instrumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të zonave me interes mjedisor (Planet e menaxhimit për sitet me interes të komunitar /rrjeti Emerald; planet e resurseve natyrore të zonave të mbrojtura).

Fig. 55 Sistemi natyror



2.3.1.2 Sistemi Ujor (U)

U.1 Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve dhe rezervave natyrore hidrologjike.

U. 2 Modernizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjeteve të shpërndarjes lokale.

U. 3 Rritja e hidrocentraleve.

U. 4 Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe shpërndarjes së ujit publik, i parë si një nga të mirat/resurset e përgjithshme.

U.5 Rigjenerimi i organeve kryesore hidrikë, në të mirë të ekosistemeve lokale dhe zhvillimin e mundshëm të turizmit sportiv.

U.6 Krijimi i një Autoriteti Publik Menaxhimi të burimeve ujore, në njohjen e zonave homogjene territoriale, si një mjet kontrolli dhe menaxhimi të cilësisë.

2.3.1.3 Sistemi Bujqësor (B)

B. 1 Promovimi dhe zhvillimi i modernizimit dhe inovacionit në sektorin e industrive vendase dhe në sektorin e integrimit të zinxhirëve të strukturave të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit.

B. 2 Promovimi dhe zhvillimi i prodhimit cilësor në sektorin bujqësor, blegtoral dhe pyjor.

B. 3 Përmirësimi i aftësive sipërmarrëse dhe profesionale të punëtorëve në sektorin e bujqësor dhe pyjor.

B. 4 Promovimi i metodave të kultivimit biologjik dhe të permakulturës.

B.5 Konvertimi për përdorim bujqësor, i zonave të degraduara dhe të braktisura.

Fig. 56 Sistemi ujor

B. 6 Rinisja dhe mirëmbajtja e aktivitetit blegtoral pyjor në zonat kodrinore, në lugina dhe zonat malore të brendshme, të kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore (çaj mali etj.), si dhe të kultivimit të peshkut në ligatinat dhe zonat bregdetare.

B. 7 Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral, në zonat fushore e bujqësore blegtorale, në zonat kodrinore dhe ato malore.

B. 8 Riorganizimi dhe zhvillimi i strukturave mbështetëse për aktivitetin bujqësor, të tilla si shoqëritë (konsorciumet) bujqësore për shërbim dhe trajnime, për fermat e vogla dhe të mesme.

B. 9 Zhvillimi i ndërtimit të objekteve të logjistikës për mbledhjen, ruajtjen, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore vendore, mbi bazë të konsorciumit dhe/ose kooperativës.

B. 10 Promovimi i krijimit të qendrave të kërkimit dhe trajnimit në agrobiznes dhe edukimit në mirë ushqimin, madje edhe në shkolla dhe fushën e arsimit.

B. 11 Promovimi i themelimit e shpërndarjes territoriale të strukturave akomoduese (struktura agro-turizmi, B&B ekologjike, ferma didaktike, fshatra ekologjikë) dhe të restoranteve cilësorë që valorizojnë produktet dhe traditat ushqimore vendase, si dhe peshkimin dhe kultivimin e peshkut.

2.3.1.4 Sistemi Urban (UB)

UB. 1 Nxitja e rikuperimit dhe rivitalizimit të qendrës historike të qytetit të Krujës si dhe qendrave apo monumenteve historike të vogla brenda qytetit, nëpërmjet përdorimit turistik, por edhe nëpërmjet banimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

UB. 2 Forcimi i strukturave hoteliere dhe shërbimeve plotësuese të turizmit kulturor, mjedisor, sportiv (aktiv), termal (spa), në zonat urbane të Krujës, pranë Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", pranë banjave termale në Bilaj, në zonat me interes natyror peizazhistik dhe mjedisor, si dhe në fshatrat e zonave të thella malore.

UB.3 Përshtatja, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, të objekteve kryesore të infrastrukturës (rrjetet kryesore), në zonat urbane dhe në zonat informale.

UB. 4 Rregullimi, sipas standardeve të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, i strukturave infrastrukturore sekondare (objektet publike, gjelbërim dhe parkime), në zonat kryesore urbane.

UB. 5 Zhvillimi i qendrave të reja urbane në qendër të Fushë-Krujës dhe lokalitetet e tjera të mëdha urbane (universitete, qendra kërkimore, biblioteka dhe mediateka lokale).

UB. 6 Zhvillimi i sistemeve alternative të lëvizjes urbane (rrugëve çiklizmi, rrjetet këmbësorësh), të integruara me sistemin e transportit publik, rrugor dhe hekurudhor.

UB. 7 Racionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të rrugëve automobilistike, të integruar me sistemin e parkimeve urbane dhe territoriale.

UB. 8 Rimëkëmbja dhe ripërdorimi, si një korridor transporti me lëvizje të shpejtë, i linjës ekzistuese hekurudhore, në përputhje me rimëkëmbjen e saj si një infrastrukturë e rëndësishme kombëtare; rehabilitim ky, i parashikuar edhe në PPK.

UB. 9 Nxitja e qasjes, përdorimit dhe shkëmbimit të resurseve urbane të përbashkëta (Urban Commons) për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.

UB. 10 Realizimi i aksesit dhe sigurisë së qytetit dhe të resurseve urbane të përbashkëta, si dhe realizimi i qasjes së drejtpërdrejtë së fëmijëve në qytet (Qyteti mik i fëmijëve).

2.3.1.5 Sistemi Infrastrukturor (IN)

IN. 1 Të sigurohet efikasiteti i plotë dhe funksionaliteti i rrjetit infrastrukturor me karakter kombëtar (korridoret nacionale), me ndarjen e trafikut lokal, me ndërtimin e mbikalimeve dhe nënkalimeve e rrjeteve lokale, duke bërë progres kështu, në transformimin gradual në autostradë.

IN. 2 Rimëkëmbja dhe zhvillimi i rrjetit hekurudhor kombëtar, për lidhje ndërkombëtare si dhe për përdorim urban dhe lokal.

IN. 3 Rimëkëmbja dhe zhvillimi i stacioneve hekurudhore, si pikat aksesi dhe shërbimi të qendrave të banuara, dhe si pika të lidhjes me rrjetin e korridoreve të gjelbër, të cilët realizojnë ndërveprimin ndërmjet zonës bregdetare dhe asaj malore.

IN. 4 Zhvillimi dhe konsolidimi i rrjetit të parkimit në nivel territorial, urban dhe lokal.

IN. 5 Zhvillimi i një rrjeti të rrugëve me lëvizje të ngadaltë, lidhur me rizbulimin e vendeve dhe peizazheve me bukuri natyrore, kulturore e arkeologjike, etno-antropologjike, si dhe atyre me cilësi të pasura agro-ushqimore (rrugë të ullishtave, rrugë të vreshtave, rrugë të produkteve lokale).

IN. 6 Forcimi dhe zhvillimi i rrjeteve të telekomunikacionit, si në nivel rajonal (rrjetet satelitore) dhe në nivel urban (rrjetet wireless, me kabllo në qendrat kryesore).

Fig. 57 Sistemi bujqësor





Fig. 58 Sistemi urban



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Fig. 59 Sistemi infrastrukturor

IN. 7 Avancimi dhe zhvillimi i rrjeteve të transportit të energjisë, me një fokus të produktet që kanë ndikim (ndotës elektromagnetike) dhe shqyrtimin e zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

IN. 8 Zhvillimi i sistemeve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme në zonat urbane dhe në mbështetje të impianteve industriale ekzistuese dhe të aktiviteteve kryesore ekonomike.

IN. 9 Kontrolli dhe nxitja për kursimin e energjisë dhe për rikuperimin/ripërdorimin/riciklimin e mbetjeve të ngurta komunale.

IN. 10 Krijimi i një qendre logjistike strategjike, lidhur me afërsinë ndaj aeroportit ndërkombëtar dhe portit kryesor turistik e tregtar të vendit, portit të Durrësit.

2.3.2 Mbivendosja e sistemeve territoriale

Mbivendosja e strategjive territoriale sektoriale. Përkufizimi i rolit, misioni dhe statusi i Bashkisë Krujë.

Objektivat e sektorëve që përcaktojnë strategjitë territoriale kërkojnë një përkufizim unitar që ka të bëjë me rolin dhe me misionin që bashkia Krujë ka marrë përsipër për zhvillimin e saj të ardhshëm, ose të paktën në periudhën për të cilën ky plan ka synim të veproje.

TOKA E NDËRMJETME:
Territor i sigurt, me tokë bujqësore pjellore, trashëgimi historike, natyre, artizanat lokal, resurs agro-ushqimor kombëtar.

Shkurtimisht, një toke e përbëre nga peizazhe të ndryshme dhe me kualitet, shprehje e raporteve sociale, historisë dhe vlerave ekologjike mjedisore, të cilat ushqehen dhe pasurojnë biodiversitetin e lartë të konteksteve.

Një territor ku mjediset e ndryshme dhe me kualitet të rizbuluar, shprehje, në të shkuarën, e një pasurie kulturore, prodhuese dhe biodiversiteti, duhet të lidhen bashke dhe mund të frymëzohen nga mundësitë e reja të zhvillimit të qëndrueshëm, duke u mbështetur në zhvillimin e rrjeteve të transportit ekzistuese dhe të reja, në korridoret ekologjike dhe në itineraret e zbulimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe mjedisore lokale, e mirë e përbashkët e atyre që jetojnë në këtë territor dhe e atyre që e vizitojnë.

Një territor, pra, që i duhet rikthyer traditave të mira dhe solide ekonomike, duke ruajtur karakteristiken e tij si territor tranzitimi, marrëdhëniesh, lëvizjeje dhe shkëmbimesh, por duke u mbështetur tek aktivitetet që prodhojnë punësim dhe të ardhura duke filluar nga zhvillimi i qëndrueshëm i resurseve lokale.

Për shkak edhe të proceseve të vona të pakontrolluara dhe të paplanifikuara, një territor ku gjenden morfologji vendbanimesh dhe materiale urbane të ndryshme të cilët krijojnë forma të ndryshme banimi, stile të ndryshme jetese, urbane dhe sub-urbane, që shikohen si shprehje e pasurisë, përveçse arsye qeverisjeje për zgjidhjen e problemeve, eksperiencave dhe raporteve sociale dhe prodhuese.

Brenda këtij vizioni të përgjithshëm, bashkia Krujë duhet të theksojë karakteret specifike që e identifikojnë, të cilat bazohen në historinë e saj, por që duhen kërkuar, me sy projektual, në prirjet që, pikat e shumta të forta dhe mundësitë që paraqiten në horizont, duket se i dedikojnë.

Kruja, pra, duhet parë në këndvështrimin e historisë, pozitës gjeografike dhe të kushteve mjedisore te jashtëzakonshme që e karakterizojnë. Far kulturor dhe gjeografik i një konteksti që për një pjesë të madhe është edhe ai i kryeqytetit, me të cilin, të paktën qendra

Fig. 60 Mbivendosja e strategjive territorial



me e madhe, është në kontakt direkt, si nga pikëpamja e infrastrukturave ashtu edhe vizuale.

Mundimi dhe synimi, i paprecedent, nëse i referohemi një riorganizimi të ri administrativ që mban bashke, fillimisht në mënyrë të sforcuar, njësi urbane, deri pak kohe me parë të ndryshme dhe të largëta, është që të gjendet, me mire nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje e gjerë që ta bëjë të pranueshëm për të gjithë, një përcaktim që ta çojë këtë territor në të ardhmen e zhvillimit dhe riorganizimit territorial.

Mundësi përcaktimi mund të gjendet në një karakter morfologjik, që ndoshta është në gjendje të mbaje bashke, nëpërmjet një terminologjie të thjeshte, lehtësisht të memorizueshme, një horizont me të gjerë sesa një episod i vetëm vendbanimi në të cilin sot duhet lexuar e gjithë bashkia.

"Toka e kodrave të Krujës"

Ato kodra, të cilat, pasi i janë hequr nga duart aktiviteteve nxjerrëse të parregullta, të mbrojtura nga prania e impianteve të mëdha industriale ekzistuese (për të cilat parashikohet, në kohe jo shumë të largëta, mbyllja, kur industria e ndërtimit do të njohe të njëjtin transformim prodhues në të cilin është e destinuar të shkojë në të gjithë perëndimin, duke u bazuar edhe në uljen e konsumimit të tokës dhe rënies se konsumit të çimentos) duhet të kthehen, gradualisht, në zona të mbrojtura natyrore dhe në zona prodhimesh agro-ushqimore të cilësisë se lartë, territor për hyrjen në parkun historik-arkeologjik që duhet ndërtuar përreth ripërpunimit simbolik të Skënderbeut, duke e pastruar nga mbetjet e mitologjisë se regjimeve të shkuara (nga regjimi i pushtimit fashist tek ai komunist), dhe nga riorganizimi i ndërlikuar i qendrës urbane origjinale, që duhet të gjeje një karakter të ri si qender kulturore, pol i arsimimit, edhe universitar dhe me lart. Një toke kodrash dhe territori gati malor, që ndoshta duhet mbrojtur në ndonjë mënyrë, rreth të cilës artikulohen edhe pjesa e ulët e bashkisë: Fushë-Kruja, qender e re e shërbimeve dhe infrastrukturave publike: bashkësia e fshatrave të shumtë dhe formave të tjera të vendbanimeve që janë pjesë përbërëse tashme e të gjithë sistemit urban, shprehje e formave të reja të banimit, me impakt të ulët ekologjik.



03 / Veprimet strategjike dhe projektet e zhvillimit

3.1 PROJEKTET STRATEGJIKE

3.1.1 Tipologjitë e projekteve

Qasja inovative urbane, që synon të përftojë një kualitet më të lartë të rezultateve, bazohet në hartimin e bashkërenduar të strategjisë dhe të projekteve operative. Projektimi i zonave të veçanta përcaktohet njëkohësisht dhe në koherencë me vizionin e përgjithshëm strategjik, me synim maksimizimin e bashkëveprimit mes dinamikave të zhvillimit dhe karakterit hapësinor të zonave.

Kjo lidhje e ngushtë mes planifikimit strategjik dhe projekteve operative është kushti kryesor për të siguruar efikasitetin e proceseve dhe cilësinë e rezultateve. Për këtë arsye, Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), përveç koherencës së kuadrit të përgjithshëm, duhet të përmbajë edhe projektin e zonave të konsideruara me interes strategjik. Projekti i tyre duhet konsideruar si emblematik dhe si një shembull i drejtimeve të ndryshme që mund të ndiqen për rigjenerimin urban dhe zhvillimin e territorit, gjithashtu duhet të jetë një pikë referimi dhe udhëzues për ndërhyrjet e ardhshme në territor.

Projektet strategjike mund të jenë të llojeve të ndryshme. Edhe pse të gjitha kanë si synim zhvillimin e përgjithshëm të territorit, ato mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme në arritjen e objektivave strategjike.

Në radhë të parë, mund të themi se ekzistojnë projekte që janë të nevojshme për të siguruar kushtet nga ku mund të nisin proceset e zhvillimit. Këto janë projekte që duhet të kenë si synim pajisjen e territorit me shërbimet bazë, siç janë shërbimet parësore, qëndrueshmëria mjedisore, jetueshmëria e qyteteve (përshtatja e rrjeteve teknike, pastrimi i territorit nga mbetjet urbane, kontrolli i shfrytëzimit të burimeve ujore etj.). Këto lloje projektesh mund t'i quajmë "projekte bazë".

Pastaj qëndrojnë projektet që i dedikohen në mënyre më të veçantë zhvillimit. Këto projekte trajtojnë tematika specifike, brenda sektorëve të përcaktuar si strategjikë, për zhvillimin e komunitetit vendor. Si rregull, këto janë të paktë në sasi por mjaft të rëndësishëm dhe të aftë për të nxitur proceset spontane dhe vetë-financuese të zhvillimit. Këto lloje projektesh mund t'i quajmë projekte zhvillimi (dhe mund t'i ndajmë në kategori të ndryshme: projekte infrastrukturore, projekte urbane, projekte prodhimi, e kështu me radhë).

Brenda kategorisë së projekteve të zhvillimit qëndrojnë projekte më të vogla, por shumë të rëndësishme, për nivelin e tyre të prioritetit dhe për aftësitë e tyre për të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

qenë shembull për projektet e ardhshme. Janë projekte shumë të rëndësishme për arsye të shikueshmërisë së tyre dhe aftësisë komunikuese, të cilat marrin rolin e "projekteve pilot".

3.1.2 Projektet bazë

"Projektet bazë/parësore" janë ata projekte, që konsiderohen të domosdoshëm për sigurimin e kushteve fillestare për zhvillim. Këto projekte nevojiten për të mundësuar arritjen e atyre kushteve fillestare që konsiderohen të domosdoshme për nisjen e çfarëdo programi zhvillimi, duke siguruar efiçencën minimale të sistemit territorial, pa të cilën është e pamendueshme nisja dhe nxitja e proceseve të zhvillimit të sistemit prodhues.

Këto projekte kanë të bëjnë me kushtet minimale të funksionimit dhe të jetueshmërisë së sistemit territorial, si për shembull efiçenca funksionale e sistemit urban, qëndrueshmëria mjedisore e sistemit të transportit, jetueshmëria e sistemit urban etj.

Projektet bazë/parësore, jo domosdoshmërisht kanë përmbajtje "strategjike", por shpeshherë kanë të bëjnë me pajisjen normale me elementet bazë të një territori. Në fakt, në rastet kur territori paraqet mungesa të mëdha nga pikëpamja e pajisjes me elementët bazë, mund të jetë e drejtë (në mos e domosdoshme) që t'u jepet ndërhyrjeve për zgjidhjen e këtyre mungesave një karakter strategjik. Në rastin specifik të sistemeve urbane në fjalë, arritja e një gjendjeje minimale të funksionalitetit të territorit është padyshim një para-kusht i nevojshëm për çfarëdolloj programi zhvillimi.

Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër për secilin nga këto projekte (apo propozime) bazë, por duke mënjanuar përshkrimin e hollësishëm të listave të gjata me nevojat konkrete, kryesisht për infrastrukturat. Duhet patur parasysh që projektet e propozuara në disa raste janë investime direkte që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve ndryshme por në disa raste janë dhe studime dhe raporte që paraprijnë dhe rrisin efektshmërinë e investimeve.

1. **Përmirësimi i rrjeteve teknike** nënkupton ndërhyrjet e nevojshme për krijimin ose përmirësimin e infrastrukturave bazë që mbulojnë zonat urbane dhe krijojnë kushtet bazë të jetesës për komunitetet lokale që jetojnë në këto zona. Në diskutime me stafin teknik të bashkisë Krujë, si investime të nevojshme primare që kanë një impakt direkt në përmirësimin e kushteve të jetesës janë:

Kodi	LISTA E PROJEKTEVE BAZË
PS 01	Përmirësimi i rrjeteve teknike
PS 02	Mbrojtje e akuiferëve
PS 03	Pastrimi i lumenjve
PS 04	Mbrojtje ndaj përmbytjeve
PS 05	Pastrimi i mbetjeve urbane
PS 06	Përmirësimi i rrugës së vjetër kombëtare
PS 07	Përmirësimi i hekurudhës
PS 08	Planifikim i detajuar vendor
PS 09	Plani i emergjencave civile
PS 10	Qendra kulturore në zonat urbane
PS 11	Qyteti mik i fëmijëve

Tabela 20: Projektet strategjike bazë



Fig. 61 Diagrama e ndërlidhjes së projekteve bazë

Infrastruktura rrugore

Nga lista e gjatë e inventarit të rrugëve lokale të bashkisë Krujë të cilat në shumicën e rasteve kanë nevojë përmirësimi, si projekte bazë janë konsideruar akset që lidhin qendrat e njësive administrative me akset kombëtare.

Infrastruktura e ujësjellës – kanalizime

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve në një pjesë të mirë të territorit mungon ose paraqitet i amortizuar. Ky rrjet duhet të jetë në qender të investimeve bazë të bashkisë në vitet e ardhshme, sidomos në zonat me popullsi të lartë dhe në qendrat me hierarki urbane primare. Nëpërmjet investimit në rrjetin e kanalizimeve do të mund të realizohej dhe mbrojtja e akuifereve dhe burime nëntokësore.

Infrastruktura e energjisë elektrike

Edhe përsa i përket kësaj infrastrukture ndërhyrjet janë të nevojshme pothuajse në gjithë territorin e bashkisë. Në shumicën e fshatrave konstatohet një tension i ulët, nën mesataren, dhe defektet janë të shpeshta. Janë të nevojshme investime në mirëmbajtjen/zëvendësimin e rrjetit të tensionit të ulët dhe të mesëm me qëllim arritjen e një standardi të qëndrueshëm furnizimi me energji elektrike

Kanalet vaditëse dhe kullues

Mirëmbajtja e rrjetit vaditës dhe kullues është kusht bazë për zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë rurale. Territori i Krujës është i pasur me toka bujqësore, sidomos në territorin perëndimor të bashkisë. Kjo tokë, e favorizuar nga pjelloria e lartë dhe kushtet klimatike përbën një prej motorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik. Pas viteve '90, mungesa e mirëmbajtjes dhe në disa raste dëmtimi i rrjetit të kanaleve ka sjellë një rënie të ndjeshme të kapaciteteve prodhuese.

2. Mbrojtja e akuiferëve.

Siç është trajtuar dhe në dokumentin e "Analizës së thelluar të territorit të Bashkisë Krujë" pjesë integrale e PPV, Akuiferi i Fushë-Krujës është një nga asetet më me vlerë të këtij territori. Zhvillimi informal i 20-25 viteve të fundit, mungesa e rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve që ka sjellë përdorimin në masë të puseve si mjet furnizimi me ujë dhe gropave septike për largimin e ujerave të zeza, vë në rrezik cilësinë e këtij pellgu ujëmbajtës nëntokësor. Dy janë aspektet kryesore që shohin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

monitoruar dhe me kalimin e kohës përmes investimeve adekuate duhen zgjidhur:

• Shfrytëzimi i pakontrolluar i Akuiferit nga puset e ujit. Kujtojmë këtu që pothuaj gjithë zonat dhe ndërtimet informale të viteve të fundit furnizohen me ujë përmes shpimeve të bëra nga vetë banorët. Cilësia e dobët e kësaj infrastrukture edhe në zonat tradicionalisht të banuara ka bërë që edhe në këto zona shumica e banorëve të bëjnë shpime spontane duke rezultuar kështu në një shfrytëzim të pakontrolluar të këtij akuiferi. Sa më sipër është propozuar që fillimisht të hartohet një kadastër (regjistër) i gjithë puseve në territorin e bashkisë dhe pastaj duke pasur një pasqyrë të qartë të gjendjes ekzistuese të shfrytëzimit të zbatohet një plan veprimi adekuat.

• Ndotja e Akuiferit. Mungesa e infrastrukturës së kanalizimeve të ujërave të zeza ka bërë që përdorimi i gropave septike të jenë i vetmi mjet për largimin e tyre. Si rrjedhim zhvillimet kryesisht me karakter informal të viteve të fundit mbartin një rrezik serioz në ndotjet e Akuiferit të Fushë - Krujës. Pajisja e zonave urbane, sipas prioriteteve dhe përqendrimit të popullsisë, me rrjetin e nevojshëm të kanalizimeve të ujërave të zeza do shmang gradualisht këtë problem mjaft serioz.
Sa më sipër mbrojtja e Akuiferit të Fushë - Krujës zgjidh një problem madhor me impakt direkt në përmirësimin e jetës së banorëve, rrit potencialet turistike dhe siguron një zhvillim të qëndrueshëm duke respektuar ekuilibrat mjedisor.

3. Pastrimi i lumenjve– mirëmbajtja e sistemit ujor sipërfaqësor

Territori i bashkisë Krujë ka një rrjet të ujërash sipërfaqësorë që janë një aset mjaft me vlerë për zhvillimin e bujqësisë, turizmit dhe cilësisë së jetës së komunitetit të banorëve që jetojnë në këtë zonë. Këtu përfshihen lumi Ishëm dhe degët e tij, rezervuarët dhe liqenet artificial dhe gjithë rrjetin e kanaleve vaditës.

Sa më sipër projektet e nevojshme për këtë rrjet ujor sipërfaqësor janë:

• Projekt për kontrollin, monitorimin e rreptë dhe gradualisht shmangien e shfrytëzimit të pakontrolluar të shtretërve të lumenjve për marrjen e inerteve;
• Projekt për kontrollin dhe ndalimin e rreptë të ndotjeve që vijnë nga bizneset e zhvilluara pranë këtyre asete ujore;

4. Mbrojtje ndaj përmbytjeve

Përmbytjet përbëjnë një rrezik tashmë konstant që cenojnë jetën e banorëve dhe ndikojnë negativisht në mjaft sektorë vitalë të bashkisë Krujë. Pasuria e madhe ujore dhe relievi mjaft i ulët në një pjesë të territorit janë kthyer në një problem konstant për komunitetin e kësaj zone. Pavarësisht disa iniciativave të marra kohët e fundit, konstatohet që në shumicën e rasteve projektet kanë qenë të një karakteri pjesor pa studiuar në tërësi ekuilibrat delikat të sistemit ujor të kësaj zone. Sa më sipër propozohet:

• Hartimi i një projekti të karakterit studimor që merr në konsideratë gjithë sistemin ujor të territorit të bashkisë dhe më gjerë si dhe ndikimin e kushteve klimatike të zonës.

• Plan për zhvendosjen graduale të gjithë banorëve që vitet e fundit kanë ndërtuar shtëpi në zona që mund të themi janë "pronë e përmbytjeve" dhe që janë kthyer tashmë në një problem të madh social. Ky plan duhet të ketë dhe programe mbështetje sociale për riakomodim në zona më të sigurta të këtyre banorë.

5. Menaxhimi i mbetjeve urbane

Trajtimi i mbetjeve urbane është një problematikë urgjente për gjithë territorin e bashkisë Krujë. Aktualisht është e nevojshme të hartohet një studim që merr në konsideratë menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin e bashkisë pas reformës territoriale, ku dhe problematikat

dhe sfidat për një menaxhim adekuat janë rritur. Vend-depozitimi i planifikuar për bashkinë Kruje, mbetet landfilli i Manzës. Në këtë kuadër, duhet planifikuar ndërtimi i stacioneve ndërmjetës (tranzitor) të depozitimit të mbetjeve si dhe hartimi i programit për nxitjen e grumbullimit të diferencuar dhe riciklimin.

6. Përmirësimi i rrugës së vjetër kombëtare

Rruga e vjetër kombëtare (aksi Nikël – Fushë Krujë – Borizanë - Thumanë), përbën një nga akset kryesore që lidh qendrat e banuara tradicionale të pjesës qendrore të bashkisë Krujë. Me ndërtimin e aksit të ri Tiranë - Milot, rruga e vjetër ka kaluar në një rëndësi të dorës së dytë dhe kanë munguar investimet konkrete. Duhet patur parasysh që kjo rrugë është pjesë e infrastrukturës kombëtare dhe si e tillë është në inventarin e akseve që menaxhohen nga Ministria që mbulon sektorin e transportit rrugor. Propozimi në këtë rast adresohet tek financimet e qeverisë qendrore për këtë sektor.

7. Përmirësimi i hekurudhës

Si në rastin e propozimit para-ardhës edhe përmirësimi i kushteve të infrastrukturës hekurudhore është një ndërmarrje dhe investim që bëhet nga qeverisja qendrore. Pavarësisht kësaj projekt-propozimi në këtë rast fokusohet në rivitalizimin e stacioneve hekurudhore që ndodhen brenda territorit të bashkisë Krujë. Stacioni Budull dhe Ishëm kanë prioritet në këtë kuadër. Gjithsesi në një afat më të gjatë, duhet rehabilituar linja Budull – Fushë Krujë (aktualisht jashtë përdorimit) si dhe duhet zhvilluar poli logjistik i Fushë Krujës ku transporti hekurudhor do të jetë një ndër asetet bazë.

8. Planifikim i detajuar vendor

Në zbatim të kuadrit ligjor për planifikimin e territorit, planet e detajuara vendore (PDV) përfshihen në nivelin e dytë të instrumenteve të planifikimit (planifikimi në nivel vendor). Pas miratimit të PPV, është detyrë e bashkisë që të nis procesin e koordinimit ose të hartimit të PDV-ve kryesisht për ato zona ku presioni i zhvillimit është i madh. Sa më sipër propozohet:

• Hartimi i PDV për zonat turistike, në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me agjencitë qendrore të planifikimit të territorit dhe të zhvillimit të turizmit;

• Hartimi i PDV për zonat informale, në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me ALUIZNI-n;

• Hartimi i PDV për zonat që preken nga infrastrukturat e rëndësisë kombëtare në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ministrinë e linjës.

9. Plani i emergjencave civile

Dihet që territori i bashkisë Krujë është subjekt i rreziqeve të ndryshme natyrore që ndikojnë negativisht dhe në disa raste rrezikojnë direkt edhe jetën e banorëve. Ndër rreziqet kryesore mund të përmendim përmbytjet që tashmë kanë marrë një karakter periodik në këtë zonë. Gjithsesi edhe rreziku sizmik dhe zjarret janë disa prej rreziqeve kryesore që duhet të ketë në fokus Plani i Emergjencave Civile për territorin e Bashkisë Krujë.

• Hartimi i Planit të Emergjencave Civile të bashkisë Krujë;
• Masa informuese dhe sensibilizuese që bazohen tek konkluzionet e këtij plani me qëllim orientimin e komuniteteve të rrezikuara në raste fatkeqësish.

10. Qendra kulturore në zonat urbane

Qendrat kulturore mungojnë pothuajse në gjithë zonat urbane të bashkisë Krujë. Ngritja nga e para ose ristrukturimi i atyre ekzistuese përbën një projekt bazë strategjik për zhvillimin normal të jetës së komunitetit të banorëve në zona të ndryshme të bashkisë Krujë. Në këtë kuadër duhet nxitur ngritja e qendrave kulturore për organizimin e veprimtarive kulturore, artistike, sportive e shkencore me fokus fëmijët dhe të rinjtë e qendrës e banuara.

11. Qyteti mik i fëmijëve

"Qyteti i fëmijëve" është një programi kombëtar i mbështetet nga UNICEF, qe ka filluar te konkretizohet

REPUBLIKA SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA

PROJEKTE ZHVILLIMI			
	PP	PSV	PSV
	AFAT-SHKURTËR (projekte pilot)	AFAT-MESËM	AFAT-GJATË
INFRASTRUKTURË DHE LOGJISTIKË (I+L)	Transformim i stacionit hekurudhor në Buduil	Rindërtim i Urës se Tubit	Aksi i ri Thumanë - Tiranë
		Rruga Prezë - Buduil	Rruga Krujë-Tiranë
		Lidhja Thumane/Bubq	Sistemi i aeroportit "Nënë Tereza"
		Pol logjistik i integruar në Fushë-Kruje	Lidhja e Bubqit me bregdetin
		Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës	Rruga lidhëse Krujë-Mamurras
		Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës	Rruga Krujë Burrel
TURIZËM KULTUROR (TK)	Rikuperim i një guroreje të braktisura në Krastë	Kalaja e Krujës dhe Pazari i Vjetër	Ujërat termale në Bilaj
	Korridori i gjelbër Albanopolis – Lugina e Ishmit - Bregdet	Pika me interes religjioz dhe panoramik në Sarisaliti	Turizëm malor në Qafështamë
	Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis)		
INOVACION PRODHIMI (IP)	Inkubator ndërmarrjesh dhe shkollë profesionale	Ndërtimi i baxhove eksperimentale	
		Zonë tregu lokal	
		Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe shëndetit	

Table 21 Projektet strategjike të zhvillimit sipas tipit dhe kohës së zbatimit

fillimisht në qytetin e Korçës dhe do shtrihet në gjithë qendrat kryesore urbane të Shqipërisë. Qëllimi kryesor i këtij programi është krijimi i qendrave multi-funksionale të cilat i dedikohen tërësisht fëmijëve. Në këtë kuadër propozohen dhe arredime urbane me fokus fëmijët dhe dimensionimi i hapësirave publike sa më shumë të aksesueshme nga ata. Programimi i ndërhyrjeve urbanistike me pjesëmarrje të gjerë për përmirësimin e jetës së fëmijëve në qytete, duke njohur dhe realizuar të drejtat e tyre.

Pavarsisht se numri i projekteve të propozuara është i kufizuar, nevojat në sektorët e shërbimeve kryesisht urbane, janë mjaft më shumë. Gjithsesi, këto projekte japin një impakt mjaft pozitiv në cilësinë e jetës së banorëve dhe sigurojnë një bazë për zhvillimin në tërësi të bashkisë.

3.1.3 Projektet e zhvillimit

"Projektet e zhvillimit" janë projektet te mirëfillta me karakter strategjik, të cilave plani kërkon t'iu caktojë detyrën e nisjes së proceseve të zhvillimit të sistemit territorial dhe atij socio-ekonomik.

Bëhet fjalë, në përgjithësi, për projekte që kanë disa karakteristika bazë: i) janë të lidhura ngushtë me potencialin që plani i njeh kontekstit të konsideruar; ii) kanë një rëndësi të lartë dhe aftësi të mëdha nxitëse; iii) prej tyre pritet një impuls i fortë në ndihmë të proceseve të zhvillimit.

Këto projekte përfaqësojnë përgjigjen operative ndaj drejtimit që plani sheh si potencial (ose kërkon të zhvillojë) në një territor të caktuar: i japin forcë potencialeve ekzistuese ose të evidentuara në kontekstin lokal. Është kjo arsyeja pse këto projekte janë të rëndësishme dhe me peshë të madhe, si nga pikëpamja e përqendrimit të resurseve, ashtu edhe nga ajo e pritshmërisë së zhvillimit.

Për shkak të natyrës së tyre të veçantë, këto projekte nuk mund të jenë të shumtë në numër, për të njëjtin territor. Situata me optimale do të ishte që, për secilin kontekst bashkiak, plani të përcaktojë pak ndërhyrje, pra ato që



Fig. 62 Diagrama e ndërlidhjes së projekteve të zhvillimit dhe objektivave strategjike

cilësohen si më prioritare nga administratorët lokalë dhe palët e interesit.

Në kuadër të kësaj kategorie të projekteve, është e domosdoshme të identifikohen ata që kanë për detyrë të shfaqin, me fakte, potencialet e zhvillimit të identifikuara për territorin përkatës ("projektet pilot"). Këto ndërhyrje, janë të lidhura ngushtë me strategjinë e zhvillimit të identifikuar për zonën në studim, por janë të një përmase më të vogël, edhe pse me domethënie dhe ndikim të fortë komunikues. Karakteristika kryesore e këtyre projekteve është, që të realizohen shpejt dhe me pak fonde: bëhet fjalë kryesisht për projekte demonstruese, për të cilat nuk është e nevojshme që të ketë shpenzime të mëdha kapitale, ndërkohë që është e rëndësishme të jenë në gjendje të nisin menjëherë, dhe të jenë në gjendje të tregojnë, sa më shpejt, në kohë të shkurtër, frytet e veprimeve të zhvillimit të identifikuara në planin e propozuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Në përputhje me vizionin strategjik, të caktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë, dhe me një propozim teknik të prioritetit të ndërhyrjeve, mund të sugjerojmë një klasifikim të projekteve të zhvillimit për linjat dhe kohët e veprimit dhe realizimit.

Për territorin e Krujës janë identifikuar tri linja veprimi, si mëposhtë:

1. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA
2. TURIZMI KULTUROR
3. INOVACION PRODHIMI

3.2 PROGRAMET DHE PLANI I VEPRIMIT

3.1.1 Plani i veprimit

Ndërhyrjet specifike që do të përbejnë planin e veprimit, modalitetet dhe afatet e tyre, do të përkufizohen më mirë nëpërmjet ballafaqimit me ekspertët e ministrive dhe autoritetet lokale. Për momentin, do të mjaftohemi me paraqitjen e metodologjive të vlerësimit që do të aplikohen në secilin nga projektet.

Në prill të vitit 2009, Shqipëria paraqiti kërkesën zyrtare për pranim në Bashkimin Evropian (BE), gjë që shënoi nisjen e një procesi që çoi Këshillin e Bashkimit Evropian, në qershor të vitit 2014, t'i japë vendit statusin 'kandidat' për në BE. Duke u mbështetur në këtë status, Shqipëria mund të marrë financimet e parashikuara nga Plani i Ndërhyrjeve për fazën e dytë, ajo e Para-Pranimit (IPA II - Instrument for Pre-accession Assistance). Ky plan, që bën pjesë në Politikat e Pranimit në Bashkimin Evropian, përfshin periudhën 2014-2020 dhe ve në dispozicion një buxhet prej 11.7 miliardë euro për ndërhyrjet në pesë nga fushat e mëposhtme:

- mbështetje në tranzicion dhe përforcim të institucioneve nëpërmjet reformave të Administrimit Publik;

- bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet shteteve pjesëtare të UE dhe vendeve të tjera të pranueshme në IPA (Maqedoni, Turqi, Shqipëri, Mal i Zi, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë);

- zhvillim rajonal, në aspektin e zhvillimit ekonomik, të transportit dhe të mbrojtjes së mjedisit;

- zhvillimi i burimeve njerëzore dhe luftë kundër përjashtimit dhe varfërisë;

- zhvillimi rural dhe i sistemeve bujqësore.

Në dhjetor të vitit 2014 Bashkimi Evropian ka lëshuar një dokument që përditëson udhëzimet për Analizat Kosto-Përfitim (CBA – Cost Benefit Analysis), të përcaktuara më parë nga BE në 2003 dhe në 2008 duke iu referuar IPA-s së parë, të cilat janë kërkesa për të hyrë në bashkë-financimin e Programeve Operative të Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF – European Regional Development Fund) dhe Fondin e Kohezionit.

(http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/studies/pdf/cba_guide.pdf)

Metodat e analizës financiare dhe ekonomike të Analizave Kosto-Përfitim (CBA) të përcaktuara në këto udhëzime, dhënë shkurtimisht më poshtë, janë ato të cilave në do t'u përmbahemi në analizën financiare dhe ekonomike të projekteve që do të janë pjesë e Planit të Veprimit të kësaj PPV-je.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

3.2.2 Analiza financiare e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit

Qëllimi i analizës financiare të një projekti është që të vlerësojë karakteristikat e tij, si më poshtë:

- përfitimin nga projekti në tërësi;

- përfitimin për pronarët dhe grupet e interesit;

- sigurimin e qëndrueshmërisë financiare;

- përcaktimin e flukseve të mjeteve monetare të krijuara nga projekti, me qëllim vlerësimin e kostove dhe përfitimeve socio-ekonomike, të cilat maten në analizën ekonomike.

Nga pikëpamja metodologjike, analiza financiare e një projekti fillon me vlerësimin e flukseve të të ardhurave monetare, hyrëse dhe dalëse, që ai gjeneron:

a) Fluksi i të ardhurave dalëse:
- shpenzimet totale të investimit: shpenzimet teknike (kostot fikse të prodhimit, të tilla si toka, ndërtesa, makineri etj.) dhe shpenzimet fillestare;

- kostot operative: kostot e personelit, shpenzimet e energjisë, si dhe shpenzimet e tjera, shërbime dhe produkte të ndërmjetme, të lëndëve të para;

- kosto të tjera: shlyerjen e kredive, interesi pasiv mbi borxhet, taksat.

b) Fluksi i të ardhurave hyrëse:
- të ardhurat operative;

- burimet financimi;

- kontribute publike;

- kapitali social që vjen nga privatët;

- kreditë (huatë) që vijnë nga privatët.

Analiza e flukseve të të ardhurave monetare mundëson vlerësimin e profilit financiar te projektit, dmth.:

- rendimenti financiar i investimeve, sa i perket vlerës aktuale dhe normës së rendimentit të brendshme;

- rendimenti financiar e kapitalit kombëtar, që është vlera aktuale dhe norma e rendimentit të investimit pa përfshirë kontributet që vijnë nga BE-ja;

- qëndrueshmëria financiare e projektit.

Një projekt konsiderohet i qëndrueshëm nga pikëpamja financiare nëse rreziku për të mbetur në të ardhmen pa të ardhura monetare (cash), si gjatë fazës së investimit fillestar ashtu dhe gjatë fazës operacionale, është zero.



Fig. 63 Qëndrueshmëria financiare e projektit

Nëse një projekt ka kthim financiar neto pozitiv (FNPV > 0), atëherë projekti nuk kërkon mbështetje publike financiare (projekt i nxehtë). Në të kundërt, një projekt që tregon një kthim financiar neto negativ (FNPV <0), ka nevojë për mbështetje financiare (projekt i ftohtë).

3.2.3 Analiza ekonomike e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit

Qëllimi i analizës ekonomike është vlerësimi i efekteve socio-ekonomike të një projekti, gjegjësisht kontributin e saj në mirëqenien e zonës dhe të vendit. Për këtë qëllim duhen vlerësuar disa vlera që nuk janë drejtpërdrejt të dukshme:

- të ashtuquajturat "çmime hije" (shadow prices), të cilat pasqyrojnë kostot sociale të të mirave dhe shërbimeve të prodhuara, në vend të çmimeve të thjeshta të tregut; "korrigjimet fiskale", dmth. eliminimi i shtrembërimeve të çmimeve të tregjeve shkaktuar nga subvencionet dhe taksat;

- prania dhe madhësia e "efekteve anësore" të mundshme të projektit, të cilat janë efektet (pozitive dhe/ose negative) të projektit të cilat nuk janë reflektuar në çmimet e vëzhguara, dmth, kostot dhe përfitimet e mundshme që rrjedhin nga projektet e subjekteve apo personave të tretë, kur për këta të fundit nuk ka një përfitim monetar (shembull tipik janë efektet në mjedis).
Pasi të gjitha kostot dhe përfitimet e një projekti (te vëzhguara ose të parashikuara) janë matur dhe vlerësuar në terma monetare, matet performanca ekonomike, duke përdorur treguesit e mëposhtëm:

- vlerën ekonomike aktuale neto, e barabartë me diferencën ndërmjet vlerës aktuale (dmth. e zbritur) të përfitimeve me kostot sociale të pritshme neto;

- normën e rendimentit ekonomik, të barabartë me normën e zbritjes, e cila e aplikuar për llogaritjen e vlerës aktuale ekonomike, e bën zero vlerën e këtij të fundit;

- raportin mes përfitimeve dhe shpenzimeve aktuale.

Sigurisht, projektet që tregojnë një vlerë ekonomike aktuale negative janë nuk janë projekte të përshtatshme për t'u realizuar, ndërkohë që është e përshtatshme për të zbatuar ato projekte me një vlerë ekonomike aktuale pozitive.

Së fundmi, analiza kompletohet me vlerësimin e rreziqeve, në mënyrë që të marrë parasysh pasigurinë që shoqëron çfarëdo projekt investimi, i cili përfshin edhe rreziqet e ndryshimeve të klimës. Analiza e rreziqeve që përshkojnë një projekt, artikulohet në tri pika:

- analiza e ndjeshmërisë (sensitivity analysis), e cila çon në identifikimin e ndryshoreve 'kritike', ndryshimi i papritur e të cilave mund të ketë efekte rrënjësore në performancën ekonomike ose financiare të projektit;

- analiza e cilësisë dhe analiza probabilistike e rreziqeve ndaj të cilave projekti është i ekspozuar;

- ndërhyrjet që kanë për qëllim parandalimin ose zbutjen e këtyre rreziqeve.

3.2.4 Plani i veprimit sipas objektivave strategjike

"Projektet e Zhvillimit" janë te organizuar ne "Objektiva Strategjike" dhe ne "Programe Strategjike". "Programet Strategjike" janë nënkategori e Objektivave Strategjike dhe janë te detajuara ne faza kohore: afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjate. "Projektet e zhvillimit" afat-shkurtër marrin rolin e "Projekteve Pilot" dhe janë ata te cilët nisin zbatimin e secilit prej programeve te Zhvillimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.1: INFRASTRUKTURE DHE LOGJISTIKE				
PROGRAMET STRATEGJIKE	PROJEKTET	AFATI		
		SHKURTER	MESEM	GJATE
INFRASTRUKTURA E TERRITORIT	Reehabilitim dhe transformim i stacionit në Budull			
	Rruga Prezë - Budull			
	Lidhja Thumanë – Bubq			
	Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës			
	Sistemi i aeroportit "Nënë Tereza"			
	Rindërtim i Urës së Tubit			
	Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës			
	Rruga Krujë-Tiranë			
	Rruga Kruje - Burrel			
	Rruga lidhëse Krujë-Mamurras			
	Aksi i ri Thumanë - Tiranë			
LOGJISTIKE E INTEGRUAR	Pol logjistik i integruar në Fushë-Krujë			

Tabela 22 Objektivi Strategjik: Infrastrukturë dhe Logjistikë

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.2: TURIZËM KULTUROR				
PROGRAMET STRATEGJIKE	PROJEKTET	AFATI		
		SHKURTER	MESEM	GJATE
ZHVILLIMI I OFERTËS	Rikuperimi i gurorëve të braktisura në Krastë			
	Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis)			
	Pikë me interes religjioz dhe panoramik në Sarisalltik			
	Ujërat termale në Bilaj			
	Kalaja e Krujës dhe Pazari			
	Turizëm malor në Qafështamë			
INTEGRIMI I OFERTËS	Korridori i gjelbër Albanopolis - Lugina e Ishmit - Bregdet			
	Lidhja e Bubqit me bregdetin			

Tabela 23 Objektivi Strategjik: Turizëm kulturor

OBJEKTIVI STRATEGJIK NR.3: INOVACIONE PRODHIMI				
PROGRAMET STRATEGJIKE	PROJEKTET	AFATI		
		SHKURTER	MESEM	GJATE
INOVIMI I SISTEMIT	Inkubator ndërmarrjesh dhe shkollë profesionale			
	Zone=ë Tregu Lokal			
	Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe shëndetit			
INOVIMI I PRODUKTIT	Ndërtimi i baxhove eksperimentale			

Tabela 24 Objektivi Strategjik: Inovacion prodhimi

PLANI I VEPRIMIT PROJEKTET BAZË – BASHKIA KRUJË

Nr.	Titulli i Projektit	Territori që preket Njësitë Administrative	Grupet (komuniteti) që preken	Vlera e projektit (Lek)	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit			Komente
1	Përmirësimi i rrjeteve teknike										
1.1	Infrastruktura rrugore lokale	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turistët	720 000 000	Bashkia, FZHR, MTI	Gjatësi rruge (km)	Bashkia, FZHR				Këtu është parashikuar lidhja e qendrave të njësive administrative me akset kombëtare (≈ 34km)
1.2	Rrjeti i ujësjellës kanalizime	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turistët	6 200 000 000	UK Krujë DPUK	Km (linja) Nr. banorë furnizuar	UK Krujë DPUK				Llogaritjet për rrjetin e ujësjellësit janë bazuar në popullsinë e bashkisë.
1.3	Rrjeti i energjisë elektrike	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turistët	1 200 000	OSHEE MEI	Km (linja) Nr. banorë	OSHEE OST				
1.4	Rrjeti ujitjes dhe kullimit	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turistët	560 000 000	Bashkia, Bordi i kullimit, MBZHRAU, FZHR	Ha tokë të vaditura Ton prodhim	Bashkia, Bordi i Kullimit FZHR				Përsa i përket kanaleve tretësore, mund të parashikohet edhe përfshirja e agro-bizneseve
2.	Mbrojtja e akuiferëve – sistemi ujor nëntokësor										
2.1	Hartimi i kadastrës së puseve	Nikël, Fushë-Krujë, Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor	2 500 000	Bashkia	Nr. pusesh	Bashkia				
2.2	Mbrojtja nga ndotja e Akuiferit të Fushë-Krujë.	Nikël, Fushë-Krujë, Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor	420 000 000	Bashkia	Parametra të ndotjes të zvogëluara	Bashkia				
3.	Pastrimi i lumenjve– sistemi ujor sipërfaqësor										
3.1	Kontroll i shfrytëzimit të inerteve	Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turistët	3 000 000	Bashkia ARM	Pika shfrytëzimi të mbyllura	Bashkia ARM				Mbrojtja nga ndotja e Akuiferëve ka lidhje direkte me investimet në U-K të zonës.
3.2	Kontrolli dhe ndalimi i rreptë të ndotjeve	Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turistët	4 000 000	Bashkia ARM	Parametra të reduktuara të ndotjes	Bashkia ARM				
4.	Mbrojtje ndaj përmbytjeve										
4.1	Hartimi i një projekti të karakterit studimor me fokus rrezikun ndaj përmbytjeve	Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal	10 000 000	Bashkia, Donatorë të huaj	Dokument Sensibilizim efektiv	Prefektura, Bashkia				
4.2	Plan zhvendosje graduale të gjithë banorëve nga zonat "pronë e përmbytjeve"	Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal	1 100 000 000	Bashkia, ALUIZNI	Banorë të zhvendosur	Bashkia, ALUIZNI				Përjashtohen zonat pa rrezik përmbytjeje
5.	Menaxhimi i mbetjeve urbane	Gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor, Turistët, Biznesi lokal	49 000 000	Bashkia, FZHR, Min. e Mjedisit	Ton (përpunim, riciklim, depozitim)	Bashkia, Min. Mjedisit				Përjashtohen zonat pa rrezik përmbytjeje
6.	Përmirësimi i rrugës së vjetër kombëtare	Fushë-Krujë, Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal Turizmi kulturor	52 000 000	MTI, FSHZH, Donatorë të huaj,	Gjatësi rruge (km) Nr. automjetesh	Bashkia, FZHR				Vlera e dhënë është kosto vjetore për menaxhimin e mbetjeve
7.	Përmirësimi i hekurudhës										
7.1	Rehabilitimi i linjës hekurudhore	Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	540 000 000	MTI	Gjatësi hekurudhe	Drejtoria Inspekt. Hekurudhor				Në territorin e Bashkisë Krujë gjatësia e këtij aksi rrugor është 15.4km
7.2	Rehabilitimi i stacioneve hekurudhore	Bubq	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	19 000 000	FZHR, MTI Bashkia	Nr. stacionesh	Drejtoria Inspekt. Hekurudhor				Në territorin e Bashkisë Krujë kemi 21.2 km hekurudhë
8.	Planifikim i detajuar vendor *(Vlerat për hartimin e PDV janë bazuar në VKM nr. 354, dt. 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim")*	Fushë-Krujë, Krujë, Bubq, Thumanë, Nikël	Komuniteti vendor, Operatorët turistik, Bizneset lokal	45 000 000	Bashkia Investitorë Privatë	Sipërfaqe në Ha (territor i planifikuar)	Bashkia, AKPT AKB ALUIZNI				Në territorin e Bashkisë kemi dy stacione hekurudhore: Stacioni Budull dhe Stacioni i Ishmit
9.	Plani i emergjencave civile (hartim dokumenti)	Të gjitha njësitë administrative	Komuniteti vendor	30 000 000	Ministria e Brendshme, Donatorë të huaj Bashkia	Dokument. Sensibilizim efektiv.	Prefektura				Në vlerën e projektit janë parashikuar hartimi i 10 PDV prioritare sipas listës së mëposhtme: - PDV në zonën turistike - PDV për zonat informale - PDV për zonat që preken nga infrastruktura kombëtare
10.	Qendra kulturore në zonat urbane	Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël, Borizanë	Komuniteti vendor	300 000 000	Bashkia FZHR Donatorë të huaj	m2 ndërtim dhe nr. qendrash	Bashkia				Të trajtojë të gjitha rreziqet që prekin territorin e bashkisë (përmbytje, zjarre, sizmik, ndryshime klimatike etj.)
11.	Qyteti mik i fëmijëve (financim)	Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël	Komuniteti i banorëve (target fëmijët)	200 000 000	Bashkia, FZHR Donatorë të huaj	m2	Bashkia, FZHR				Në këtë zë parashikohen rikonstruksione të qendrave ekzistuese kulturore ose ngritja e atyre të reja.
											Vlera e paraqitur parashikon ngritjen e 5 qendrave rekreative për fëmijë në Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIATI

PLANI I VEPRIMIT PROJEKTET E ZHVILLIMIT – BASHKIA KRUJË

Nr.	Titulli i Projektit	Territori që preket Njësitë Administrative	Grupet (komuniteti) që preken	Vlera e projektit (Lek)	Burimet e Financimit	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin e projektit	Fazat e zbatimit			Komente
Objektivi Strategjik I – INFRASTRUKTURË dhe LOGJISTIKË											
Programi Strategjik – Infrastruktura e territorit											
1.	Transformim i stacionit hekurudhor Budull	Bubq	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	78 000 000	Bashkia, FZHR Hekurudha shqiptare Donatorë të huaj	Nr. i pasagjerëve, rritja e aktivitetit social kulturor.	Bashkia, FZHR				Rekuperimi i ndërtesës dhe krijimi i hapësirave publike infrastrukturës ndihmëse dhe funksioneve dytësore.
2.	Rindërtim i Urës së Tubit	Nikël	Komuniteti vendor, Biznesi lokal	40 000 000	Bashkia, FZHR	Fluks lëvizjeje mjetesh	Bashkia, FZHR				Përfshin edhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore në të dy anët e urës.
3.	Rruga Prezë - Budull	Bubq	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	38 000 000	Bashkia Krujë dhe Vorë, FSHZH, Donatorë të huaj	Gjatësi rruge (km) Fluks lëvizjeje mjetesh dhe turistësh	Bashkitë, FZHR				Gjatësia e këtij aksi rrugor është.4km. Ky aks prek dy bashki dhe realizohet me bashkëfinancim. Vlera e paraqitur është vetëm për bashkinë Krujë. Vlera totale 80 000 000
4.	Lidhja Thumanë - Bubq	Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	1 850 000 000	Bashkia, FZHR, Donatorë të huaj	Fluks lëvizjeje, rritje prodhimi dhe rritja e shkëmbimit ekonomik	Bashkia, FZHR				Ndërtimi dhe rehabilitimi i një sistemi urash mbi Ishëm dhe lidhja me infrastrukturën rrugore. Ndërtimi mund të jetë me faza
5.	Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës	Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal	690 000 000	Bashkia, FZHR	Rritja e cilësisë së jetës dhe zhvillimi i biznesit	Bashkia, FZHR				Hapësira urbane, infrastruktura, shërbimet. Me faza.
6.	Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës	Fushë-Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal	1 450 000 000	Bashkia, FZHR	Rritja e cilësisë së jetës dhe zhvillimi i biznesit	Bashkia, FZHR				Hapësira urbane, infrastruktura, shërbimet. Me faza.
7.	Aksi i ri Thumanë - Tiranë	Thumanë, Bubq, Nikël	Operatorët e transportit kombëtar	8 400 000 000	FSHZH, MTI, koncesionar privat	Numri i mjeteve, rritja e shkëmbimit ekonomik, reduktimi i aksidenteve	FSHZH, koncesionar privat				Autostradë. Ky investim menaxhohet në nivel kombëtar.
8.	Rruga Krujë - Tiranë	Krujë, Nikël	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	240 000 000	FZHR, MTI Donatorë të huaj	Numri i turistëve, numri i bizneseve dhe punësimi	FZHR				Ky aks prek dy bashki dhe realizohet me bashkëfinancim. Vlera e paraqitur është vetëm për bashkinë Krujë. Vlera totale 480 000 000
9.	Sistemi i aeroportit "Nënë Tereza"	Nikël	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	950 000 000	Bashkia, FZHR, investime private	Rritja e punësimit, rritje e numrit të bizneseve	FZHR, investime private				Zonë ekonomike dhe shërbime.
10.	Lidhja e Bubqit me breggëtin	Bubq	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	160 000 000	Bashkia, FZHR	Numri i turistëve	Bashkia, FZHR				Ndërtimi i segmentit rrugor dhe urës mbi Ishëm. Projekte që ndërthuret me pikën I - 4 dhe II – 7 në këtë tabelë.
11.	Rruga lidhëse Krujë - Mamurras	Krujë	Komuniteti vendor	260 000 000	Bashkia, FZHR	Numri i mjeteve, rritja e shkëmbimit ekonomik	Bashkia, FZHR				
12.	Rruga Krujë - Burrel	Krujë, Cudhi	Komuniteti vendor	420 000 000	FSHZH, MTI, MZHETTS	Numri i turistëve	FSHZH				Investimi shtrihet thuajse tërësish në bashkinë Mat
Programi Strategjik – Infrastruktura e territorit											
13.	Pol logjistik i integruar në Fushë-Krujë	Fushë-Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal dhe rajonal	2 500 000 000	Bashkia, FSHZH, MTI, investime private, MZHETTS	Numri i turistëve, numri i mjeteve, kapaciteti i magazinimit.	Bashkia, FSHZH, investime private				Ndërtimi mund të jetë me faza
Objektivi Strategjik II – TURIZËM KULTUROR											
Programi Strategjik – Zhvillimi i ofertës											
1.	Kalaja e Krujës dhe Pazari i Vjetër	Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal,	190 000 000	Bashkia, MK, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i turistëve	Bashkia, FZHR				

				Turizmi								
	2.	Pika me interes religjioz dhe panoramik në Sarisalltik	Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	46 000 000	Bashkia, FZHR, Donatorë	Numri i turistëve	Bashkia, FZHR				Përfshin shtegun për ngjitjen në këmbë në Sarisalltik.
	3.	Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis)	Fushë-Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	133 000 000	Bashkia, MK, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i turistëve	Bashkia, FZHR				Krijimi i një infrastrukture që e kthen monumentin në atraktiv dhe të vizitueshëm.
	4.	Rikuperim i një guroreje të braktisur në Krastë	Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	370 000 000	Bashkia, MM, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i turistëve	Bashkia, FZHR				
	5.	Turizëm malor në Qafështamë	Cudhi	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	110 000 000	Bashkia, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i turistëve	Bashkia, FZHR				
	6.	Ujërat termale në Bilaj	Bubq	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	280 000 000	Bashkia, investime private	Numri i turistëve, kapaciteti akomodues	Bashkia, investime private				Rritje e kapaciteteve shfrytëzuese.
Programi Strategjik – Integrimi i ofertës												
	7.	Korridori i gjelbër Albanopolis – Lugina e Ishmit – Bregdet	Fushë-Krujë, Bubq, Thumanë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	222 000 000	Bashkia, MM, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i turistëve, numri i biçikletave	Bashkia, FZHR				Përfshin rrugën e biçikletave, infrastrukturë ndihmëse dhe ruajtje të mjedisit.
Objektivi Strategjik III – INOVACION PRODHIMI												
Programi Strategjik – Inovim i sistemit												
	1.	Inkubator ndërmarrjesh dhe shkollë profesionale	Fushë-Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal	400 000 000	Bashkia, MMSR, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i studentëve, numri i bizneseve	Bashkia, FZHR				
	2.	Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe shëndetit	Thumanë	Komuniteti vendor	48 000 000	Bashkia, MM, MSH, Donatorë të huaj	Të dhënat e shëndetit dhe cilësisë së ajrit	Bashkia				Stacion i monitorimit të cilësisë së ajrit dhe statistikash
Programi Strategjik – Inovim i produktit												
	3.	Ndërtimi i baxhove eksperimentale	Bubq, Thumanë, Nikël	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	170 000 000	Investime private	Rritja e prodhimit, rritja e numrit të bagëtive	Investime private				
	4.	Treg i produkteve lokale	Bubq / Fushë - Krujë	Komuniteti vendor, Biznesi lokal, Turizmi	42 000 000	Bashkia, investime private, FZHR, Donatorë të huaj	Numri i prodhuesve dhe tregtarëve	Bashkia, investime private, FZHR				Treg ku takohen direkt prodhuesi dhe konsumatori.

3.3 PROJEKTE ZHVILLIMI PILOT

3.3.1 Identifikimi dhe hartëzimi i projekteve

Ne këtë plan projektet strategjike janë ndare në dy kategori: projektet bazë dhe projektet e zhvillimit. "Projektet bazë" janë ato projekte te cilët janë te domosdoshëm për t'i krijuar sistemit lokal kushtet fillestare për zhvillimin e mëtejshëm dhe kane te bëjne me plotësimin e kushteve minimale për efiçencën e sistemit territorial. Nga ana tjetër, "projektet e zhvillimit" janë ato projekte te cilëve plani u ngarkon detyrën për dhënien e shkëndijës se pare te proceseve te zhvillimit te sistemit territorial dhe social-ekonomik.

Ne kategorinë e projekteve bazë hyjnë ato ndërhyrje te cilat duhet te jene pjesë e politikave rutinë te financimeve publike: pra bëhet fjale për projekte jo te jashtëzakonshme dhe realizimi i tyre duhet te bazohet në fondet e zakonshme te financimit nga ana e shtetit dhe bashkisë. Është e vështirë, si rrjedhoje e natyrës se tyre, qe këto projekte te mund te paraqiten e në harte apo te mund te përllogaritet vlera e tyre.

Projektet e zhvillimit, nga ana tjetër, janë ato te cilët kanë një përmbajtje me te forte strategjike: ato duhet te konsiderohen si ndërhyrje te "jashtëzakonshme" dhe, për këtë, duhet te mbështeten në politika "shtesë" te qeverise. Brenda kësaj kategorie projektesh duhet bërë një zgjedhje prioritetesh në mënyrë qe te mund te vazhdohet me programimin e investimeve te nevojshme.

Hartëzimi i projekteve te zhvillimit është me i lehtë dhe i realizueshëm, pasi shpeshherë bëhet fjale për ndërhyrje te lokalizuara, edhe pse në disa raste mund te parashikojnë ndërhyrje te shpërhapura qe nuk paraqiten dot në harte. Vendosja në harte e projekteve te zhvillimit, gjithsesi, duhet te konsiderohet thjesht si udhëzuese, duke qene se paraqesin një projekt qe është në nivelin e projektidesë, aq me tepër në një moment fillestar te fazes se konsultimit me entet lokale dhe mbajtësit e interesit (stakeholder). Një përkufizim me i përpikte i projekteve strategjike te zhvillimit do te jetë i mundur vetëm pas përcaktimit te prioriteteve te programimit.

Për sa me sipër, paraqitja e një vlerësimi paraprak te prioriteteve teknike në zbatimin e projekte bëhet nëpërmjet ndarjes se projekteve te zhvillimit në tre fasha kohore:

- Projekte të realizueshme në një periudhe kohore te shkurtër (afat-shkurtër)

- Projekte të realizueshme në një periudhe kohore te mesme (afat-mesëm)

- Projekte të realizueshme në një periudhe kohore te gjatë (afat-gjatë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Periudha "afat-shkurtër" nënkupton nga 1 deri në 5 vite, "afat-mesëm" nga 6 nga në 10 vite dhe "afat-gjatë" me shumë se 10 vite.

Kriteret për klasifikimin e projekteve në fashën afat-shkurtër janë:

- Mundësia e ndërhyrjes se menjëhershme (disponimi i tokës, disponimi i teknologjive, qartësia e procedurave etj.);

- Disponimi ose mundësia e gjetjes se shpejte te resurseve financiare (te cilat mund te jene si publike ashtu edhe private)

- Mos-ekzistenca e kundërshtive ose arritja i shpejte e konsensusit (pra, përjashtohen te gjitha projektet për te cilat mbajtësit e interesit (stakeholders) kanë kundërshti ose opinione te ndryshme)

Projekteve te zhvillimit afatshkurtër mund edhe t'iu jepet roli i "projekteve pilot" (përveç rolit "prioritar"). Në këtë rast bëhet fjalë për projekte qe parashikojnë ndërhyrje shembullore qe kanë për qellim promovimin e idesë se zhvillimit: projekte qe janë te afta te tregojnë në mënyrë te komunikueshme dhe bindëse efektin virtuoz te projekteve te zhvillimit.

3.3.2 Skedat e projekteve

Mbështetur në kategorizimin e bërë më sipër, në vijim përshkruhen shkurtimisht në trajtë skedash projektet strategjike Bazë, të Zhvillimit (aftmesëm dhe afatgjatë) dhe ato Pilot.



Fig. 64 Identifikimi dhe hartëzimi i projekteve

3.3.2.1 Skedat e projekteve



PP 31 | **I+L**

Transformim i stacionit hekurudhor në Budull

Rehabilitimi dhe transformimi i Stacionit Hekurudhor Budull në nyje rigjallërimi të fshatit.

Rekuperimi i stacionit hekurudhore në Budull mund të shërbejë si mjet për gjallërimin e jetës dhe aktiviteteve social-kulturore në njësinë administrative të Bubqit. Në këtë këndvështrim ky stacion, së bashku me atë të Ishmit kthehen jo vetëm në pika aksesi për transportin hekurudhor, por edhe në referenca urbane që gjenerojnë aktivitet dhe mundësojnë zhvillimin e qendrave me shërbime urbane.



Përshkrimi i projektit

Rimëkëmbja dhe zhvillimi i transportit hekurudhor, për përdorim urban dhe kombëtar, kalon gjithashtu nëpër rehabilitimin e stacioneve hekurudhore, të cilat mund të bëhen pjesë e një sistemi të ri të objekteve të vogla urbane, në shkallë lokale, në kuadër të programit të riorganizimit të objekteve publike dhe shërbimeve private të parashikuara në Planin e Përgjithshëm (projektet bazë).

Hekurudha kombëtare është sot në një gjendje të rëndë braktisjeje, dhe ofron një shërbim shumë të kufizuar në krahasim me potencialin e saj të vërtetë. Edhe stacionet hekurudhore vuajnë të njëjtin gjendje neglizhence dhe mos-shfrytëzimi. Pozicioni i tyre është gjithashtu i mundshëm për tu rishikuar. Në territorin e Bashkisë Krujë kemi dy stacione hekurudhore që gjenden në njësinë administrative Bubq, Stacioni Budull dhe Stacioni Ishëm. Është menduar një mundësi e rishikimit të Stacionit të Ishmit, për ta spostuar në afërsi të fshatit Gramëz, hipotezë që ende ka nevojë për hulumtim të mëtejshëm, që të jetë edhe në përputhje me strategjinë kombëtare të infrastrukturës. Kjo hipotezë është ngritur për shkak të vizionit të bashkisë, në lidhje me strategjinë territoriale të "korridoreve portokalli "- struktura që kanë tendencë për të forcuar më tepër strukturën urbane të zonës, duke densifikuar në këtë drejtim facilitetet, shërbimet dhe qendërzimet e reja, dhe të "korridoreve të gjelbër" - struktura territoriale të planifikuara për të balancuar marrëdhëniet ekologjike dhe mjedisore të integruara me linjat e lëvizjes së ngadaltë (rrugë biçikletash, këmbësore).

Stacionet ekzistuese në Bubq nuk lidhen me asnjë nga korridoret e lart përmendur, megjithatë përbëjnë një mundësi interesante për ripërdorimin dhe renovimin e infrastrukturës ekzistuese, në pronësi të shtetit. Nga kjo pikëpamje Stacioni Budull është parë si shumë i përshtatshëm dhe i mundshëm për tu konsideruar si projekt pilot, pra projekt që mund të realizohet në kohë të shkurtër, me pak kosto financiare, dhe me impakt të madh në komunitet, që lidhet ngushtë me impaktin total që ka për qëllim të arrijë strategjia gjithë përfshirëse, që realizohet nga objektivat e strategjisë së përgjithshme territoriale, në lidhje me të gjitha sistemet, e sidomos infrastrukturës, për rastin në fjalë.

Veprimi i parë i projektit është rehabilitimi dhe integrimi i stacionit ekzistues me hapësira të reja dhe facilitete publike, në kuadër të objektivit të projektit për të krijuar një farë qendërsie urbane rrotull stacionit, për rigjallërimin e jetës sociale komunitare të banorëve të fshatit Budull.

Një ndërhyrje e tillë duhet të synojë drejt një strukture të qëndrueshme nga pikpamja e shfrytëzimit të energjisë, gjë e cila realizohet përmes pajisjes me panele fotovoltaike në mbulesën e objektit dhe në strehat e reja që parashikohet t'i shtohen objektit, për mbrojtjen e pasagjerëve.

Projekti parashikon edhe krijimin e disa hapësirave polifunksionale dhe shërbimi në një fazë të dytë që do ta kthejnë stacionin në pikë interesi për fshatin Budull dhe për gjithë njësinë administrative Bubq.

Meqë rrjeti hekurudhor pritet që shumë shpejt të jetë aktiv dhe të ripërdoret, projekti parashikon edhe realizimin e nje mbikalimi për këmbësorët.

Komponenti i faciliteteve dhe shërbimeve plotësuese të lëvizjes së qëndrueshme, përfshin sigurimin me zona të vogla të pushimit/parkimit të kryqëzimit të lëvizjes drejt qendrave të tjera.

Grupet e interesit

Aktorët publikë: Bashkia Krujë, Hekurudha Shqiptare

Aktorët privatë: Ndërmarrje private aktive në sektorin e kulturës dhe turizmit

Agjensitë e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PP 32 | **TK**

Rikuperim i një guroreje të braktisur në Krastë

Projekt shembull për rikuperimin e një guroreje të braktisur në zonën e Krastës me qëllim që të tregohet se është i mundur eliminimi i një elementi shqetësues për peizazhin dhe gjetja e një funksioni të ri.

Projekti ka për qëllim rikuperimin, në kuptimin ambiental, të një prej guroreve të braktisura në zonën e kodrave të Krastës, e propozuar nga Strategjia Territoriale për mbrojtje, si Park Rajonal Natyror. Ky projekt do të shërbejë si shembull për rikuperimin e guroreve të tjera që janë të shpërndara nëpër të gjithë kodrën.

Nevoja dhe urgjenca e kësaj ndërhyrje lind edhe për shkak të efektit të degradimit të shkaktuar nga prania e këtyre guroreve në rrugën e hyrjes për në qytetin e Krujës. Ky është një peizazh që meriton të sillet në cilësinë e tij të mëparshëm, i cili lidhet edhe me rritjen e propozuar të qendrës historike (Pazari i Vjetër dhe Kalaja), e përmendur në PPV si një nga projektet strategjike, që nga ana tjetër është i lidhur edhe me programin e zhvillimit të zonës arkeologjike Albanopolis, që ndodhet një distancë të shkurtër nga zona e ndërhyrjes së këtij projekti.

Kushtet e domosdoshme për zhvillimin e një projekti të tillë, janë disa; së pari eshte konfirmimi që aktiviteti i nxjerrjes minerare në zonën në studim të ketë përfunduar, pra të jemi të sigurt që është një gurore e braktisur. Së dyti, duhet të jetë një zonë që ka prishur peizazhin natyror, që ka deformuar vijën peizazhistike vizuale dhe shfrytëzimin e mirë të tij, bazë kryesore kjo për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë lokale.

Identifikimi i sitit, zgjedhja e teknologjive dhe metodave të kultivimit dhe projektimit të rimëkëmbjes së mjedisit do të trajtohen në mënyrë të integruar në fazat e planifikimit dhe projektimit.

Identifikimi i zonës së projektit pilot, do të marrë në konsideratë faktorë të tillë si: ndikimi mjedisor, koherenca me instrumentet ekzistuese të planifikimit, pëlqimi (nëpërmjet një fushate informimi) nga komuniteti lokal.

Projekti synon të rindërtojë vazhdimësinë e peizazhit, nëpërmjet ri-natyralizimit të zonës së nxjerrjes minerare, nëpërmjet mbjelljes së llojeve të ndryshme të drurëve që përputhen me ekosistemin lokal dhe nëpërmjet ripërdorimit të pjesshëm të zonave dhe objekteve ekzistuese, për të mbështetur aktivitetet e turizmit mjedisor, kulturor dhe natyror. Këto ndërhyrje kanë për qëllim që të jenë në përputhje me synimet e rehabilitimit mjedisor, duke studiuar metodat dhe mjetet e gërmimit në funksion të ndërhyrjeve në të ardhmen për risistemimin dhe rimëkëmbjen e mjedisit. Ky është një ndër qëllimet më kryesore të strategjisë, prandaj është në qender të interesit që ne fillimet e projektimit te saj.

Për te kufizuar ndikimin ne peizazh parashikohet që: t'i jepet përparësi metodave te kultivimit nga lart - poshtë, ne mënyrë te tillë qe te vazhdohet me kantiere "te mbrojtur", duke lene një kreshte te përkohshme te shkëmbit ne vend; te parashikohen zgjidhje qe minimizojne impaktin morfologjik te gërmimeve dhe mbushjeve me dhe' ne kontekstin ekzistues territorial; te ndërpritet rregullsia gjeometrike horizontale e shkallareve qe jane krijuar nga gërryerjet, duke bere lidhjen e tyre nepermjet rampave te mbivendosura ne nivele te ndryshme; te eliminoje "shkallaren" e panatyrshme vertikale te krijuar nga nivelet e ndryshme, duke realizuar p.sh. nje alternim te planeve te pjerrëta me vegjetacion dhe me mure te çregullt qe mund te kthehen ne mjedis natyror, ne varesi te kërkesave te stabilitetit te shpateve.

Ne përfundim te fazës se ri-natyralizimit, parashikohet rivendosja e qëndrueshmërisë së ish-zonës se gërmuar, përmes krijimit te rrugëve te brendshme te lidhen me ato ekzistuese, por edhe nëpërmjet krijimit te një sistemi te ri shtigjesh, te pajisur me zona pushimi.

Përshkrimi dhe struktura e projektit

Projekti lidhet me korridorin e gjelbër/rrugë bicikletash e këmbësorësh ndërmjet Krujës dhe bregdetit veçanti, gurorja e braktisur e përzgjedhur, është sfondi i vetëm peizazhistik që ka ky korridor ne segmentin nga Albanopolis deri ne Fshat Fushë-Krujë.

Komponenti mjedisor i projektit ka te bëjë me rehabilitimin e vazhdimësisë ekologjike dhe vizuale tipike te sistemit te mjedisit te kodrave te mbrojtura te Krastës, ku këto gurore përbëjnë një ndërprerje te papritur. Projekti i rekuperimit ka për qëllim te krijojë një mjedis te ri me karakteristika te ngjashme me ato te zonave përreth që nuk janë ndikuar nga minierat, përmes një rimodelimi natyror te sitit dhe përmes rritjes se vlerave te biodiversitetit te pranishëm ne zonën e mbrojtur.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË

Tërësia e ndikimeve, në komponentët e listuara, do të konsiderohen me kujdes në drejtim të efekteve të tyre mbi biodiversitetin, florën, faunën dhe ekosistemet e pranishme në ish zonën e nxjerrjes së minerareve dhe në afërsi të saj. Në përgjithësi, për të kufizuar ndikimin në florën dhe faunën e pranishme, do të vlerësohen:

- Ndërhyrjet që zvogëlojnë në mënyrë të përhershme trashëgiminë pyjore ekzistuese;

- Ndryshimet e strukturës së mozaikëve mjedisorë ekzistues dhe ndryshimi i funksionimit të tyre;

- Ndërtimi i rrugëve të reja, realizimi i të cilave duhet bërë me gjurmë sa më minimale;

- Dëmet e mundshme të burimeve të ekosistemit me vlerë faune;

- Ndërhyrja e mundshme me korridoret ekologjike dhe ndryshimi i elementeve të tjera të rrjetit ekologjik;

- Rreziku i ndryshimit të habitatit;

- Ndryshimi i strukturave të rëndësishme për migrimin dhe flukset biotike;

- Masat e përshtatshme kompensuese, në rast se nuk është e mundur zbutja e ndikimeve.

Ndërhyrjet e rehabilitimit të vazhdimësisë së ekosistemit të Kodrave të Krastës, do të synojnë riformulimin e zonës dhe integrimin e saj në kontekstin mjedisor nëpërmjet përdorimit të bimësisë vendore dhe terrenit natyror. Për më tepër, ballinat e gërmimeve do të riorganizohen për të krijuar hapësira më të përshtatshme për rritjen e specieve bimore që do të përdoren për ri-gjelbërimin e zonës. Do të realizohen përforcime (skarpata) me pjerrësi të vogël (në të cilat do mund të vendoset dhe të mbahet një shtresë toke e punueshme) dhe është i mundur edhe alternimi me zonat alternative ku shkëmbi lihet i dalë me relieve të theksuara. Së fundmi, këto ndërhyrje përfshijnë ndërtimin e shkallareve me pjerrësi të tillë që të mund të mbajnë tokë të punueshme të mjaftueshme për të siguruar një shpat të gjelbëruar, pa i shtuar peshë konstruktive që mund të sjelli rrezik në qëndrueshmëri.

Faza finale do të siguroje sistemimin e zonës me rruge hyrëse, me shtigje natyrore të brendshme, me sheshe të vogla pritëse dhe me pika të ndryshme për vrojtimin natyror e panoramik.

Grupet e interesit

Aktorët publikë: Bashkia Krujë, Ministria e Mjedisit

Aktorët privatë: Ndërmarrje bujqësore, prodhues vendorë, ndërmarrje private aktive në sektorin e turizmit

Aktorët të Sektorit të Tretë: Shoqata kulturore, shoqata mjedisi, WWF (World Wide Fund for Nature)

Agjensitë e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Rezultatet e parashikuara

- Ri-natyralizimi i gurores së braktisur

- Lidhja e ekosistemit të Kodrave të Krastës

- Rritja e biodiversitetit

- Zhvillimi i aktivitetit turistik komplementar me sitin në fjalë

- Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe aksesit në zonat me trashëgimi natyrore

- Rritje e ofertës turistike

- Shtim i vendeve të punës

Periudha kohore e zbatimit

Parashikohet një projekt i artikuluar përgjatë pesë viteve te ardhshme, në varësi të resurseve që do vihen në dispozicion nga Bashkia dhe Ministritë përkatëse.

Burimet kryesore të financimit të mundshëm: *Qeveri, bashki, donacione, fonde evropiane zhvillimi etj.*

Burimet sekondare të financimit të mundshëm: *Bashkim ndërmarrjesh private, përfituese të mundshme te projektit.*



30. Rikuperim i guroreve të braktisura në Krastë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PP 33 | TK

Korridori i gjelbër Albanopolis - Lugina e Ishmit - Bregdet

Projekti buron nga ideja e krijimit të një rruge për zbulimin dhe njohjen e burimeve arkeologjike, kulturore, natyrore dhe peizazhistike, që karakterizojnë territorin e Bashkisë, sipas propozimit të paraqitur për Korridorin e Gjelbër Cv.2, nga vizioni udhëheqës.



Përshkrimi i projektit

Funksioni i këtij korridori është që të nxisë lidhjen ekologjike ndërmjet zonave bregdetare dhe atyre të brendshme malore, duke përdorur një pjesë të rrjeteve ekzistuese hidrografike natyrore dhe artificiale, duke e shoqëruar këtë funksion kryesor me ndërtimin e një itenerari të lëvizjes së qëndrueshme, të avashtë, për përdorim kryesisht çiklist e këmbësor, dhe me qasje në destinacionet kryesore turistike të zonës. Ky korridor është elementi kryesor i lidhjes ekologjike mes kodrave të Krastës - për të cilat Strategjia Territoriale parashikon mbrojtje duke e propozuar si Park Natyror Rajonal - dhe Luginës së Ishmit, në njësinë administrative Bubq, duke vazhduar në zonat e mbojtura bregdetare në veri të Kepit të Rodonit, pjesë e Lagunës së Patokut, në komunën e Kurbin. Ky korridor, idealisht, vazhdon si një korridor i lëvizshmërisë ngadalë edhe përtej kufijve vendorë të Krujës, në Kep të Rodonit, sipas një rruge, pjesërisht në shpatet kodrinore.

Projekti përbëhet nga ndërhyrje në infrastrukturë, në gjelbërim dhe në sipërfaqet bimore të zonave të kufirit vendor, në sistemim dhe mirëmbajtje të veçantë të rrjedhave ujore, si dhe në vendosjen e strukturave mbështetëse për turizmin kulturor dhe mjedisor.

Boshti themelor i strukturës së projektit përbëhet nga një rrugë e vazhdueshme çiklistike e këmbësore, e ndërtuar pjesërisht në shtigjet ekzistuese (kryesisht rrugët lokale, ose ato në shërbim të vendbanimeve të vogla), pjesërisht për ri-përdorimin e gjurmës hekurudhore jashtë përdorimi (linja hekurudhore sekondare Budull – Fushë-Krujë/ fabrikë e çimentos), pjesërisht në gjurmë të konsoliduar, në rrugët e reja të ndërtuara, si dhe pjesërisht nëpër argjinaturat e rindërtuara të lumenjve (Lumi Ishëm dhe degët e tij).

Ky korridor, me shtrirje të gjatë, lidhet me përmirësimin e linjës hekurudhore kombëtare, që kryqëzohet me korridorin në mesin e gjatësisë së tij, në fshatin Gramëz. Hipoteza është që rruga çiklistike det – mal, të jetë e lidhur me përdorimin e hekurudhës duke zhvilluar kështu mënyra të integruara të lëvizjes së qëndrueshme tren – biçikletë, siç janë realizuar në shumë kontekste evropiane.

Projekti favorizon, në fshatrat e vegjël që përshkohen nga ky korridor i gjelbër, zhvillimin e aktiviteteve të vogla të llojit agroturistik të lidhura me ofertën e "priljes së vogël" (Bed&Breakfast, ferma bujqësore didaktike, tregje të prodhimeve bujqësore lokale).

Për sa i takon komponentit të infrastrukturës, korridori i gjelbër / rrugë çiklo-këmbësore është i ndarë në dhjetë pjesë të dallueshme kryesore, i shoqëruar edhe nga gjashtë rrugë dytësore që lidhin zonën e kodrave të Krastës, fshatin Luz, qendrën e Ujrave Termale në Bilaj, qendrën bujqësore Adriatik (Bashkia Kurbin), drejt stacionit bregdetar ekologjik në Fushë Kuqe (Bashkia Kurbin), në Kep të Rodonit dhe në Manastirin e Shën Antonit (qyteti i Durrësit), sipas të dhënave përmbledhëse të raportuara më poshtë.

Komponenti mjedisor i projektit përmban veprime të mëdha mirëmbajtje dhe ri-natyralizimi të rrjedhave ujore që shoqërohen nga ky korridor, gjë e cila sigurohet në përputhje me efiçiencën hidraulike dhe përmirësimin e funksioneve ekologjike të caktuara, së bashku me veprimet e mbjelljes së pemëve të reja për arredim urban dhe për mbrojtjen e korridorit të propozuar.

Komponenti i faciliteteve dhe shërbimeve plotësuese të lëvizjes së qëndrueshme përfshin lidhjen e këtij korridori me stacionin ekzistues të Ishmit, me përgatitjen e disa zonave të vogla për ndalim/parkim dhe për shkëmbim afër qendrave të mëdha; krijimi i hapësirave të vogla publike komunitare gjatë këtij itinerari, madje edhe si zona të pushimit me facilitete; krijimi i pikave natyrore për aktivitet Birdwatching ; organizimi i sinjalistikës në mbështetje të rrugës së çiklo-këmbësore dhe të pikave të interesit kulturor dhe natyror ku ky itinerar kalon; vepra ndihmëse për shërbim të kësaj rruge (çezma/burime me ujë të pijshëm, kioska, zgarë parkimi biçikletash, etj.); organizimi i një portali web për të mbështetur aktivitetet ekonomike dhe bizneset që prek ky itinerar.

AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË QYTETIT TIRANË SEKRETARIA

me fokus të veçantë te ndërmarrjet e sektorit bujqësor vendor, te fermat agroturistike dhe te banesat lokale të pritjes turistike (Bed & Breakfast, hotele dhe hostele për të rinjtë).

Grupet e interesit

Aktorët publikë: Bashkia Krujë, Hekurudha Shqiptare

Aktorët privatë: Ndërmarrje bujqësore, prodhuesit vendorë, Llixhat Bilaj

Aktorët të Sektorit të Tretë: Shoqata çiklistike, shoqata sportive, shoqata ambientaliste, WWF (World Wide Fund for Nature)

Agjensitë e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Rezultatet e parashikuara

- Progresi ekologjik në drejtim të përmirësimit të biodiversitetit

- Përmirësimi i përgjithshme i cilësisë së jetës së qytetarëve

- Zhvillimi i aktiviteteve plotësuese turistike në shërbim të aktivitete bujqësore të zonës

- Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe aksesit ndaj të mirave të përbashkëta të territorit

Periudha kohore e zbatimit

Për këtë itinerar, parashikohet një realizim me faza, lidhur me krijimin e Parkut Arkeologjik të Albanopolisit (Zgërdhesh) dhe lidhjen e këtij korridori me stacionin ekzistues të Ishmit, në harkun kohor të tre viteve të ardhshme.

Fazat e projektit

Faza e parë (viti 2016-2017): realizimi i gjurmëve fillestare PP1_PP2, deri te PP5, Fushë-Krujë – Zgërdhesh, lidhur me realizimin e Parkut Arkeologjik të Albanopolisit (Zgërdhesh).

Burimet kryesore të financimit të mundshëm: *Qeveria shqiptare, bashkia Krujë, donacione, fonde evropiane zhvillimi etj.*

Burimet sekondare të financimit të mundshëm: *Bashkim ndërmarrjesh private (si p.sh. Llixhat në Bilaj), përfituese të mundshme të projektit.*

KATEGORIA E PUNIMEVE	SEGMENTI	Njësia matëse
Ndërhyrje të karakterit infrastrukturor		
a. Rrugë biçikletash me gjurmë Parku Arkeologjik i Albanopolisit – Halil – kryqëzimi i rrugës kombëtare për Krujë (itinerar i përzier, në rrugë ekzistuese)	PP1-PP2	1,56 Km / Disnivel: 55,4 m / Pjerrësi mesatare: 4,7%
b. Rrugë biçikletash me gjurmë rruga kombetare – Fshat Fushë Krujë, gjurmë e re	PP2-PP3	2,25 Km / Disnivel: 84,9 m / Pjerrësi mesatare: 4,7%
c. Rrugë biçikletash me gjurmë Fshat Fushë Krujë - hekurudhë	PP4-PP3-PP5	0,63 Km
d. Rrugë biçikletash me gjurmë pjesën hekurudhore që shkon te fabrika e çimentos	PP4-PP5	2,0 km / Disnivel: 20,5 m / Pjerrësi mesatare: 1,4%
e. Rrugë biçikletash me gjurmë të re përgjatë rrjedhës së lumit Zezë dhe Ishëm	PP5-PP6	6,0 Km / Disnivel: 37,5 m / Pjerrësi mesatare: 5%
f.1 Rrugë biçikletash lidhëse me Gramzën, në rrugët ekzistuese	-	1,11 Km
f.2 Rrugë biçikletash lidhëse me llixhat në Bilaj e fshatin Luz 2, në rrugë ekzistuese	-	2,0 Km
g. Rrugë biçikletash në rrugë ekzistuese ndërmjet Gramzës dhe rrjedhës së Ishmit	PP6-PP7	5,31 Km
h. Rrugë biçikletash në rrugë rurale ekzistuese përgjatë bregut të djathtë të lumit Ishëm	PP7-PP8	5,30 km
i. Segmenti përfundimtar	PP8-PP9	2,28 km
Shumatorja e rrugëve të biçikletave me segment të ri		13.16 km
Shumatorja e rrugëve të biçikletave me segment në rrugë ekzistuese		15.28 km
Lidhja e korridorit me stacionin ekzistues të Ishmit		2.3 km
Rehabilitimi i ndërtesës së stacionit të Ishmit		copë 1
Zona të vogla për ndalim/parkim dhe për shkëmbim, afër qendrave të mëdha		copë. 10
Hapësira të vogla publike komunitare gjatë itinerarit, edhe si hapësira facilitetesh		copë. 10
Pika natyrore për Birdwatching		copë. 5
Sinjalistikë në mbështetje të rrugës çiklo-këmbësore dhe të pikave të interesit kulturor (nga dy, në çdo kryqëzim me shikueshmëri të madhe)		E përfunduar, copë. Një tabela sinjalistike çdo km të rrugës
Vepra ndihmëse për shërbim të rrugës (çezma/burime me ujë të pijshëm, kioska, zgarë parkimi biçikletash, etj.);		copë. 20
Portal web për të mbështetur aktivitetet ekonomike dhe bizneset që prek ky itinerar, me fokus të veçantë te ndërmarrjet e sektorit bujqësor vendor		copë.1 e përfunduar
Kosto projektimi dhe konsulence teknike		10% e punimeve totale
Përgatitja e një rregulloreje për menaxhimin me pjesëmarrje të Trashëgimisë		E përfunduar
Kosto të tjera financiare		Për tu verifikuar në bazë të ligjeve kombëtare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



PP 34	TK

Kalaja e Zgërdheshit (Albanopolis)

Projekt i integruar për promovimin e vlerave të Kalasë së Zgërdheshit, për qëllime turistike, objekt me interes si kulturor dhe arkeologjik.

Fshati Zgërdhesh mendohet se ka qenë Albanopolisi i përmendur nga Ptolemeu në shekullin II të erës sonë. Prej këtej mendohet që trashëgohet emri i sotëm për Shqipërinë "Albania". Me braktisjen e tij në fillim të Mesjetës banorët gjetën një vend më të mbrojtur në Krujë ndaj me kalimin e kohës qyteti mori rëndësi për gjithë krahinën. Sot, Albanopolis ka vetëm gjurmët murale të dikurshme. Projekti buron nga dëshira për ta vendosur në vëmendje këtë sit arkeologjik historik, për t'u kujdesur për të e për ta rivlerësuar si një nga asetet historiko-kulturore të Bashkisë Krujë.

Objektivat e Projektit

Projekti ka për qëllim rizbulimin e sitit arkeologjik të Albanopolisit, në funksion të njohjes së identitetit dhe vlerave të tij kulturore, sidomos nga ana e komunitetit lokal, duke e hapur atë në rrjetet vendore dhe ndërkombëtare të turizmit kulturor dhe mjedisor. Gjithashtu ky projekt ka për qëllim, të nxisë një proces progresiv të identifikimit dhe ndjenjës së përkatësisë së trashëgimisë lokale, si bazë për përfshirjen e aktorëve lokalë ndaj ndërhyrjeve për kujdesin dhe mbrojtjen aktive të një siti me vlerë të pamohueshme arkeologjike dhe kulturore, duke synuar krijimi i një Parku Arkeologjik të Integruar, pjesë e Zonës së Mbrojtur të Kodrave të Krastës, siç është parashikuar nga Strategjia e Planit të Përgjithshëm Vendor. Nga ky këndvështrim, çështja merr karakter paradigmatik, pikërisht për shkak të përsëritjes së rasteve të shumta me situatën në shqyrtim, e cila gjen shumë ngjashmëri me kontekste të ndryshme në vend.

Projekti kështu, fiton karakterin e projektit pilot, për shkak se ai mund të përbëjë një rast interesant referimi për të dhënë zgjidhje ndaj zbulimeve arkeologjike dhe kulturën lokale të vendit, të cilat ende i nënshtrohen prishjes dhe neglizhencës, në një situatë të mungesës së burimeve publike dhe efikasitetit të ulët dhe efektivitetit të institucioneve përkatëse të kontrollit dhe të mbrojtjes. Për këtë arsye duhet provuar hipoteza e praktikave të reja të shoqërisë civile aktive, pjesë e banorëve lokalë, të cilave mund t'i caktohet, në bashkëpunim me strukturat e këtij sektori, roli i ri i "qytetarëve aktive ruajtës së trashëgimisë lokale".

Për këtë arsye, projekti merr një qasje prioritare për ndërtimin e tij, që do të zhvillohet nëpërmjet krijimit të komisioneve dhe strukturave të pjesëmarrjes, të hapura për kontributin e palëve të interesuara lokale.

Historiku

Qyteti i lashtë është ndërtuar në afërsi të Krujës, në pikën e bashkimit midis fushave perëndimore dhe sistemit kodrinoro-malor. Para mbërritjes në Zgërdhesh, duke ardhur nga perëndimi, kalojmë nëpër fusha pjellore, të ndara vetëm nga kodra të ulta; në lindje, ato ngrihen me me malin e Skënderbeut. Nga ky vend pastaj, nisen edhe dy rrugë kryesore: një në drejtim të Tiranës, të tjera në drejtim të Burrelit dhe Dibrës.

Siti u zhvillua në sajë të pranisë së një zone të madhe bujqësore, dhe për shkak të mundësisë që këto zona

SHQIPËRISË
LIMIT TE TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

kishin për rritjen blegtorale. Qyteti u ndërtua kështu, mbi një pllajë të formë afërsisht trekëndëshi, me pjerrësi zbritëse drejt fushave bujqësore.

Zhvillimi i qendrës së lashtë urbane Albanopolis nuk ka ndodhur nëpërmjet një planifikimi paraprak, prandaj ajo shoqërohet me rrugë të gjata dhe të parregullta, të cilat ndjekin terrenin dhe izohipset e zonës.

Shtrirja e mureve të qytetit - të gjetura deri më sot, si dhe zbulimi i fragmenteve arkitektonike dhe skulpturore që mund të lidhen me një ndërtesë kulti (blloqe të gjetura tra-kolonë, statuja e Artemisës, etj.) tregojnë se qyteti, në shekullin e II p.e.s., është zgjeruar jashtë mureve mbrojtëse të kështjellës së qytetit, në një zonë ku janë gjetur dhe varre të vjetër.

Pas një periudhe lulëzimi gjatë shek. të II p.e.s. – shek. II, Albanopolis, pas pushtimit romak, pësoi një periudhë rënie, e cila gjithashtu kulmoi me humbjen e funksionit të saj si një mburojë e territorit përreth. Megjithatë, gjatë gërmimeve, është zbuluar një varrezë, e cila tregon se ai ka qenë qytet aktiv deri në shek. e IV.

Përmbajtja e projektit

Në radhë të parë, projekti propozon krijimin e një itinerari fillestar për të vizituar brendësinë e sitit, të pajisur edhe me facilitetet e shërbimet përkatëse.

Projekti, gjithashtu, ka për qëllim të mundësojë që në të ardhmen të kryhen gërmime të mëtejshme, me qëllim që të rritet shkalla e njohurive në lidhje me origjinën dhe zhvillimin e qytetit të Albanopolis. Kjo pasohet natyrisht nga një rritje lokale e ofertës turistike, e cila do të japë, në sektorin jug-lindje të Krujës, një rrjedhë më të madhe të vizitorëve. Këta të fundit, gjithashtu, mund të përfitojnë dhe shfrytëzimin e një prej korridoreve të gjelbër të zonës, pikërisht atë që merr nisje nga Albanopolis, që vazhdon përgjatë territorit të bashkisë nëpër kodra, nëpër fshatra, rrugë ekzistuese, anash rrugëve hekurudhore, nëpër luginat e lumenjve dhe fushave bujqësore, për të përfunduar pastaj në bregdetin Adriatik mbi Kepin e Rodonit. Qëllimi i këtij korridori është realizimi i një rruge të vetme kulturore dhe mjedisore për turizëm lokal dhe rajonal, i cili lidhet me Projektin Pilot të Parkut Arkeologjik, më së miri, duke e rritur vlerën e tij dhe duke e vënë në qendër të vëmendjes.

Së fundmi, projekti nxit zhvillimin e aktiviteteve të vogla të mikpritjes e agroturizmit, në fshatrat afër zonës arkeologjike. Rruga që çon në Albanopolis, kalon nëpër fshatin Halil të Fushë-Krujës, fshat tejet i bukur e karakteristik i zonës, i cili mund të klhehet në një nga fshatrat më mirëpritës tradicionalë.

Përshkrimi dhe struktura e projektit

Siç u përmend edhe më lart, projekti është në logjikën e investimit me bashkëpunim të shoqërive civile dhe atyre kulturore si dhe të palëve të interesuara, dhe shoqërohet që nga akti i tij fillestar, nga një program që synon të përfshijë banorët dhe palët e interesuara në kontekstin e përkatësisë, në procesin e ndërhyrjes dhe ndërtimin e parkut të ardhshëm arkeologjik.

Faza fillestare e projektit ka të bëjë me realizimin e një studimi paraprak të analizës së vlerës së zonës, gjendjen e përdorimit, aksesibilitetin dhe përkatësinë e zonës arkeologjike, nëpërmjet vlerësimit të sitit.

Sa i përket komponentit të infrastrukturës, projekti lidhet me Korridorin e Gjelbër, Projekti Pilot PP1, i cili është ndarë në disa seksione të veçanta, ku seksioni i parë i këtij itinerari i takon zonës në fjalë. Prandaj seksioni i rrugës hyrëse në këtë sit arkeologjik është trajtuar në PP1. Ndërkohë që i takon projektit në fjalë, të trajtojë pjesën e infrastrukturës lidhëse me korridorin e gjelbër, si dhe të asaj të rrugëve të brendshme për vizitimin e zonës arkeologjike dhe të ndërhyrjeve të shërbimit të nevojshëm, që vijnë edhe si pasojë e terrenit kodrinor që e karakterizon sitin.

Komponenti mjedisor i projektit, ka të bëjë me veprimet lokale të mirëmbajtjes së ekosistemit lokal, tipik i zonës së mbrojtur të Kodrave të Krastës, brenda të cilit shtrihet siti ynë arkeologjik. Këtyre ju shtohen ndërhyrjet e mbjelljeve të pemëve të reja (të cilat do luajnë dhe rolin e mbrojtjes së strukturave arkeologjike nga erërat dhe nga ndërtimet ekzistuese që nuk rrinë mirë me peizazhin arkeologjiko-historik), si dhe ndërhyrjet për sistemimin dhe mbrojtjen e sitit arkeologjik dhe të rrugës së biçikletave të propozuar.

Komponenti i faciliteteve dhe shërbimeve plotësuese të lëvizjes së qëndrueshme, përfshin rritjen e lidhjeve me zonat fqinje, qendrën e Krujës dhe Fushë-Krujës, sidomos nëpërmjet zbatimit të linjave të transportit publik rrugor (autobus) dhe krijimin e rrugës së biçikletave të përmendur më lart. Përgjatë gjurmës së kësaj të fundit, është i mundur parashikimi i hapësirave të vogla komunitare, të projektuara madje edhe si zona pushimi të këtij itinerari; realizimi i pikave natyrore të ndalimit e vrojtimit, organizimi i sinjalistikës së rrugës për shërbim të korridorit dhe të pikave kulturore e natyrore; vepra shtesë në rrugën e shërbimit (burime të ujit të pijshëm, kioska, zgara parkimi biçikletash, etj.); organizimi i një portali web, për të mbështetur aktivitetet ekonomike dhe bizneset që kanë aktivitet të lidhur me këtë itinerar, me fokus te kompanitë e sektorit të bujqësisë organike lokale, te fermat dhe strukturat hoteliere lokale (Bed&Breakfast, hostele dhe shtëpi pritjeje).

I lidhur ngushtë me jetën dhe përdorueshmërinë e sitit arkeologjik, është realizimi i një perimetri mbrojtës së mureve antike; krijimi i një shërbimi stabël të ruajtjes së përditshme të vendit, që mund të realizohet edhe në bashkëpunim me komunitetin lokal; krijimi i një qendre të vogël muze (antiquarium) që përkrah me ekspozimin e objekteve të ndryshme karakteristike antike, të ofroje dhe disa shërbime bazë për vizitorët (zyra e biletave, librari, administratë, hapësira sanitare, restorant i vogël). Së fundmi, parashikohet krijimi i sinjalistikës shumëgjuhëshe informative, shoqëruar me udhëzimet në Braille për vizitorët e verbër dhe me guidë audio interaktive.

Grupet e interesit

Aktorët publikë: Bashkia Krujë, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti Arkeologjik, Ministria e Kulturës

Aktorët privatë: Ferma turistike, prodhues vendorë kompanitë private aktive të sektorit të turizmit

Aktorët të Sektorit të Tretë: Shoqata kulturore, organizata të mjedisit, WWF (World Wide Fund for Nature)

Agjensitë e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Rezultatet e parashikuara

- Zgjerimi i kufinjve të zonave të mbrojtura sipas ligjeve ekzistuese.
- Mbrojtje, kujdes dhe vlerësim i zonës arkeologjike.
- Identifikimi dhe fuqizimi i komuniteteve lokale në lidhje me vlerën dhe kuptimin e vendit.
- Zhvillimi i gërmimeve arkeologjike.
- Zhvillimi i aktiviteteve plotësuese turistike në zonë.
- Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe qasjes ndaj trashëgimisë kombëtare.
- Rritje e ofertës turistike.
- Rritje e vendeve të punës dhe e të ardhurave lokale.

Periudha kohore e zbatimit

Parashikohet një zbatim shkallë-shkallë i projektit të korridorit të gjelbër, i lidhur ngushtë me zhvillimin e Parkut Arkeologjik të Albanopolisit, dhe ky zhvillim pritet të japë rezultate në një hark kohor fillestar 3 vjeçar.

Fazat e projektit

Faza e parë (2017-2018): Realizimi i Parkut Arkeologjik të Albanopolisit, sëbashku me segmentin e parë të korridorit të gjebër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Burimet kryesore të financimit të mundshëm: Qeveri, bashki, donacione, fonde evropiane zhvillimi etj.

Burimet sekondare të financimit të mundshëm: Bashkim ndërmarrjesh private, përfituese të mundshme të projektit.

Përmbledhje e kategorive të punimeve që përfshihen, njësive, sasisë, çmimit për njësi, vlerës së pjesshme.

Kontribute nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

KATEGORIA E PUNIMEVE	Njësia matëse
Ndërhyrjet me karakter infrastrukturor	
A. Rrugë për vizitim të brendshëm	800 m
a. Rrethim i zonës arkeologjike	1400 m
b. Realizimi i antiquarium në shërbim të zonës arkeologjike të zonës, me librari dhe restorant të vogël	100 m²
c. Realizim i sinjalistikës informative shumëgjuhëshe me shërbim guidë audio interaktive	E përfunduar
d. Arredim i zonës arkeologjike (parapete, ulëse, ndriçim, çezma me ujë të pijshëm)	E përfunduar
e. Zonë parkimi për biçikleta	2500 m²
f. Krijimi i app-s për smartphone për sinjalistikë dhe informacion	E përfunduar
g. Sistem i ndriçimit për natën, që të rritet shikueshmëria e sitit arkeologjik edhe nga larg	1400 m
h. Mbjellja e pemëve të reja me funksion të fshehjes vizuale të ndërtesave ekzistuese rezidenciale dhe për mbrojtjen e zonës arkeologjike nga agjentët atmosferikë	E përfunduar
i. Financimi i aktivitetit të gërmimeve arkeologjike	
j. Kostot e menaxhimit	
k. Kostot e mirëmbajtjes	
l. Aktivitete pjesëmarrëse	
m. Realizimi i portalit web	
n. Zonë e mundshme shpronësimi për Parkun Arkeologjik	8,21ha
o. Shpenzimet për projektim dhe konsulencë	
p. Përgatitja e rregulloreve për menaxhimin e trashëgimisë	
q. Shpenzime të tjera financiare	

PP 35 | IP

Inkubator ndërmarrjesh dhe shkollë profesionale

Projektimi dhe zbatimi i një strukture që do të shërbejë si inkubator për ndërmarrjet e reja (startup) si dhe një shkollë trajnimesh profesionale për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Përshkrimi i projektit

Inkubatori i ndërmarrjeve është një strukturë që ka për qëllim shpejtimin dhe sistemimin e procesit të krijimit të ndërmarrjeve inovative. Nëpërmjet përdorimit të infrastrukturave të përbashkëta dhe ofrimit të shërbimeve specifike në mbështetje të biznesit, inkubatori do të ofrojë mundësi në rritjen profesionale të sipërmarrësve të rinj dhe mundësi kontakti me ndërmarrje të tjera në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i inkubatorit është të mbështesë "zhvilluesit e talentuar" ose më saktë ata që zhvillojnë ide që kanë më shumë gjasa të kenë sukses. Roli i tij është që të vlerësojë si idenë ashtu dhe aftësitë e sipërmarrësit për ta realizuar atë, duke vlerësuar të ardhurat e nevojshme për t'i dhënë jetë projektit dhe duke hartuar një plan biznesi në të cilin evidenton potencialin financiar dhe blerësit e produktit të ndërmarrjes së ardhshme.

Një model inkubatori ndërmarrjesh përgjithësisht karakterizohet nga:

a) MISIONI dhe VIZIONI

b) VENDNDODHJA dhe zgjerimi i mbulimit gjeografik të saj (në zona industriale, afër Universiteteve ose jo, etj.)

c) SHKALLA E SPECIALIZIMIT (për sa i përket sektorit ekonomik)

d) ZGJERIMI I INVESTIMEVE DHE I SHËRBIMEVE TË OFRUARA: ndjekja e ndërmarrjes potenciale deri në zhvillimin e saj ose ndjekja vetëm në fazat e para, ofrimi i shërbimeve duke filluar nga ekspertiza (know-how) deri në shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të operimit (networking), shërbime financiare, etj.

e) METODA PËRZGJEDHËSE TË NISMAVE

f) SISTEMI I "SHKËMBIMIT" INKUBATOR-NDËRMARRJE E RE (p.sh. Kostoja e performancës së inkubatorit)

g) AFATI në të cilën ndërmarrja e re duhet të largohet nga inkubatori dhe të përcaktojë programin në vazhdim

Gjithashtu Inkubatori do të shërbejë edhe si qendër për trajnimin profesional, ku do të specializohen banorë të bashkisë Krujë në profesione që ndikojnë drejtpërdrejtë në ekonominë vendase dhe mundësojnë zhvillimin e mëtejshëm të sipërmarrjeve të vogla e të mesme ku janë punësuar një pjesë e mirë e popullsisë. Këto trajnime do të mundësojnë formimin profesional për industritë e specializuara që janë karakteristike për bashkinë Krujë si përpunimi i drurit, bujqësia dhe turizmi.

Grupet e interesit

Aktorët publikë: Bashkia Krujë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Aktorët privatë: Ndërmarrje, konsorciume,

kooperativa

Aktorët të Sektorit të Tretë: Institute kërkimore, Universitete, Shoqata jo-fitimprurëse

Agjencitë e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Rezultatet e parashikuara

Në njëzet vitet e fundit, inkubatorët janë konsideruar si një mekanizëm për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik të vendeve. Shumë agjenci rajonale, qeveri dhe institucione të tjera publike kanë përdorur inkubatorët si një mjet për të reduktuar probabilitetin e dështimit dhe për të përshpejtuar procesin e krijimit të ndërmarrjeve të reja. Shërbimet që strukturat e inkubatorit mund tu ofrojnë ndërmarrjeve të reja janë të ndryshme:

- Qasja në të mira materiale. Inkubatorët u vënë në dispozicion ndërmarrjeve të reja, zyra, lokale, orendi, qasje në infrastrukturë, në internet dhe në laboratorë informatike.

- Qasje në burime financiare. Inkubatorët ofrojnë qasje në kapitale, si nëpërmjet fondeve të tyre ashtu edhe nëpërmjet fondeve të krijuara nga kontributi i investitorëve

të huaj. Në përgjithësi objektivi i inkubatorëve përbëhet nga ndërmarrje që kërkojnë fonde për investim në fazat e para të zhvillimit të tyre (Seed Capital). Konkurrentët kryesorë në aktivitetet e financimit përfaqësohen nga business angels, sipërmarrje kapitaliste të specializuar në ofrimin e kapitalit fillestar, dhe nga kompani investimesh.

- Mbështetja administrative. Përveç infrastrukturës, inkubatorët mund të ofrojnë shërbimet e sekretarisë, pritjen, postën, mbështetje kompjuterike, të cilat u mundësojnë sipërmarrësve të përdorin në mënyrë më efikase kohën, sidomos në fazat fillestare të biznesit të tyre, duke fokusuar vëmendjen e tyre në elementët më të rëndësishëm të idesë së tyre për sipërmarrjen, duke bërë që ajo të ngjizet më shpejt.

- Mbështetja strategjiko-menaxhuese. Inkubatorët mund ndihmojnë ndërmarrjet e reja në hartimin e planit të biznesit dhe të ofrojnë shërbime profesionale si ato të kontabilitetit, mbështetje ligjore dhe mbështetjen e taksave, kërkime për stafin e ri, mbështetje strategjike. Ata gjithashtu mund të ofrojnë mbështetje të menaxhimit, duke ndihmuar sipërmarrësit për të zhvilluar aftësitë e nevojshme menaxhuese.

- Qasje në rrjete. Në përgjithësi, inkubatorët janë ne gjendje të identifikojnë aktorë kyç te jashtëm për të ndihmuar ndërmarrjet në përkujdesje. Sipërmarrësit aspirantë jo gjithmonë kanë kontaktet e nevojshme për të zhvilluar idenë e tyre për sipërmarrje; këto mund të sigurohen nga inkubatori, si rezultat i eksperiencës së vetë inkubatorit ose e menaxherëve të tij. Rëndësia e shtrirjes së kontakteve shpesh është nënvlerësuar nga shumë inkubatorë, ndërkohë që studimet e fundit tregojnë që akseset në rrjetet e organizuara me aktorë të jashtëm janë kyçe, që përcakton suksesi ose dështimin (Hansen et al., 2000). Aksesi në këto rrjete strategjike mund të ofrohet edhe nga firma konsulente, business angels, ose rrjete të organizuara, si psh. First Tuesday].

Periudha kohore e zbatimit

Koha e plotë e ushtrimit të një inkubatori ndërmarrjesh varet nga përmasat e tij dhe nga vendndodhja e tij. Duke konsideruar që zona ku inkubatori do të ushtrojë aktivitetin e tij është sa bashkia e Krujës, mund të mendojmë që koha e realizimit të strukturës dhe të ushtrimit të plot të funksioneve të tij për të pritur ndërmarrjet e para, mund të jetë një vit.

Fazat e projektit:

Faza e parë (pjesa e dytë 2016): realizimi i Parkut teknologjik me shërbimet përkatëse dhe infrastrukturën;

Faza e dytë (pjesa e parë 2017): fillimi i aktivitetit menaxhues të strukturës me shpalljen e tenderave për shfrytëzimin e hapësirave dhe të shërbimeve të ofruara.

Burimet kryesore të financimit të mundshëm

Përgjithësisht, të ardhurat kryesore të një inkubatori janë nga:

Financim nga ana e autoriteteve publike

Konsulentë të veçantë

Kapitalin e vetë - privat

Sipas burimit të financimit mund te dalim ne përfundimin se inkubatorët mund të jenë privatë, publikë dhe Universitarë. Nga ana tjetër, inkubatorët privatë ndahen në:

1. Inkubatorë sipërmarrës: ofrojnë të gjitha llojet e shërbimeve, me një theks të veçantë në ndihmën menaxhuese dhe shërbime të rrjeteve;

2. Nxitës të sipërmarrjeve: detyra e tyre është të përshpejtojnë zhvillimin e ndërmarrjeve të reja, duke u fokusuar në konsulencën strategjike, injektimin e kapitalit dhe futjen në treg në kohë më të shkurtër të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

3. Portale të sipërmarrjeve: në sajë të portaleve të internetit, investitorët mund të kenë qasje në një numër të gjerë projektesh të ndarë sipas sektorëve, përmasave të investimit të nevojshëm dhe fazës së zhvillimit;

4. Ndërlidhës të sipërmarrjeve: investojë në nismat fillestare dhe në të njëjtën kohë nxisin rritjen e bashkëpunimit efektiv ndërmjet partnerëve të ndryshëm.

Për sa i takon inkubatorëve publikë, të ashtuquajturit jofitimprurës, ata kanë tendencë për të siguruar mbështetje të përgjithshme për zhvillimin e zonave rajonale ose lokale, duke u fokusuar në krijimin e shoqërive të cilat kanë qëllime të dobishme sociale (p.sh. krijimi i vendeve të reja të punës). Këta operatorë nuk janë zakonisht të specializuar në një fushë të caktuar.

Së fundmi kemi një gjeneratë të re inkubatorësh jo-tradicionale të quajtur "Universitarë", të cilat ndryshe nga dy llojet e tjera të përshkruara më sipër, punojnë në bashkëpunim të ngushtë me institutet kërkimore.

Karakteristikat kryesore të këtyre strukturave janë si më poshtë:

- Fokus i fortë në kërkimin shkencor;

- Prania fizike në universitete;

- Theks i veçantë mbi çështjet e universitetit;

- Mbledhja e ideve të studentëve të diplomuar ose jo, dhe studiuesve;

- Bashkëpunim i ngushtë me ato ndërmarrje që sponsorizojnë kërkimet universitare.

Burimet sekondare të financimit të mundshëm

Bashkëpunim mes ndërmarrjeve dhe kompanive private, që mund të nxjerrin përfitime nga projekti.

- KATEGORIA E PUNIMEVE	- NJËSIA	- Njësia matëse
- Ndërhyrjet me karakter infrastrukturor		
- a. Strukturat që do të jepen për kompanitë e Start-Up	- 10	- 50 m2
- b. Strukturat që të jepen për shërbimet e biznesit	- 1	- 200 m2
- c. Facilitete teknologjike • Auditorium • Mobilie • Sallë informatike • Impiant kondicionimi • Impiant ndriçimi • Impiant ngohje • Impiante hidriko-sanitare	- E përfunduar	
- Ndërhyrjet me karakter menaxherial e promocional		
- d. Shkollë profesionale	- E përfunduar	- 1
- e. Shërbime të përgjithshme përfaqësie e konsulence	- E përfunduar	- 1
- f. Kosto menaxhimi	- E përfunduar	- 1
- g. Krijimi i portalit web	- E përfunduar	- 1
- h. Kosto projektimi dhe konsulentë teknike	- E përfunduar	- 1
- i. Kosto mirëmbajtjeje	- E përfunduar	- 1
- l. Aktivitetet pjesëmarrëse	- E përfunduar	- 1
- m. Kosto të tjera financiare	- E përfunduar	- 1

3.3.2.2 Projektet Strategjike të Zhvillimit afat shkurtër

PS 01 Përmirësimi i rrjeteve teknike

Zhvillim i rrjeteve të burimeve të ujërave të pijshëm, kanalizimet e ujerave të zeza dhe furnizimi me energji elektrike, si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm.

Përmirësimi i rrjeteve teknike nënkupton ndërhyrjet e nevojshme për krijimin ose përmirësimin e infrastrukturave bazë që mbulojnë zonat urbane dhe krijojnë kushtet bazë të jetesës për komunitetet lokale që jetojnë në këto zona. Në diskutime me stafin teknik të bashkisë Krujë, si investime të nevojshme primare që kanë një impakt direkt në përmirësimin e kushteve të jetesës janë: Infrastruktura rrugore, Infrastruktura e ujësjellës – kanalizime, Infrastruktura e energjisë elektrike.

PS 02 Mbrojtje e akuiferëve

Kontrolli i shfrytëzimit të burimeve ujore nëpërmjet puseve dhe i shkarkimeve nën tokë (në akuifer) i ujërave të zeza, si kusht fillestar për qëndrueshmërinë mjedisore.

Zhvillimi informal i 20-25 viteve të fundit, mungesa e rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve që ka sjellë përdorimin në masë të puseve si mjet furnizimi me ujë dhe gropave septike për largimin e ujerave të zeza, vë në rrezik cilësinë e akuifereve.



PS 03 Pastrimi i lumenjve

Inventarizim dhe kontroll i hedhjeve të lëndëve ndotëse në trupat ujore, si ato me natyre urbane ashtu edhe industriale, për të penguar ndotjen e mëtejshme të sistemeve ujore sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Territori i bashkisë Krujë ka një rrjet të pasur ujerash sipërfaqësor që janë një aset mjaft me vlerë për zhvillimin e bujqësisë, turizmit dhe cilësisë së jetës së komunitetit të banorëve që jetojnë në këtë zonë. Këtu përfshihen lumi Ishëm dhe degët e tij, rezervuarët dhe liqenet artificiale dhe gjithë rrjeti i kanaleve vaditës. Sa më sipër projektet e nevojshme për këtë rrjet të pasur ujërash sipërfaqësor janë:

- Projekt për kontrollin, monitorimin e rreptë dhe gradualisht shmangien e shfrytëzimit të pakontrolluar të shtretërve të lumenjve për marrjen e inerteve;

- Projekt për kontrollin dhe ndalimin e rreptë të ndotjeve që vijnë nga bizneset e zhvilluara pranë këtyre asete ujore;

PS 04 Mbrojtje ndaj përmbytjeve

Studimi i zonave të rrezikuara nga dalja e lumenjve nga shtrati, përcaktimi i udhëzimeve dhe veprave prioritare, projektimi dhe realizimi i ndërhyrjeve urgjente dhe vënia në siguri e territorit.

Përmbytjet përbëjnë një rrezik që cenon ekonominë e banorëve dhe ndikojnë negativisht në mjaft sektorë vitalë të bashkisë Krujë. Pasuria ujore dhe relievi mjaft i ulët për një pjesë të territorit janë kthyer në një problem konstant për komunitetin e kësaj zone. Pavarësisht disa iniciativave të marra kohët e fundit, konstatohet që në shumicën e rasteve projektet kanë qenë të një karakteri pjesor pa studiuar në tërësi ekuilibrat delikate të sistemit ujor të kësaj zone. Për sa më sipër propozohet:

- Hartimi i një projekti të karakterit studimor që merr në konsideratë gjithë sistemin ujor të territorit të bashkisë dhe më gjerë si dhe ndikimin e kushteve klimatike të zonës.

- Investime konkrete në mirëmbajtjen dhe funksionimin e hidrovoreve dhe nëse është e nevojshme edhe ndërtimin e hidrovoreve të rinj.

- Plan për zhvendosjen graduale të gjithë banorëve që vitet e fundit kanë ndërtuar shtëpi në zona me rrezik ndaj përmbytjeve dhe që janë kthyer tashmë në një problem social.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, KRUJË
SEKRETARIA

PS 05 Pastrimi i mbetjeve urbane

Propozim i përgjithshëm mbi mënyrat e racionalizimit dhe realizimit të sistemit të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane, duke evidentuar edhe fazat dhe afatet e realizimit.

PS 06 Përmirësimi i rrugës së vjetër kombëtare Fushë-Krujë – Borizanë - Thumanë

Rimëkëmbje e funksionalitetit dhe rolit territorial të rrugës së vjetër kombëtare, që lidh qendrat urbane historike që ndodhen përgjatë rrëzës së vargmaleve. Përmirësimi i rrugës ekzistuese, është një domosdoshmëri dhe urgjencë për banorët e kësaj bashkie.

Rruga e vjetër kombëtare, përbën një nga akset kryesore që lidh qendrat e banuara tradicionale të bashkisë Krujë (Nikël, Fushë Krujë, Borizanë, Thumanë). Me ndërtimin e aksit të ri Fushë Krujë - Milot, rruga e vjetër ka kaluar në një rëndësi të dorës së dytë dhe kanë munguar investimet konkrete. Duhet patur parasysh që kjo rrugë është pjesë e infrastrukturës kombëtare dhe si e tillë është në inventarin e akseve që menaxhohen nga ministria që mbulon sektorin e transportit rrugor. Propozimi në këtë rast adresohet tek financimet e qeverisë qendrore për këtë sektor.

PS 07 Përmirësimi i hekurudhës

Rimëkëmbje e funksionalitetit teknik dhe zhvillim i funksionit territorial të hekurudhës ekzistuese, për t'i dhënë një hov të ri rolit të mundshëm si mjet transporti publik parësor.

Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës hekurudhore është një ndërmarrje dhe investim që bëhet nga qeverisja qendrore. Pavarësisht kësaj, projekt-propozimi në këtë rast fokusohet në rivitalizimin e stacioneve hekurudhore që ndodhen brenda territorit të bashkisë Krujë.

PS 08 Planifikim i detajuar vendor

Hartim i planeve të detajuara vendore (PDV) të parashikuara nga Neni 22 i ligjit 107/2014 në të gjitha ato situata urbane ku ekziston nevoja për ndërhyrje.

Në zbatim të kuadrit ligjor për planifikimin e territorit, planet e detajuara vendore (PDV) përfshihen në nivelin e dytë të instrumenteve të planifikimit (planifikimi në nivel vendor). Pas miratimit të PPV, është detyrë e bashkisë që të nis procesin e koordinimit ose të hartimit të PDV-ve kryesisht për ato zona ku presioni i zhvillimit është i madh.

PS 09 Planifikim i detajuar vendor

Përgatitja e një plani për mbrojtjen nga rreziqet e lidhura me emergjencat e mundshme, duke parashikuar strategjitë e ndërhyrjeve dhe përcaktimin e hapësirave për vënien në siguri të popullsisë.

Ndër rreziqet kryesore mund të përmendim përmbytjet, rrezikun sizmik dhe zjarret, që janë disa prej rreziqeve kryesore që duhet të ketë në fokus Plani i Emergjencave Civile për territorin e Bashkisë Krujë.

- Hartimi i Planit të Emergjencave Civile të bashkisë Krujë;

- Masa informuese dhe sensibilizuese që bazohen tek konkluzionet e këtij plani me qëllim orientimin e komuniteteve të rrezikuara në raste fatkeqësish.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, TIRANË

PS 10 Qendra kulturore në zonat urbane

Realizim i qendrave lokale për aktivitete social-kulturore, edhe nëpërmjet rikuperimit të ndërtesave ekzistuese të cilat nuk përdoren më për këto qëllime.

Kruja është një nga qendrat kryesore të trashëgimisë kulturore të mbarë vendit tonë. Kalaja dhe Pazari i Krujës, Kalaja e Zgërdheshit dhe monumentet e shumta e kulturës e kthejnë këtë territor në një nga pikat kryesore të turizmit kulturor dhe aktualisht mjaft e vizituar nga turistë vendas e të huaj. Krijimi i faciliteteve kulturore, rekuperimi i qendrave kulturore të amortizuara si dhe krijimi i infrastrukturës ndihmëse duhet të jenë një prioritet i bashkisë.

Promovim i turizmit kulturor, përmirësimi i infrastrukturave të aksesit, pika informimi;

PS 11 Qyteti mik i fëmijëve



Programimi i ndërhyrjeve urbanistike me pjesëmarrje të gjerë për përmirësimin e jetës së fëmijëve në qytete, duke njohur dhe realizuar të drejtat e tyre.

"Qyteti i fëmijëve" është një programi kombëtar që mbështetet nga UNICEF, që ka filluar të konkretizohet fillimisht në qytetin e Korçës dhe do shtrihet në gjithë qendrat kryesore urbane të Shqipërisë. Qëllimi kryesor i këtij programi është krijimi i qendrave multi-funksionale të cilat i dedikohen tërësisht fëmijëve. Në këtë kuadër propozohen dhe arredime urbane me fokus fëmijët dhe dimensionimi i hapësirave publike të aksesueshme nga ata.

3.3.2.3 Projektet Strategjike të Zhvillimit afat mesëm

PSV 12	I+L	Rindërtim i Urës së Tubit



Ndërtimi i një ure të re që do të zëvendësoje urën e Tubit ekzistuese, e cila është jashtë kushteve teknike dhe atyre të sigurisë, dhe në varësi të kushteve të motit edhe jofunksionale. Kjo urë do të mund të përmirësonte ndjeshëm komunikimin e Rinasit me Tapizën.

PSV 13	I+L	Rruga Prezë-Budull

Lidhja e Prezës me fshatin Budull do të mundësonte krijimin e një rrjeti lidhës mes qendrave rurale dhe do të kthente kalanë e Prezës në një pikë lehtësisht të aksesueshme nga territori i Bubqit. Kjo rrugë do të kompletonte segmentin e rrugës që përshkon kodrat e Ishmit duke lidhur kalanë e Prezës me atë të Ishmit dhe do të ofronte një sistem funksional, panoramik dhe me potencial për zhvillimin e turizmit.



PSV 14	I+L	Lidhja e Thumanës me Bubqin

Lidhja e njësive administrative Thumanë dhe Bubq, nëpërmjet plotësimit të segmenteve rrugore të paasfaltuar si dhe rehabilitimit të sistemit të urave dhe ndërtimit të urave të reja në korridorin ujor që ndan këto dy njësi administrative. Kjo infrastrukturë do të mundësojë një komunikim unazor në gjithë territorin e bashkisë Krujë, duke rritur ndërveprimin territorial dhe ekonomik dhe duke mundësuar një zhvillim të integruar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PSV 15	I+L	Pol logjistik i integruar në Fushë-Krujë



12. Pol logjistik i integruar në Fushë-Krujë



Projektimi i një qendre logjistike të integruar, që përmbledh tipologji të ndryshme transportesh, e tillë që të optimizojë grumbullimin dhe shpërndarjen e mallrave në hyrje dhe dalje.

PSV 16	I+L	Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës



13. Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës

Propozim dhe realizimi i ndërhyrjeve urbanistike për përmirësimin e cilësisë së jetës sociale në zonën qendrore të Thumanës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PSV 17	I+L	Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës



14.Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës

Propozim dhe realizimi i ndërhyrjeve urbanistike për përmirësimin e cilësisë së jetës sociale në zonën qendrore të qytetit të Fushë-Krujës

PSV 18	TK	Kalaja e Krujës dhe Pazari i Vjetër

Projekt i integruar për ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave të kompleksit historiko-kulturor të përbërë nga Kalaja e Krujës, Pazari i Vjetër dhe Muzeu Etnografik.



1, Pazari i Vjetër

2. Kishtjella e Krujës

3. Muzeu Etnografik

SHQIPËRISE
LIMIT TË TERRITORIT
AGENCIA KOMBËTARE
TIRANË
SEKRETARIA

PSV 19	TK	Pikë me interes religjioz dhe panoramik në Sarisalltik

Projekt i integruar për promovimin për qëllime turistike të shpellës dhe majës Sarisalltik, pikë me interes si fetar ashtu edhe peizazhistik dhe mjedisor. Pjesë e programit promovues do të jetë edhe rekuperimi i shtegut që lidh Sarisalltikun me Krujën duke krijuar një trajektore të sigurt për pelegrinët dhe të apasionuarit e ecjes në natyrë.



28.Pikë me interes religjioz dhe panoramik në Sarisalltik

PSV 20	IP	Ndërtimi i baxhove eksperimentale



24.Ndërtimi i baxhove eksperimentale

Projekt për krijimin e një impianti të ri eksperimental për përpunimin dhe transformimin e qumështit në produkte bulmeti, që synon krijimin e një zinxhiri të shkurtër shpërndarjeje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TËRRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PSV 21	IP	Zonë tregu lokal

Projekti paraqet një rrjet të bashkëpunimit midis kompanive për një qasje rajonale për zbatimin dhe forcimin e zinxhirëve të furnizimit te produkteve lokale brenda një planifikimi më të gjerë ekonomik të zhvillimit , ku përfituesit janë kompani dhe konsorciume të tyre.

Realizimi i një tregu lokal, si një vend në të cilin prodhuesit do të kenë një hapësirë për shitje direkte, informacione për konsumatorët, projekte zhvillimi, në një krahasim të vazhdueshëm dhe konstant me nevojat dhe shijet e tyre.

Në detaje, zona e propozuar do të menaxhohet nga një konsorcium i kompanive dhe / ose prodhuesve, përmes zbatimit të një sërë veprave të nevojshme dhe funksionale në aktivitetet e këmbimit.

PSV 22	IP	Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe shëndetit

Projektimi dhe instalimi i një qendre për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe të efekteve të ndotjes atmosferike në shëndetin e banorëve të zonave përreth fabrikave të çimentove.

3.3.2.4 Projektet Strategjike të Zhvillimit afat gjatë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

PSV 23	I+L	Aksi i ri Thumanë - Tiranë

Realizimi i një aksi të ri rrugor me shpejtesi te larte, qe lidh drejtperdrejt Thumanen me aksin Tirane-Durres, si alternative e rruges aktuale kombetare Tirane-Shkoder, qe ka nje trafik mjaft te renduar.



PSV 24	I+L	Rruga Krujë-Tiranë

Realizimi i lidhjes rrugore te drejtperdrejte mes Krujes dhe Tiranes, nepermjet rikuperimit te gjurmes ekzistuese. Kjo rruge redukton kohen e udhetimit, mundeson zhvillimin e fshatrave te thella ne juglindje te territorit te bashkise, si dhe ka potencialin e transformimit ne nje korridor perzazhistik e natyror, qe shnderron Qendren Historike te Krujes ne nje destinacion turistik te kryeqytetit. Gjithashtu, permes kesaj rruge mundesohet lidhja me rrugen e Arbrit duke krijuar mundesi per zhvillim te metejshem te turizmit nga Maqedonia dhe duke permiresuar lidhjen e qytetit me zonen lindore te vendit.



PSV 25	I+L	Sistemi i aeroportit "Nënë Tereza"



Krijimi i një sistemi ekonomik në shërbim të zonës së aeroportit duke shfrytëzuar potencialet e zhvillimit që mundëson Aeroporti.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PSV 26	I+L	Lidhja e Bubqit me bregdetin

Lidhja e Bubqit me bregdetin: Lidhja me Gjirin e Lalëzit është aktualisht e realizuar nëpërmjet një rruge nga Bubqi - Kodër Ishëm – Lalëz; një lidhje më e shkurtër e Bubqit me gjirin e Lalzit si dhe lidhja me gjirin e Rodonit do të mund të përfiqte një pjesë të mirë te fluksit turistik gjatë verës që do të përshkonte këtë territor për të mbërritur në bregdet.



PSV 27	I+L	Rruga lidhëse Krujë-Mamurras

Përforcim i lidhjes rrugore Krujë - Mamurras nëpërmjet përmirësimit dhe rehabilitimit të rrugës ekzistuese Krujë – Brret – Thumanë - Mamurras.



PSV 28	I+L	Rruga Krujë-Burrel



Vazhdimi i rrugës Krujë-Qafë Shtamë sipas gjurmës ekzistuese do të mundësonte lidhjen e Krujës me Burrelin dhe shfrytëzimin më të mirë të potencialeve turistike të zonës së Qafë Shtamës. Kjo rrugë është pjesë e korridorit tërthor mbështetës Durrës – Krujë – Dibër parashikuar nga PPK.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

PSV 29	TK	Ujërat termale në Bilaj



27.Ujërat termale në Bilaj

Zhvillimi i një programi për ujërat termale në Bilaj, me qëllim zgjerimin e ofertës turistike me një segment të specializuar.

PSV 30	TK	Turizëm malor në Qafështamë

Zhvillim i turizmit natyror dhe ekskursioneve në zonën malore të Qafështamës, nëpërmjet nxjerrjes në pah të vlerave të peizazhit dhe resurseve antropologjike. Në kuadër të promovimit të këtij karakteri propozohet edhe zgjerimi i zonës së mbrojtur të parkut kombëtar të Qafë Shtamës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

04 / Aneks

4.1 KONSULTAT PUBLIKE GJATË HARTIMIT TË PPV

Gjatë hartimit të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, është shumë e rëndësishme që gjatë fazave nëpër të cilat kalon procesi, të realizohet **përfshirja e grupeve të interesit dhe dëgjesat publike**.

Qëllimi kryesor i këtyre takimeve publike është, të krijojë transparencë dhe besim ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve publike, në mënyrë që vendimet e zhvillimit të territorit të jenë në përgjigje të kërkesave të këtyre aktorëve.

Gjatë kësaj periudhe të punës me PPV-në, pra gjatë hartimit të fazës së parë, "Analiza e thelluar e Territorit", dhe gjatë procesit të punës për fazën e dytë, "Strategjia territoriale dhe Plani i veprimeve strategjike" janë realizuar disa dëgjesa publike, si dhe janë kryer takime të ngushta me administratorët, me ekspertë vendorë, përfaqësues të biznesit e aktorë të tjerë, që operojnë në këtë rajon, të cilët me aktivitetin e tyre, janë pjesë thelbësore e zhvillimit territorial.

4.1.1 Dëgjesë Publike datë 01.03.2016

Në datën 01.03.2016 në qytetin e Krujës u organizua një dëgjesë publike me përfaqësues të qeverive lokale, përfaqësues të Agjencisë se Planifikimit te Territorit, përfaqësues të sektorit privat, banorë të zonës etj. Gjatë prezantimit të Analizës dhe Vlerësimit të gjendjes ekzistuese (objekt i fazës se parë), u diskutua dhe u morën mjaft sugjerime në lidhje me problematikat dhe nevojat e zonës. Gjatë dëgjesës publike në sallë, u shpërndanë dhe pyetësorë me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave kryesore dhe marrjen e opinionit të të pranishmëve, në lidhje me atë që ata e mendojnë si më të nevojshme për zonën e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Datë 01 Mars 2016

Dëgjesë publike për hartimin e Planit të Pëgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë

Faza e parë: Analiza dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Emri	Mbiemri	Pozicioni/	Tel. / Cel.	E-mail
Zelilja	Kuvalaj	Ekonomiste	0682164070	zeli.kuvalaj@yahoo.com
Bledar	Hakiu	Jurist	0692508888	bledi8888@hotmail.com
[illegible]	Hoxha	Bajra	0B 84155	—
ARSHAMIR	BAZJA	Ing. [illegible]	0683872745	—
Astrit	Gurakuqi	[illegible]	0682815921	—
Kastriot Praio	Praio	[illegible]	0695052865	[illegible]
Albert Dubali	Dubali	Pensionist	0692100739	
MUHADEM	NDREU	TOPOGRAF	0695735276	
Muhamet	Loka	Inspektor Pyjesë	0693430026	

Datë 01 Mars 2016

Dëgjesë publike për hartimin e Planit të Pëgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë

Faza e parë: Analiza dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Emri	Mbiemri	Pozicioni/	Tel. / Cel.	E-mail
[illegible]	DANO		0673626705	
ERDIC	NEZIRI	SPAPUN	0686257508	
SKENDER	ALKURTI	ISH. USHTARAK	0682911010	
Mehmet	Oda	Dr. B. Pl.	0682789397	
Naim	Merlika	po punë	0682221958	
Mevlid	Kalajoi	PENSION	0692491178	
Rovena	Kaçani	I.H.T Bashkia Krujë	0673006540	
Ermanda	Çeli	I.A.SG.B. Krujë	0692289767	ermandaceli@gmail.com
Hysni	Caca	K. K. Bashkia	0692183146	
MALIQ	RECI	SEK. K. BASHKIAK	0692259105	
Erald	Vraja	P. punës	0683751073	
Gjergjia	Koka	P. punë	0682807630	

Datë 01 Mars 2016

Dëgjesë publike për hartimin e Planit të Pëgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë

Faza e parë: Analiza dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Emri	Mbiemri	Pozicioni/	Tel. / Cel.	E-mail
EDMOND	MALLAHI	Inspektor mjedisi	0672214111	edmond.mallahi@yahoo.com
Veli Keni	Keni			
		Pensionit		
Avdyan	Bajraktari	Traktorist	0692603928	
Mufaredin	Çelhezi	Pensionist		
Hoxhi	Çeloci	OPERATOR	0699422142	hoxhiceloci@gmail.com
Anisa	Maloku	Specialist NE		anisatopalli@hotmail.com
Sanije	Pistolja	Specialiste NE		sanijepistolja@yahoo.com
Jolanda Gumi	Gumi	Nëpunëse e Z.G.C		0693099392
Ing. Ela	Shkolaj	Inp. fiz.	0637619108	shkollja@gmail.com
STAVLARI	Pampili	Tekniku Jashtëm	0698603131	pampilstavlari@yahoo.com
Daniela	Temo	Arsim	0692571458	dafdlatema@gmail.com
Elida	Çela	Arsimi parësor	0692160785	cela.elida@yahoo.com
Deshire	Karruka	Punësim P. Punësi	0685450323	

Datë 01 Mars 2016

Dëgjesë publike për hartimin e Planit të Pëgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë

Faza e parë: Analiza dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Emri	Mbiemri	Pozicioni/	Tel. / Cel.	E-mail
Sonila	Zela	Juriste	0685407814	sonila.zela@yahoo.com
Amela	Hoxhi	Jurist. B. Krujë	0693062614	amelahoxhi@yahoo.com
Sabije	Sesaj	Ekonomiste	0686521907	sabije.puniqi@gmail.com
Eglantina	Subashi	Mr. Juridike	0693214250	eglantina.subashi@yahoo.com
Pëzarlda	Balla	Perg. B. Nëpunëse	0696517722	pezarldaballa@yahoo.com
Matilda	Togo	Punëtore Social	0696386746	matildaallomani@hotmail.com
Ermida	Tuqa	Nëpunëse B. Krujë	0695467791	ermida2010@live.com
Aida	Deda	Dr. Pl. B. Krujë	0697570621	aida.deda@yahoo.com
Iva	Hoxha	Dr. Pl. B. Krujë	0695163897	iva.hoxha@yahoo.com
